



Republika e Kosovës
Republika Kosova -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR 25 NËNTOR 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
25. NOVEMBRA 2008. GODINE

NËNTOR – NOVEMBAR
2008

Seancën e drejtoi Kryetari i Kuvendit, zoti **Jakup Krasniqi**.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuari Kryeministër, zëvendëskryeministra,
Të nderuar ministra,

Hap seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.
Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 90 deputetë, që do të thotë janë plotësuar kushtet për të filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Para se të fillojmë me rendin e ditës, Kryeministri e ka kërkuar fjalën. Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

Të nderuar anëtarë të Kryesisë,
I nderuar Kabinet qeveritar,
Të nderuar kryetarë të partive politike,
Të nderuar deputetë, kolegë,
Të nderuar ndërkombëtarë,
Në konsultim me Presidentin, duke dashur t'iu përgjigjem shqetësimeve të qytetarëve, por në të njëjtën kohë edhe kërkesave dhe pyetjeve të shumta tuaja lidhur me planin 6 - pikësh të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili pritet të përfshihet në raportin që Sekretari i Përgjithshëm i OKB-ës do t'ia paraqet Këshillit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, më lejoni të ritheksoj edhe njëherë qëndrimin e institucioneve të Republikës së Kosovës.

Statusi i Kosovës është zgjidhur dhe kjo çështje është e mbyllur. Kosova, që nga 17 shkurti 2008, është shtet i pavarur, sovran, demokratik dhe i tillë do të jetë përgjithmonë.

Institucionet e Republikës së Kosovës i kanë dhënë mbështetje, e kanë ftuar, e kanë mirëpritur dhe do të bashkëpunojnë ngushtë me EULEX-in. EULEX-i do të vendoset në Kosovë ashtu siç e parashikon Kushtetuta e Kosovës, Plani i Ahtisarit dhe mandati nga Bashkimi Evropian.

Rezoluta 1244 e OKB-së është plotësisht jorelevante dhe e pakuptimtë në shtetin tonë sovran. Të gjitha fushat për të cilat flet plani 6 - pikësh: drejtësia, policia, kufijtë, doganat, trashëgimia serbe, transporti dhe infrastruktura, janë të rregulluara me ligjet tona përkatëse, të cilat janë miratuar nga Parlamenti i Kosovës dhe të cilat janë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Çdo dokument tjetër duhet të zbatohet në përputhshmëri të plotë me Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet e Kosovës.

Kosova ka paraqitur 4 pika të saj, që në fakt paraqesin edhe qëndrimin tonë zyrtar në raport me 6 pikat e propozuara. Kosova e ka Kushtetutën e vet moderne dhe ligjet e saj moderne, të cilat i rregullojnë të gjitha çështjet e ngritura.

Prandaj, është Kushtetuta e Kosovës dhe ligjet e miratuara nga Parlamenti i Kosovës që ne, si institucione të Kosovës, do t'iu përmbahemi dhe do t'i zbatojmë në praktikë dhe asgjë tjetër. Ky është plani ynë, ky është vizioni ynë, ky është vullneti ynë.

Plani 6 - pikësh për institucionet e Republikës së Kosovës, për popullin e Kosovës, ka genë, është dhe do të mbetet i papranueshëm dhe i pazbatueshëm në Kosovë. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, Kryeministër!

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me rendin e ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar 2009 – 31 dhjetor 2009.

Në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike, Qeveria e Kosovës ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka proceduar për shqyrtim dhe miratim, në parim, Projektbuxhetin për vitin 2009.

Ftoj Kryeministrin e Republikës së Kosovës, zotin Hashim Thaçi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektbuxhetin për vitin 2009. Zoti Kryeministër, e keni fjalën!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: I nderuar, zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar anëtarë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Të nderuar ndërkombëtarë të pranishëm,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Jam i nderuar që sot, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, të paraqes para jush Buxhetin e parë të Kosovës, si shtet i lirë, demokratik, shtet modern, i pavarur dhe sovran. Është hera e parë që nga hyrja në fuqi e Kushtetutës së shtetit tonë, më 15 qershor 2008, që një Qeveri e Kosovës, e pavarur, ka kryer obligimin kushtetues për të hartuar buxhetin e shtetit tonë të ri.

Me këtë Projektligj kemi marrë përgjegjësinë e plotë për sigurimin e rritjes ekonomike të Kosovës, mbrojtjen dhe kultivimin e jetesës të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Me këtë buxhet do të përcaktojmë drejtimin e ardhshëm ekonomik të Kosovës dhe, po ashtu, do të përcaktojmë se çfarë shteti do të jetë vendi ynë, a do të mbesim në të kaluarën, duke u përpjekur të vazhdojmë me politika të gabuara ekonomike të shtetit të dështuar të ekonomisë së centralizuar, apo do të vazhdojmë të modernizojmë ekonominë tonë dhe të transformojmë Kosovën si qendrën më të re të rritjes në Evropë.

Dekada e fundit e luftës sonë të përbashkët dhe sukseset tona këtë vit, me realizimin e pavarësisë sonë dhe miratimin e Kushtetutës së re, mua, e besoj edhe juve, na bëjnë të qartë faktin se populli i Kosovës dëshiron dhe është i vendosur të vazhdojë të shkojë përpara, dëshiron dhe meriton progres drejt Evropës moderne. Ky është vullneti i popullit

të Kosovës, ky është vizioni i progresit që e drejtoi Qeverinë time në krijimin e buxhetit. Ky buxhet i propozuar e vë Kosovën në rrugë drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik.

Zonja dhe zotërinj,

Buxheti i vitit 2009 është më i lartë në historinë e Kosovës. Shënon rritje mbi 15% në krahasim me Buxhetin e vitit 2008. Me këtë buxhet pushteti lokal është stimuluar me rritje të 100% sa i përket grandit të përgjithshëm që reflekton në ngritjen e shpenzimeve kapitale, aty ku përfitojnë më së shumti qytetarët. Kjo rritje është edhe rezultat i instalimit të qeverisjes së mirë, transparente, të sundimit të ligjit dhe të luftës së pakompromis të Qeverisë së Kosovës kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe ekonomisë informale. Buxheti përfshin investime të reja dhe të qëndrueshme kapitale për të modernizuar infrastrukturën tonë. Buxheti i rrit pensionet në mënyrë që të mbrohen dhe të shtohet përkujdesja institucionale për prindërit tanë. Shërbyesit civilë do të kenë rritje pagash brenda resurseve që i kemi dhe që mund t'i përballojmë. Familjet tona do të gëzojnë përfitimet prej shkollave të reja dhe spitaleve të renovuara e moderne.

Këta janë hapa të parë në riparimin dhe përmirësimin e ekonomisë sonë që po përballlet ende me vështirësi të së kaluarës.

Natyrisht, nuk mund të rregullojmë gjithçka për një vit dhe me një plan të vetëm shpenzimi. Ky plan është i mirë për kushtet, rrethanat, mundësitë e shtetit tonë të ri.

Megjithatë, mund të sigurojmë se po i vëmë bazat për rritje të vazhdueshme ekonomike. Duhet kuptuar se sot, në vitin e pavarësisë sonë, po vëmë themelet që do të përcaktojnë se çfarë shteti do të bëhet Kosova. Kjo është ajo që e bën buxhetin e këtij viti aq të rëndësishëm për të gjithë ne, pa marrë parasysh përkatësinë politike apo ndjenjat personale.

Duhet të kemi të qartë se zgjidhjet apo qasjet e gabuara sot do të ndjekin për të keq këtë vend për shumë vjet.

Ju ftoj të gjithëve të reflektojmë për interesin e Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve. Shteti nuk është qeveria, por është populli i Kosovës. Qeveria është e zgjedhur nga sovrani për t'i shërbyer dhe do të shërbejmë.

Të nderuar deputetë,

Kemi përgjegjësi para popullit të Kosovës të ndërtojmë një vend me ekonomi që do të ofrojë shpresë, optimizëm, siguri dhe stabilitet për fëmijët dhe nipërit tanë. Po ashtu, kemi përgjegjësi t'u tregojmë miqve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë, të cilët na ndihmuan të fitojmë lirinë tonë dhe vazhdojnë të investojnë në të ardhmen tonë, se e meritojmë besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të tyre. Në këtë mënyrë, kemi obligim të zgjedhim rrugën e drejtë ekonomike, rrugën e disiplinës fiskale, një rrugë që do t'i ofrojë Kosovës mundësi për rritje ekonomike edhe për shumë vjet.

Kosova ka resurse të mëdha, fuqi punëtore të re e të gjallë, pasuri të rëndësishme minerare dhe lokacion që premtan rritje të lartë ekonomike. Njëkohësisht, jemi një vend i ri dhe do të marrë kohë të shfrytëzojmë plotësisht gjithë potencialin tonë.

Buxheti ynë i parë duhet të investojë në çlirimin e këtij potenciali, duke e bërë në të njëjtën kohë jetën më të lehtë të gjithë qytetarëve të Kosovës brenda kufijve të mundësive tona aktuale.

Duke përgatitur këtë buxhet, të nderuar deputetë, kemi konsultuar shumë palë të interesuara. Ua kemi shpjeguar elementet e këtij buxheti të propozuar përfaqësuesve të partive politike të Kosovës, atyre në Qeveri dhe në opozitë. I falënderoj për mirëkuptimin dhe durimin që kanë pasur për të na dëgjuar dhe për idetë, sugjerimet dhe këshillat e tyre. Gjithashtu, dëshiroj t'i falënderoj edhe shoqërinë civile, që na kanë kuptuar në të dëgjuarit, por edhe për prezantimin e këtij debati nga ana e mediave. Ne mirëpresim diskutimet edhe sot, diskutime këto të mëtutjeshme, gjersa paraqesim elementet më të detajuara të planit tonë. Gjersa kemi shqyrtuar me kujdes të gjitha këshillat, ne marrim përgjegjësi të plotë për këtë buxhet. Ne jemi të përgatitur të paraqesim shpjegime shtesë për prioritetet tona në fokusin tonë. Ne kemi besim se elementet e këtij plani do të na dërgojnë në një drejtim të ri të politikës së re, kah e ardhmja më e mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në të vërtetë, prioritetet tona janë të thjeshta, por të rëndësishme së lartë. Ne duam paqe, stabilitet, progres dhe rritje ekonomike.

Jemi vend me resurse të mjaftueshme për të gjithë qytetarët tanë dhe punojmë të shohim një Kosovë që ofron kthesë dhe mundësi më të mirë për të gjithë. Jemi në rrugë për t'i arritur këto objektiva, por këto qëllime vendosin kërkesa para të gjithë nesh, duke përfshirë para se gjithash Qeverinë.

Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar deputetë,

Ne duhet të kuptojmë se Kosova sot nuk i ka resurset financiare për të plotësuar secilën nevojë dhe secilën kërkesë që mund të paraqitet, kështu që ne duhet të jemi edhe më të kujdesshëm të sigurojmë se çdo euro është e vlefshme, se projektet tona zhvillimore kanë ndikim në jetët tona dhe se të gjitha aktivitetet tona e orientojnë vendin tonë kah krijimi i vendeve të reja të punës.

Besoj se buxheti, të cilin ia kemi paraqitur Kuvendit për miratim, i arrin këto qëllime. Ai përmban një rritje prej 157.000.000 eurosh në shpenzime, krahasuar me vlerësimet e shpenzimeve për vitin 2008. Si pjesë e këtij buxheti për vitin 2009, Kosova do të shpenzojë 1.430.000.000 në investime kapitale, programe të arsimit, shëndetësore, shërbime sociale dhe programe tjera për qytetarët tanë. Këto investime dhe shpenzime do ta transformojnë Kosovën në shumë mënyra.

Me respekt, durim dhe përgjegjësi, dëshiroj t'ju ofroj disa shembuj se si synojmë të përmirësojmë kushtet në vendin tonë gjatë vitit të ardhshëm. Do të shpenzojmë më shumë se 100 milionë euro në rrugë. Kjo përfshin 53 milionë euro për renovimin e rrugëve të vjetra dhe të rrezikshme, të cilat janë korridore të rëndësishme transportuese, që e mbajnë ekonominë tonë në lëvizje. Do të vazhdohet dhe është në proces dizajni për ndërtimin e rrugës Prishtinë-Kaçanik, që na lidhë me Shkupin. Do të vazhdohet me auto-rrugën Prishtinë-Pejë, rreth 20 kilometra të reja. Do të vazhdohet me auto-rrugën Prishtinë-Vushtri-Mitrovicë, me 20 kilometra të reja dhe projekti madhor Vërmicë-Merdare, që është në përfundim e sipër.

Gjithashtu, do të kemi 12.000.000 të tjera që do të përdoren për mirëmbajtjen dhe ndërtimin e urave në tërë vendin. Do të investojmë më shumë se 30 milionë euro në

ndërtimin e rrugëve të reja, që do të sjellin vitalitet ekonomik rajoneve me infrastrukturë të kufizuar transportuese. Në vitin e ardhshëm do të ndërtojmë apo rinovojmë rreth 60 shkolla fillore dhe të mesme në tërë vendin me qëllim që t'u ofrojmë fëmijëve tanë një ambient arsimor, që iu duhet për t'u përgatitur për të ardhmen. Në tërësi, do të shpenzojmë rreth 40 milionë euro për të përmirësuar infrastrukturën arsimore në tërë Kosovën, pos grandit prej 98 milion eurosh që do t'ua japim komunave për arsim.

Jam i përkushtuar të përmirësoj sistemin arsimor në Kosovë, si një prej prioriteteve kryesore të Qeverisë që e udhëheq unë dhe duhet të punojmë të gjithë së bashku për të garantuar që fëmijët tanë të kenë mjete që iu nevojiten për të garuar në ekonominë globale, e cila vlerëson rritjen dhe aftësinë më shumë se çdo gjë tjetër. Tani jemi të lidhur me ekonominë botërore dhe duhet të përgatitemi të punojmë dhe të përparojmë brenda saj dhe standardeve të saj.

Të nderuar deputetë,

Janë siguruar mjete të nevojshme për planin e fillimit të kompjuterizimit dhe të informatizimit të të gjitha shkollave në Kosovë. Plani pilot-projekt ka përfunduar në vitin 2008. Janë siguruar mjetet e duhura për fillimin e projektit madhor apo të modelit "Silicon Valley" të Universitetit të Teknologjisë Informative apo të Fakultetit të Teknologjisë Informative në Prishtinë. Unë dua të besoj se në Kosovën do të mund ta bëjmë shembull të teknologjisë informative për rajonin dhe në këtë drejtim nuk do të kursejmë.

Po ashtu, po punojmë për të përmirësuar sistemin tonë shëndetësor. Kemi rritje të buxhetit mbi 15%, duke mos llogaritur grandet prej 23 milionë eurosh komunave për shëndetësi. Buxheti i Ministrisë së Shëndetësisë do të tejkalojë shumën e tërësishme prej 66 milionë eurosh. Pacientët do të përfitojnë nga oferta më e madhe e barërave esenciale dhe trajnimi i përmirësuar primar. Qytetarët tanë meritojnë dhe do të kenë kujdesin më të mirë shëndetësor që mund ta përballojmë, prandaj planifikojmë të kemi përmirësimin në ofrimin e shërbimeve mjekësore për secilin vit. Dua të theksoj se shëndetësia do të jetë prej prioriteteve tjera kryesore për vitin 2009.

Spektori i bujqësisë do të jetë prioritet i Qeverisë. Kemi rritje fillestare prej 40% të buxhetit për investime kapitale.

Po ripërtërijmë, po ashtu, edhe zotimin tonë për të mbrojtur dhe përkrahur komunitetet pakicë të Kosovës. Buxheti ynë për vitin 2009 drejton apo ka ndarë 8.7 milionë euro për Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, 7.5 milionë euro që shkojnë në projektin e konsoliduar për kthim. Kemi bërë zotim sipas planit të Presidentit Ahtisari të kujdesemi dhe të mbrojmë komunitetet pakicë të Kosovës dhe me këtë buxhet do të demonstrojmë se po përmbushim atë zotim me resurse kuptimplote të respektimit afirmativ të minoritarëve në Kosovë.

Këto shpenzime na vënë në rrugën drejt ofrimit të sigurisë më të madhe ekonomike për të gjitha familjet në Kosovë. Këto janë investime që ofrojnë vende të reja pune sot, por hapin perspektivë edhe më të mirë për nesër. Krijojnë infrastrukturën që do të ndihmojë në krijimin e vendeve më të mëdha të punës anekënd Kosovës në të gjithë sektorët. Ajo që ndoshta është më e rëndësishmja, është se Kosova mund të përballojë këto shpenzime me nivelin e tashëm të të hyrave dhe të zhvillimit.

Të nderuar e të respektuar deputetë,
Gjithashtu, në kuadër të agjendës shtesë dhe të plotësimit të të gjitha institucioneve shtetërore kemi edhe rreth 60 milionë që do të ndahen për Forcën e Sigurisë së Kosovës, e po ashtu edhe për Ministrinë e Jashtme dhe për Shërbimin Inteligjent të Kosovës.

Të nderuar deputetë,
Nëse ka një ide qendrore pas së cilës qëndrojmë unë dhe Qeveria ime, ajo është nevoja për të mësuar nga përvoja e demokracive të reja evropiane që dolën në vitet e 90-ta. Të gjitha këto vende u ballafaquan me sfidat e ngjashme, me të cilat ballafaqohemi ne sot, dhe me durim, me planifikim të kujdesshëm dhe me shpenzime të përgjegjshme iu treguan anëtarëve të atëhershëm të Bashkimit Evropian se demokracitë më të reja të Evropës e kishin vendin në mesin e tyre. Bashkimi Evropian sot është për 12 vende më i madh se sa që ishte para më pak se një dekade. Edhe Kosova, po ashtu, aspiron dhe do ta meritojë t'i bashkëngjitet Bashkimit Evropian dhe të marrë vendin e vet në bllokun tregtar dhe unionin ekonomik më dinamik të botës.

Nëse do të ndjekim shembullin e vendeve që me sukses iu bashkëngjitën Bashkimit Evropian, ne duhet t'i përmbahemi leksionit të tyre parësor. Sjellja e përgjegjshme sot do të sjellë prosperitet ekonomik nesër. Duhet t'u tregojmë miqve tanë evropian se jemi të aftë, ashtu si aspiruesit e mëhershëm të suksesshëm drejt Bashkimit Evropian, të bëjmë të njëjtat zgjidhje të vështira që bënë ata me qëllim të pozicionimit tonë të qëndrueshëm në ekonominë evropiane dhe globale të 10 dhe 20 viteve të ardhshme.

Duhet të ruhem i sot nga programet e kushtueshme ad-hoc që u ofrojnë përfitime afatshkurtra grupeve individuale, por që u shkaktojnë dëme të pariparueshme financave tona shtetërore dhe pengojnë rritjen tonë ekonomike. Disa besojnë se duhet të përdorim edhe euron e fundit që kemi për përfitime të grupeve të ndryshme në Kosovë. Kjo nuk do të ndodhë. Ne nuk mund ta bëjmë këtë. Kemi ndarë aq sa kemi pasur mundësi, në mënyrë të përgjegjshme për përfitimet e popullit tonë. Mirëpo, në interes të Kosovës duhet të mbajmë edhe një rezervë të mjaftueshme që do të na ndihmojë të përballojmë përkeqësimin e mundshëm të kushteve globale ekonomike ose eventualitetet e paparashikuara që kërkojnë resurse tjera buxhetore.

Ne duhet t'i balancojmë nevojat tona të tashme me nevojat tona për të ardhmen. Këto janë sfida të vështira për cilëndo qeveri dhe Qeveria e Kosovës nuk bën përjashtim. Nëse kërkojmë nga qytetarët e Kosovës të kuptojnë nevojën për përmbajtje dhe përgjegjësi, Qeveria duhet ta bëjë të njëjtin zotim apo të prijë me zotim. Populli shikon kah Qeveria dhe pyet në mënyrë krejt legjitime: pse zyra ime ose zyra e Presidentit ose Kuvendi duhet të kenë rritje të shpenzimeve nëse kërkohet nga qytetarët të jenë të përmbajtur dhe të përgjegjshëm. Dëshiroj t'i siguroj qytetarët e Kosovës se në Buxhetin e propozuar për vitin 2009 do të heqim dorë nga çfarëdo rritjeje të shpenzimeve në zyrën time, pra në zyrën e Kryeministrit, të Presidentit dhe në Kuvendin e Kosovës, një hap që e kemi marrë në konsultim me institucionet relevante dhe me vullnetin tonë të plotë. Kjo do të thotë se unë dhe zyrtarët e tjerë qeveritarë duhet të punojmë më shumë, të kursejmë edhe më shumë dhe së bashku të zotohemi të punojmë për këtë vend në mënyrën më të mirë të mundshme dhe për interesat madhore të qytetarëve. Kjo është ajo që populli e pret, kërkon dhe meriton prej nesh një shërbim qeveritar. Ky është edhe zotimi ynë, ky është vizioni ynë. Këto gjëra duhet për t'u bërë dhe kursimet që do të bëhen, do të drejtohen në rritje të rrogave për ata që punojnë në sektorin publik. Derisa bëjmë përpjekje për të forcuar sektorin privat, duke krijuar vende pune, që do të punësojmë qytetarët e Kosovës

për një brez të tërë, po ashtu duhet të mbajmë sektorin publik të fuqishëm në mënyrë që të ofrojmë shërbimet që i kërkojnë qytetarët tanë.

Në këtë buxhet unë propozoj apo kam vendosur një rritje të përgjithshme prej 10% për të gjithë shërbyesit tanë civilë. Ky është vetëm fillimi. Kjo rritje demonstroi brengën tonë të vazhdueshme për mirëqenien e atyre që punojnë për shtetin e Kosovës, që është njësoj e rëndësishme të mbajmë buxhetin tonë brenda kufijve të arsyeshëm. Kjo rritje ndodhë për herë të parë në Kosovën e pasluftës. Ky është niveli i rritjes të cilin ekonomia e Kosovës mund ta përballojë dhe të mbesë shëndoshë. Çdo rritje tjetër do të binte në dëm të investimeve në infrastrukturë dhe në prioritetet e tjera, në dëm të të ardhmes sonë dhe të fëmijëve tanë.

Me këtë buxhet, po ashtu, po rrisim pensionet bazike mujore për 12.5% - për 189.000 qytetarë që varen nga kjo pagesë për të mbuluar koston e jetesës.

Të nderuar deputetë,

Në të njëjtën kohë, pas rritjes së pensionit bazë, ne kemi paraparë një rritje të të gjitha skemave sociale dhe kjo ndodhë për herë të parë në Kosovën e pasluftës. Në përgjithësi, pagesat e pensioneve përbëjnë më shumë se 13.5% të buxhetit, më shumë se 150.000.000 euro. Ne nuk mund t'i harrojmë e as injorojmë ata të cilët kanë më së shumti nevojë për ndihmën tonë, por po ashtu duhet të krijojmë një ambient të fuqishëm ekonomik, me të cilin nevoja për ndihmë të posaçme dhe asistencë sociale do të zvogëlohet me kohë. Do të dëshiroja të jemi në gjendje t'u ofrojmë rritje më të madhe të pagave dhe të pagesave më të mëdha të pensioneve për të kënaqur secilin thirrje për asistencë dhe shpenzim prej buxhetit tonë.

Kam besim se me kohë do të arrijmë një barasvlerë më të lartë të pagave me pjesën tjetër të Evropës. Por, tani për tani duhet të kuptojmë se ende po ndërtojmë dhe ende po rimëkëmbemi pas konfliktit të viteve të keqmenaxhimit fiskal dhe, si një vend i pavarur, vetëm sa kemi filluar rrugën drejt rritjes së qëndrueshme ekonomike, drejt mirëqenies sociale.

Zonja dhe zotërinj,

Ju konfirmoj se pas pak kohe, Kosova do të jetë me meritë anëtare e Fondit Monetar Ndërkombëtar, e Bankës Botërore dhe e të gjitha institucioneve tjera relevante financiare ndërkombëtare. Tani kemi nevojë të tregojmë vendosmëri dhe ndjenjë të përgjegjësisë së përbashkët në sferën ekonomike, ashtu siç patëm demonstruar para botës gjatë viteve të sakrificës, të vështirësive dhe të betejave politike, të cilat i fituam bashkërisht. Këto sakrifica politike sollën rezultate të mëdha me kalimin e kohës, me ushtrimin e përgjegjësisë ekonomike, që do ta bëjmë të njëjtën gjë në vitet që do të vijmë.

E ardhmja është e ndritur për Kosovën. Këtë e besoj fuqishëm, duke instaluar qeverisjen e mirë dhe zotimin tonë për qeverisje të mirë dhe për proces integruar.

Në vitin që vjen do të privatizojmë, të nderuar deputetë, industrinë që ende kanë vështirësi për shkak të modeleve të paefektshme socialiste. Këto veprime do të gjallërojnë ekonominë tonë. Do të privatizojmë ndërmarrjet kyçe ekonomike në sektorë të energjisë dhe të telekomunikacionit "Vala 900", duke nxitur krijimin e vendeve të reja të punës në industrinë private. Ne nuk mund të bëjmë dallim nga bota e përparuar, nga bota moderne. Ndryshimet më të mëdha do t'i shohim në sektorin e energjisë me dhënien e projektit për

termocentralin “Kosova e re” për fillimin e zhvillimit dhe ndërtimit të këtij projekti, për privatizimin e pjesës së KEK-ut që merret me distribuim dhe furnizim.

Ashtu, siç e dinë qytetarët tanë, duhet t’i kryejmë këto reforma në industrinë e energjisë shpejt dhe në mënyrë të vendosur, jo vetëm që do të ofrojmë furnizim stabil e të sigurt me rrymë për popullin, por po ashtu që të ofrojmë bazën për investime në ekonominë tonë. Ne duhet njëherë e përgjithmonë të ndahemi nga tetëvjeçari i territ kosovar.

Secila kompani apo biznes do të investojë para në Kosovë vetëm nëse mund të ofrohet një burim i sigurt i energjisë elektrike. Pra, asnjë biznes nuk mund të ofrojë investim në Kosovë nëse nuk ka sektor të qëndrueshëm, efektiv dhe solid të energjisë. Infrastruktura jonë energjetike është tmerrësisht e vjetruar dhe edhe kur funksionon me efikasitet maksimal, është e pamjaftueshme për të plotësuar kërkesat tona.

Kushtet e tanishme do të kërkojnë nga ne të investojmë miliona të tjerë eurosh në vitin e ardhshëm për të subvencionuar KEK-unë në mënyrë që të sigurohet prodhimi i rrymës, transmetimi i saj nëpër pajisjet e vjetruara dhe importi për të mbuluar mungesat në prodhimin enorm. Kjo merr një hisë të madhe të resurseve tona financiare. Duhet dhe do t’i eliminojmë këto rrjedhje nga buxheti ynë nëpërmjet politikës së privatizimit, që e ka shpallur Qeveria, dhe do të ndjekim atë me vendosmëri serioze dhe transparencë të plotë. Me privatizimin nuk do të kemi më nevojë të ndajmë para për të subvencionuar dhe mirëmbajtur infrastrukturën tonë të dërmuar energjetike gjatë viteve të ardhshme. Partneri ynë i ri privat do të marrë përgjegjësinë për të siguruar furnizimin tonë me rrymë dhe mirëmbajtjen e rrjetit. Për këtë arsye, buxheti ynë do të bëhet më fleksibil me kalimin e kohës, me aftësi për të plotësuar nevoja dhe kërkesa të tjera të rëndësishme. Në shumë mënyra, viti 2009 është i rëndësishëm për tranzicion për ne.

Të nderuar deputetë,

Dëshiroj të prezantoj para jush edhe politikat fiskale në kontekst të Buxhetit për vitin 2009.

Buxheti për vitin fiskal 2009, nga një aspekt tjetër pasqyron edhe bashkëpunimin tim dhe të kabinetit qeveritar me bizneset kosovare. Ka qenë zotim, është qëllim dhe vizion, por edhe punë e përditshme e kabinetit që udhëheq unë, por edhe i imi, ndërtimi dhe thellimi i partneritetit me komunitetin e biznesit kosovar për të krijuar kushte e siguri për investimet e huaja në Kosovë.

Ne jemi zotuar në fillim të qeverisjes sonë për të zgjidhur çështjet e pengesave nga më të ndryshmet, si: përmirësimin e infrastrukturës; avancimin e sistemit tatimor dhe eliminimin e pengesave të tjera me qëllim të mundësimin të një klimë sa më të favorshme investuese në dobi të bizneseve dhe të zhvillimit ekonomik në përgjithësi. Këto ndryshime kanë refleksionet e veta në buxhetin e propozuar, shikuar nga struktura e të hyrave. Ne jemi kujdesur që rishikimi i sistemit tatimor të mos rrezikojë apo vështirësojë mundësinë për të gjeneruar të hyrat e nevojshme për Qeverinë. Gjithashtu, jemi kujdesur dhe kemi propozuar veprime për të arritur parimin e drejtësisë sociale për të gjitha kategoritë përfituese, duke u kthyer përmes rritjes së pagave të ngritura për mësimdhënësit rreth 30%, të pagave të shërbyesve civilë dhe rritjes për përfituesit e skemave sociale.

Të nderuar deputetë,

Edhe rritja e pagave për mësimdhënësit në Kosovë ndodhë për herë të parë pas luftës në këtë nëntëvjeçar, rreth 30%.

Të nderuar deputetë,

Në këtë kontekst, Qeveria ka përgatitur dhe dorëzuar në Kuvend për miratim një pako prej 4 pikash të projektligjeve: për tatimin për vlerën e shtuar; për tatimin e të ardhurave të korporatave; për tatimin e të ardhurave individuale dhe për normën e akcizës.

Ne kemi propozuar uljen e normave tatimore në të ardhurat e korporatave nga 20 në 10% me qëllim që t'i ndihmojmë bizneset për zvogëlimin e kostos së operimit dhe të shtojnë investimet e tyre, ndërsa për të ardhurat individuale dhe pagat kemi propozuar ulje nga 5 në 4%, nga 10% në 8%, nga 20% në 10%. Të hyrat e zvogëluara nga kjo do të kompensohen me ngritjen e performancës në agjencionet mbledhëse dhe me një ngritje të vogël tek tatimet indirekte, që do të thotë se Qeveria e Republikës së Kosovës ka adaptuar agjendën në favor të rritjes ekonomike me qëllim të përkrahjes së sektorit privat, të tërheqjes së investimeve të huaja direkte duke sjellë normat ndër më të voglat dhe më konkurrentet në rajon.

Të nderuar deputetë,

Siç jeni në dijeni, Qeveria e Republikës së Kosovës buxhetin vjetor e ka instrumentin kryesor për ofrimin e politikave prioritare para jush dhe qytetarëve të Kosovës, përmes të cilit ofrojmë zgjidhje në përmbushjen e prioriteteve dhe marrjen e përgjegjësi për përbalimin e sfidave të kohës. Andaj, edhe në kontekstin e krizës financiare të ekonomisë botërore, e kemi trajtuar me shumë kujdes që përmirësimin e normave tatimore dhe rritjen e investimeve publike nga ana e Qeverisë për vitin fiskal 2009 dhe planifikimin afatmesëm të shpenzimeve 2009-2011 t'i përdorim si dy leva të rëndësishme në funksion të minimizimit të efekteve negative dhe të shtrëngesave eventuale për zhvillimet ekonomike.

Zonja dhe zotërinj,

Deputetë, ministra,

Gjersa viti 2008 shënoi vitin e pavarësisë sonë politike, shpresoj dhe besoj se viti 2009 do të bëjë hapa të parë drejt pavarësisë ekonomike të Kosovës. Gjersa i bëjmë këta hapa drejt rritjes së ekonomisë sonë, ata i bëjmë të gjithë së bashku. Secili qytetar në këtë vend ka një rol dhe obligim në përpjekjen tonë të përbashkët për të modernizuar dhe forcuar shtetin tonë. Duhet të sakrifikojmë joshjen e shpenzimeve të menjëhershme financiare që Kosova nuk mund t'i përballojë për premtimin e rritjes ekonomike nesër. Ne dhe secili prej nesh në tërë vendin tonë duhet të përkrah industrinë tona, të paguaj taksat dhe faturat e energjisë në mënyrë që të ndajmë në mënyrë të barabartë dhe të drejtë barrën e financimit të rritjes ekonomike dhe t'i demonstrojmë botës se jemi një shtet i rregullt dhe i ligjit.

Duhet ta bëjmë të qartë se Kosova është një destinacion atraktiv për investim dhe se jemi serioz në lidhje me bashkëngjitjen Evropës dhe marrjen pjesë në përgjithësi në benificionet që kjo anëtarësi ofron. Ne jemi në Evropë, por bashkësia ndërkombëtare do të shikojë të bëmat dhe veprimet tona për të gjykuar nëse jemi apo nuk jemi evropian, nëse jemi apo nuk jemi të gatshëm të qëndrojmë në vete dhe të marrim përgjegjësitë për të ardhmen tonë, për të ardhmen demokratike, moderne, integruese, zhvillimore.

Me një buxhet serioz dhe të përgjegjshëm dhe me një demonstrim nga ana e të gjithë qytetarëve tanë, për fuqinë dhe vendosmërinë e tyre, do t'i tregojmë botës se jemi të gatshëm për të marrë vendime të vështira, por të duhura. Kjo do të dëshmojë se i kuptojmë përgjegjësitë që vijnë me pavarësinë, se jemi të gatshëm t'i lëmë anash trashëgimitë e konflikteve dhe modelet e dështuara ekonomike dhe t'i përkushtohemi ndërtimit të një vendi të ri, stabil dhe dinamik, në zemër të Evropës.

Të nderuar deputetë,

Projektbuxheti i vitit 2009 është buxheti i Kosovës ndryshe, i Kosovës për qeverisje të mirë, i Kosovës prosperuese, i Kosovës me mirëqenie sociale. Ju ftoj të gjithëve që me respektin më të lartë t'i jepni mendimet dhe propozimet tuaja dhe të përkrahni këtë projektbuxhet për vitin 2009. Faleminderit për vëmendjen tuaj!

KREYTARI: Faleminderit, zoti Kryeministër! Fjalën tash e merr ministri për Ekonomi e Financa, zoti Ahmet Shala.

MINISTRI AHMET SHALA: I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj,

Është nder dhe privilegj i imi i veçantë që si ministër i Ekonomisë dhe Financave të paraqes sot para jush Buxhetin e vitit 2009.

Dihet se hartimi i buxhetit është një detyrë e vështirë dhe me shumë sfida për të gjithë ne, i cili po thuaj do të ishte i pamundur pa mirëkuptimin dhe mbështetjen e plotë politike të krerëve të shtetit të Kosovës. Në këtë kontekst, më lejoni t'i shpreh falënderimet dhe mirënjohjet e mia më të singerta Kryeministrit të Kosovës dhe dy zëvendëskryeministrave për përkrahjen e vazhdueshme në këtë sfidë, por edhe shansin tonë të përbashkët.

Falënderim i posaçëm iu dedikohet kolegëve të mi – ministra, të cilët e kanë kuptuar dhe mirëkuptuar peshën dhe rëndësinë e këtij momenti, duke reduktuar mbase në maksimum disa nga kërkesat legjitime të sektorëve që ata mbulojnë për t'i hapur rrugë të qëndrueshme vizionit të përbashkët të stabilitetit afatgjatë të shtetit tonë.

Falënderoj me sinjeritetin më të lartë Komisionin për Buxhet dhe Financa të Parlamentit të Kosovës për kontributin dhe sugjerimin e tyre, si dhe grupet parlamentare me të cilat jemi konsultuar dhe i vlerësojmë vlerësimet e tyre.

Një buxhet i hartuar mirë pikësëpari duhet t'i plotësojë nevojat e ekonomisë së vendit, duke treguar përgjegjshmëri fiskale ndaj atyre që kontribuojnë në krijimin e buxhetit, pra taksapaguesve të Kosovës. Në anën tjetër, ne doemos duhet të jemi koshient ndaj ndihmës së komunitetit ndërkombëtar, i cili jep po ashtu edhe vlerësime të vazhdueshme për punën dhe përgjegjshmërinë tonë. Është ky një fakt, realitet dhe obligim për të cilin jemi zotuar.

Qeveria e Republikës së Kosovës dhe ne, si Ministri e Ekonomisë dhe Financave, jemi të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm ndaj këshillave profesionale të Fondit Ndërkombëtar

Monetar, institucion në të cilin kemi aplikuar për anëtarësim, dhe proces i cili është në rrugë të mbarë për t'u realizuar dhe besoj në pranverë të vitit të ardhshëm do të jemi anëtar të plotë të tij dhe Bankës Botërore.

Ky institucion, dy vite më parë i ka rekomanduar Qeverisë së Kosovës rregullën fiskale, e cila vendos një kufi buxhetor prej 0,5% të rritjes vjetore të shpenzimeve operative. Kjo rregull duket të jetë e logjikshme dhe e dobishme për rrethanat ekonomike të Kosovës dhe të institucioneve në përgjithësi në Kosovë, andaj Qeveria e Kosovës atëbotë e ka pranuar si rregull të tillë dhe ne jemi duke e respektuar.

Dua t'ju rikujtoj, gjithashtu, se ky buxhet është hartuar duke pasur gjithmonë parasysh kornizën afatmesme të shpenzimeve. Ky buxhet, po ashtu, në mënyrë të drejtpërdrejtë adreson nevojat e vitit të ardhshëm, por në realitet, natyrshëm do të ketë ndikime edhe për vitet në vijim.

Dihet mirëfilli se korniza afatmesme e shpenzimeve, e miratuar në korrik të këtij viti, është quajtur ndër të tjera edhe si hap i parë i Kosovës në rrugën e saj drejt një rritjeje dhe zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm e afatgjatë.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që tani të paraqes në hollësi buxhetin e shtruar para jush. Në rrethana të kërkesave të shumta të nevojave të rëndësishme dhe legjitime, por edhe të një presioni nga pritjet e mëdha, objektivi ynë kryesor ka qenë të mbajmë një pozitë të qëndrueshmërisë dhe kredibilitet fiskal.

Ne duhet patjetër të gjenerojmë rritje ekonomike. Ne duhet të krijojmë një mjedis ku sektori privat do të mund të rrisë aktivitetin e tij dhe të fillojë të krijojë më shumë vende të reja pune. Në të njëjtën kohë, ne duhet të jemi të vetëdijshëm për kërkesat e punonjësve, për rroga më të larta për punën që bëjnë. Në të njëjtën kohë, duhet po ashtu të kemi parasysh edhe kujdesin për pjesën e popullatës, e cila është në pozitë jo të mirë sociale. Sipas buxhetit të propozuar, shpenzimet primare për vitin 2009 arrijnë shumën prej 1.094.300.000 euro. Duke ia shtuar kësaj shume huanë për sektorin e energjisë, shërbimin e pritshëm të borxhit, si dhe rezervën stabilizuese, totali i përgjithshëm arrin në shumë prej 1.430.000.000 euro, që është rreth 35% të GDP-së, përkatësisht të bruto prodhimit vendor, shifër mjaft signifikante karshi edhe shteteve në zhvillim.

Duke pasur parasysh madhësinë e ekonomisë sonë, kjo shumë e paraparë për Buxhetin e vitit 2009 paraqet një shifër sinjifikante. Ky buxhet ofron një stimulim fiskal për një rritje të parashikuar të ekonomisë në nivel prej 6% gjatë vitit 2009, e cila njëkohësisht është edhe platforma e parë për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik e social. Parashikimi i të hyrave të rregullta buxhetore llogaritet të jetë 956.000.000 euro. Këto të hyra, krahasuar me të hyrat e vlerësuara për vitin 2008, janë më të larta përreth 8%, ndërsa krahasuar me vitin 2007, duke mënjanuar të hyrën e njëhershme të operatorit të dytë të telefonisë mobile, të hyrat e pritshme për vitin 2009 do të jenë mbi 16% më të larta. Këto të hyra janë bazuar në faktorët makro-ekonomikë, si në vijim:

- Bruto produkti vendor nominalisht do të ketë një rritje prej 10%;
- Konsumi, rritje 6%;
- Investimet, rritje 27%;
- Eksporti, rritje 17%;

- Importi rritje prej 13%.
- Ndërsa, rritja reale e bruto-produktit vendor është 6%.

E di që do të dëgjoni dhe keni dëgjuar mbase deri më tani edhe vlerësimet e tjera, e kam përsëritur dhe dua të përsëris prapë. Ky vlerësim është në përputhje të potë me metodologjitë edhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe, nëse mobilizohemi të gjithë, ne do ta arrijmë ta ruajmë këtë rritje.

Pavarësisht rritjes së projektuar të të hyrave në raport me vitet paraprake, shpenzimet e planifikuara janë më të larta se të hyrat e projektuara.

Si rrjedhojë të kësaj, bilanci primar gjeneron një boshllëk financiar për 137,8 milionë eurosh, ndërsa totali i ndryshimit mes të hyrave të rregullta buxhetore dhe totalit të ndarjeve buxhetore, që është 474 milionë euro, planifikohet të mbulohe nga bilanci i akumuluar bankar -249 milionë euro, nga të cilat 131,2 do të jenë nënshpenzim për buxhetin e vitit 2008. kthimi i huas së KEK-ut -159,4 milionë dhe nga ndihma e komunitetit ndërkombëtar prej 64,9 milionë euro.

Dua të theksoj se ky boshllëk financiar, si rezultat i përgjegjësiave tona të reja, të cilat rezultojnë nga pavarësimi i Kosovës, duke përfshirë këtu komunat e reja, ministritë e reja dhe përgjegjësitë e tjera. Pra, dua të theksoj se ky boshllëk është si rezultat i krijimit të institucioneve të reja.

Në vijim, po jap disa nga pikat kryesore të ndarjeve buxhetore për vitin 2009.

Në Buxhetin e vitit 2009 është përfshirë krijimi i një rezerve stabilizuese fiskale prej 200 milionë eurosh. Nuk duhet të harrojmë se në pamundësi për të pasur një politikë monetare, si pasojë e mungesës së valutës sonë, mundësi kontrolli mbi norma të interesit, Kosova është shumë pak e mbrojtur nga ndikimet të paparashikuara, siç mund të jenë: çmimet e tregjeve botërore të naftës, që ishim dëshmitarë të vitit të kaluar deri më tani, të grurit, krizat financiare që jemi dëshmitarë tani. Prandaj, një rezervë e tillë prej 200 milionë shihet si një masë, e cila do të na mundësojë intervenim të shpejtë dhe të suksesshëm për të ulur sadopak efektet që do të mund të kishin këto lloj ndikimesh në ekonominë e Kosovës.

Në kuadër të shpenzimeve kapitale, ndarjet buxhetore janë bazuar në prioritetet kryesore të Qeverisë së Kosovës. Shuma totale për kategorinë e shpenzimeve kapitale do të jetë rreth 413 milionë euro. Kur kësaj shume i shtohet huaja e KEK-ut, ajo arrin shumën totale prej 493 milionë euro.

Një ndarje e tillë buxhetore mundëson që taksapaguesit t'i kthehen taksat në mënyrën më të shpejtë, më afatgjatë dhe më të drejtpërdrejtë, duke i përmirësuar nivelin e jetesës, si dhe duke ua mundësuar bizneseve konkurrencë më të lartë.

Një pjesë e konsiderueshme e buxhetit për shpenzime kapitale, rreth 103 milionë euro, janë dedikuar për infrastrukturën rrugore.

Rreth 38 milionë € janë ndarë për sektorin e arsimit, ku shumica e këtyre mjeteve do të përdoren për ndërtimin e shkollave të reja, dhe mbi 95 milionë € për sektorin e energjisë,

mjete të cilat do të përdoren për hapjen e minierës së re të Sibovcit, 80 milionë €, dhe për mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes prej 15 milionë €.

Përfitues më i madh janë komunat, përmbi 100% rritje karshi vitit vijues, andaj thërras kryetarët e komunave dhe menaxhmentet komunale që të përmbledhin gjithë forcat mobilizuese në mënyrë që planifikimet e tyre mos të mbesin në suficit në fund të vitit të ardhshëm.

Të nderuar deputetë,

Një ndër objektivat e rëndësishme të Qeverisë është që të hiqet barra e presionit që i bëjnë Buxhetit të Kosovës ndërmarrjet publike.

Siç e tha edhe Kryeministri, ne jemi shumë të vendosur që të ecim përpara me privatizimin, furnizimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike deri në fund të vitit 2009, të zgjedhim fituesin për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, zhvillimin e hidrocentralit në Zhur dhe të shumë hidrocentrale të tjera më të vogla.

Një objektiv tjetër i rëndësishëm të cilin e kemi për qëllim që ta përmbylлим deri në fund të vitit 2009, është edhe dhënia e koncesion e Aeroportit të Prishtinës, proces i cili tanimë ka ecë mjaft përpara.

Përfshirja e sektorit privat në Posttelekomunikacionin e Kosovës dhe fillimi i procedurave për involvimin e sektorit privat në Kombinatin “Trepça”.

Të gjitha këto iniciativa, do të thosha shumë të mëdha dhe me interes strategjik për Kosovën, janë bërë nën frymën e tërheqjes së investitorëve të rangut botëror në sektorët kyç të ekonomisë dhe të cilat, përveç efektit që do të kenë në performancën ekonomike të Kosovës, pa dyshim do të ndikojnë edhe në gjenerimin e vendeve të reja dhe të qëndrueshme të punës.

Ndër iniciativat tjera, duhet të theksoj se ne jemi duke shikuar mundësinë për zhvillimin e partneritetit privato-publik në sektorët tjerë, në shëndetësi, kulturë, arsim e tjerë, kudo që një gjë e tillë do të mund të sjellë përmirësimin e produktivitetit, si dhe ulje të kostos së prodhimeve, gjegjësisht të operimeve.

Efekti i kësaj iniciative do të mund të vërehet pik së pari në sektorin privat, por në fund të fundit, do të jenë konsumatorët ata që do të përfitojnë jo vetëm nga shërbimet më të mira, por edhe nga çmimet më të ulëta për shërbimet që do t’u ofrohen atyre.

Siç përmenda më herët, nga buxheti i Kosovës parashihen të ndahet një kredi prej 80 milionë € për Minierën e Sibovcit, ndërsa një shumë mbi 30 milionë € parashihet për importin e energjisë elektrike gjatë vitit 2009, duke i shtuar edhe pjesën për sociale dhe pjesën e planifikuar më herët, shuma prej 45 milion €.

Të gjithë e dimë se KEK-u ka qenë dhe është një barrë e madhe për buxhetin e Kosovës dhe, padyshim, çdo njeri nga ne pyet, edhe sa kohë mund të qëndrojmë kështu. Përgjigja më e saktë është dhënë për Projektbuxhetin e vitit 2009.

Qeveria e Kosovës tanimë ka strategjinë e vet në këtë drejtim. Kredia prej 80 milionë € për vitin 2009, së bashku me kredinë prej 79 milionë € për renovimin e eskavatorëve dhe të pajisjeve të tjera të nevojshme për minierën e re të Sibovcit, si dhe për renovimin e “Kosovës A” do të përfshihen si pako në “Kosovën e Re”. Kredia që i ofrohet KEK-ut do t’i kthehet buxhetit të Kosovës nga konzerciumi që do të fitojë “Kosovën e Re”. Pra, 159 milionë € do t’i kthehen buxhetit të Kosovës dhe KEK-u nuk do të jetë më një barrë e buxhetit, përkatësisht e taksapaguesve të Kosovës.

Shuma prej 40 milionë euro për import ka për qëllim të sigurojë furnizimin me energji për qytetarët, por edhe për bizneset. Pas privatizimit, siç e ceka më lart, nuk do të ketë më shpenzime nga buxheti për importin e energjisë.

Për sa i përket shpenzimeve të tjera, përveç rrogave të mësimdhënësve, të cilët tanimë janë përfitues sinjifikantë në rritje të pagave, siç u përmend edhe në fjalimin e Kryeministrit, planifikojmë dhe është projektuar në mënyrë të saktë që rritja fillestare e Buxhetit për vitin 2009 të jetë 10% për të gjithë shërbyesit civilë që ka një kosto totale prej 14 milionë €. Rritje të tilla në sektorin e pagave dhe në sektorin e pensionistëve mund të planifikohen për vitet e ardhshme. Kemi paraparë, gjithashtu, një rritje prej 12,5% të pensioneve bazë, të asistencës sociale, shumë e cila përfshinë 11,3 milionë euro.

Në qoftë se këtyre rritjeve i shtohet edhe zvogëlimi i taksave që në mesatare, varësisht prej rrogës, vjen prej 1 deri në 4%, atëherë rritja reale e pagave kalon 12 – 13%.

Këtu dua të shtoj, gjithashtu, se Qeveria është duke përgatitur të ashtuquajturën Letrën e bardhë për politikën sociale, e cila do të analizojë strukturat ekzistuese. Nëse shihet e arsyeshme dhe e nevojshme, do të bëjmë sugjerime me objektivin për të arritur një qëndrueshmëri edhe më të madhe fiskale.

Tani, më lejoni që të prezantoj para jush buxhetet e disa prej ministrive dhe të organizatave të tjera buxhetore, për të parë ndryshimet në mes të këtij propozimbuxheti dhe buxhetit të vitit 2008, ose edhe ndonjë shembull të vitit 2007.

Siç u përmend nga Kryeministri, kemi dhe dua të falënderoj Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, të gjithë juve dhe, natyrisht, Kryeministrit për kuptimin e saktë të momentit dhe pranimin për të zvogëluar shpenzimet e tyre ose për të kursyer, më mirë të themi, deri në shkallë 20%, si vijon: Kuvendi 3,3% zvogëlim, Zyra e Presidentit 4,5%, Zyra e Kryeministrit 19,5%. Ky është mesazhi më i fortë politik për të gjithë qytetarët e Kosovës se lidhshëpi i tyre e kupton momentin politik dhe ekonomik të Kosovës.

Ministria e Shërbimeve Publike në vitin 2009, rritje prej 40,6%, viti 2009 karshi me vitin 2007 165,7%.

Ministria e Bujqësisë, rritje 40% në këtë vit.

Ministria e Tregtisë, rritje 59,5% ose vitin 2007 – 2009, 156%.

Ministria e Shëndetësisë, rritje në këtë vit 14,5%.

Ministria e Kulturës, 17,1%.

Ministria e Arsimit në buxhet, do ta shihni, ka zvogëlim prej 22%, por kjo është sepse ju ka hequr universiteti për disa shpenzime kapitale, por në fakt ka një qëndrueshmëri të njëjtë po thuaj se me vitin e kaluar.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, 1,4%.

Ministria e Administratës dhe Qeverisjes Lokale, 121,5%.

Ministria e Drejtësisë, 6,2%, e kështu me radhë.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha këto ndryshime të përmendura më herët, së bashku me ndryshimet e paraqitura nga Qeveria më parë rreth tatimit në të ardhura fitim, tatim në të ardhura, tatimit në fitim, si objektivi primar kanë që pikë së pari përfituesi i këtyre nismave dhe ndryshimeve të jenë qytetarët e Kosovës dhe ambienti investues në Kosovë.

Qeveria, gjithashtu, po bën përpjekje të vazhdueshme për të rritur efektivitetin edhe të administratës qendrore dhe lokale.

Buxheti i propozuar parasheh kursime të theksuara në mallra dhe shërbime, 10% në nivelin lokal dhe 15 deri në 40% në nivelin qendror.

Këso lloj kursimesh madje janë bërë edhe në instancat më të larta, siç e theksova edhe më lart, dhe kanë arritur shumë prej 3,4 milionë në tërësi.

Dua të theksoj këtu se këto shkurtime të shpenzimeve nuk janë bërë në dëm të funksionalitetit të institucioneve publike. Të gjitha këto masa të lartpërmendura i mundësojnë Qeverisë që të respektojë sa më shumë që është e mundur rregullin fiskal për shpenzimet rrjedhëse të sugjeruar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Siç e thashë edhe më herët, moto e hartimit të këtij buxheti ka qenë përgjegjshmëria fiskale dhe arritja e një pajtimi me rregullën e Fondit Monetar Ndërkombëtar. Për të arritur një gjë të tillë, është dashur një bashkëpunim, por njëkohësisht edhe ballafaqim me kolegët e mi në Qeveri dhe në institucione të tjera të Kosovës. Kjo arritje duhet të vlerësohet edhe më lart, duke marrë parasysh gjendjen e ekonomisë botërore tani, e cila padyshim është shumë më ndryshe nga ajo e vitit të kaluar. Tanimë të gjithë e dimë që bota po ballafaqohet me një krizë financiare të paparë në historinë moderne të tregjeve. Efektet e kësaj krize kanë filluar të ndihen në ekonominë reale të këtyre vendeve dhe të vendeve në regjion.

Kosova, me ekonominë e saj modeste ka një deficit tregtar prej 40% të GDP-së. Kjo na bën të jemi shumë të ekspozuar ndaj ekonomisë botërore dhe nuk guxojmë në asnjë mënyrë të mendojmë se ne disi jemi të izoluar nga zhvillimet ekonomike botërore. Prandaj, ne ndoshta më tepër se çdo vend tjetër i regjionit duhet të jemi gjithmonë të vetëdijshëm dhe agjil rreth zhvillimeve ekonomike botërore, të cilat po thuaj se janë jashtë çdo kontrolli tonë.

Siç e theksova edhe më herët, ne nuk kemi mundësi të një politike monetare. Politika mbase e vetme fiskale që është në disponim tonë, është buxheti. Pra, ky instrument është i vetmi, i cili mundëson një menaxhim ekonomik për qëndrueshmërinë ekonomike dhe fiskale. Është shumë me rëndësi që të gjithë ne të jemi të vetëdijshëm se çfarë pengesash dhe vështirësish paraqet një gjendje kur buxheti duhet të shfrytëzohet për të zëvendësuar mungesën e një politike të mirëfilltë monetare.

Megjithatë, dua edhe njëherë të ritheksoj faktin se gjatë vitit 2009 ekonomia e Kosovës pritet të rritet në një normë prej 6%. Kjo nuk do të thotë se nuk i kemi marrë parasysh mundësitë e ndikimit negativ të trendeve globale në ekonominë tonë, por kjo në fakt tregon se politikat tona do të bëjnë që efektet e mundshme negative të jenë më pak të ndjeshme tek qytetarët tanë.

Investimet e mëdha kapitale të projekteve produktive, vendimi për privatizimin e numrit të ndërmarrjeve publike, ndryshimi në politikat tatimore, si dhe masa të tjera të Qeverisë do të bëjnë që ekonomia e Kosovës të vazhdojë të ketë ritme pozitive edhe në vitin vijues.

Ne në një linjë me ecuritë e Fondit të Ekonomive Botërore, në vijimësi do të monitorojmë progresin tonë në raport me politikat e paraqitura në buxhet.

Prandaj, të nderuar deputetë, duhet të shihni këtë buxhet nga ky këndvështrim dhe, padyshim, përkrahja e juaj në këtë drejtim është shumë e çmueshme.

Buxhetin, të cilën e paraqes sot para jush, kohë më parë është miratuar nga Qeveria e Kosovës. Ne jemi shumë të vetëdijshëm se jo të gjithë do të mbeten të kënaqur me këtë buxhet. Por, në fund të fundit, buxheti lë edhe njerëz të pakënaqur. Në rastin e Kosovës, duke pasur parasysh kapacitetet e kufizuara buxhetore, ndoshta numri i njerëzve të pakënaqur mund të jetë një çik më i lartë.

Por, ajo që dua të theksoj këtu, si ministër i Ekonomisë dhe i Financave të Republikës së Kosovës, është se përkundër kufizimeve që i përshkrova më lart, ne jemi përpjekur që të hartojmë një buxhet i cili do të shërbejë si masë e një përgjegjësie të lartë fiskale ndaj një kornize dhe vizioni të politikës makro-ekonomike, e cila do të kontribuojë drejt në një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Nëse dikush zgjedh të kritikojë këtë buxhet, atëherë nuk do të ishte e drejtë dhe as e mirë që kjo të bëhet në pjesë të veçanta, në pjesë të izoluara. Ky buxhet duhet të shihet si pjesë përbërëse e të ardhmes së Kosovës. Nëse dikush ka kritika për një komponent të veçantë të këtij buxheti, atëherë do të duhej të ofroheshin alternativa se çfarë do të ndryshohej dhe si do të ndikonin ato ndryshime në kornizën e përgjithshme dhe cilat do ishin përfitimet e atij apo të atyre ndryshimeve.

Pra, buxhetin që kemi para jush, nuk duhet të shihet si një komponent e ndarë, e shkëputur, e izoluar, por si pjesë përbërëse e një plani dhe kornize afatmesme të zhvillimit ekonomik. Ne nuk duhet të harrojmë se të gjitha veprimet dhe aksionet tona monitorohen vazhdimisht nga ata të cilët na kanë ofruar përkrahje financiare, teknike, por edhe politike. Ne duhet të tregojmë përgjegjshmërinë tonë para miqve tanë ndërkombëtarë, të cilët kanë qëndruar gjithnjë pranë nesh këto vite të vështira, por shumë domethënëse për të ardhmen e Kosovës. Por, gjithsesi, përgjegjësia jonë më e madhe është ndaj popullit të Kosovës dhe të ardhmes së tij.

Prandaj, në emër të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, kërkoj nga ju që të pranoni dhe votoni këtë buxhet, si shenjë e kontributit tuaj për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër, për kohën e shfrytëzuar!

Sipas radhës, fjala është për kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetin Gani Koci.

GANI KOCI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

I nderuari Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Do të përpiqem që të diskutoj më shkurt se sa Kryeministri edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave.

Dua të them paraprakisht se do të përpiqemi të jemi edhe të disiplinuar, kështu që të mos kritikojmë shumë buxhetin. Është fakt se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar paraprakisht propozimin e ofruar të Qeverisë së Kosovës dhe e ka miratuar dhe i rekomandon Kuvendit që po ashtu ta miratojë këtë projektbuxhet.

Ky ka qenë një konstatim i Komisionit për Buxhet edhe për vetë faktin se gjatë gjithë procesit buxhetor të krijimit të këtij projektbuxheti, Komisioni për Buxhet dhe Financa në mënyrën e vet ka qenë shumë aktiv. Anëtarët e këtij komisioni edhe veç e veç kanë qenë aktiv në kërkesat buxhetore të shumë agjencive buxhetore, por edhe si komision dhe në shumë raste sugjerimet e komisionit tonë Qeveria i ka pasur parasysh.

Përparësi e këtij projektbuxheti, siç e thanë edhe Kryeministri edhe ministri i Ekonomisë dhe Financave, është një fakt i pamohueshëm, sepse për herë të parë institucionet tona po bëjnë vetë një projektbuxhet, pa një ndërhyrje dhe pa një ndihmesë nga të tjerët edhe në kuptimin e projektimit të të hyrave, por edhe të shpërndarjes. Dhe, çështja tjetër, është projekti i parë i buxhetit në shtetin e Kosovës- në Republikën e Kosovës.

Ajo që Komisioni për Buxhet ka konstatuar, është se këtij projektbuxheti i paraprinë Korniza afatmesme e shpenzimeve, që është një dokument mbi bazën e të cilit është krijuar edhe ky projektbuxhet ose projeksionet buxhetore dhe i gjithë projektbuxheti është konceptuar mbi bazën e një analize të kriterëve makroekonomikë, po edhe të ndryshimeve të një politike fiskale që ka qenë e nevojshme, e domosdoshme për këtë fazë dhe për këtë periudhë që është një karakteristikë e veçantë. Pra, karakteristikë tjetër është, sepse për herë të parë pas kaq vitesh të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, kemi një rritje të pagave për shërbyesit civilë prej 10% , gjë që ndoshta nuk është krejt ajo që do të duhej të ishte, por megjithatë ka një lëvizje në këtë drejtim.

Meqë ky projektbuxhet është krijuar mbi bazën e një politike të re fiskale, Komisioni për Buxhet ka konstatuar se ky projektbuxhet nuk mund të implementohet në qoftë se nuk i paraprinë edhe miratimi i katër ligjeve dhe ne, si Komision për Buxhet, kemi bërë një kërkesë që ato katër ligje të jenë pjesë e shqyrtimit bashkë me këtë projektbuxhet. Pra, besoj që Kryesia e Kuvendit do të thërrasë një mbledhje të veçantë, ndoshta, që të procedohen ato katër projektligje që janë pjesë për realizimin dhe implementimin e këtij projektbuxheti.

Komisioni për Buxhet nuk ka cekur vërejtjet e shumta për vetë faktin se gjatë leximit të dytë, bashkërisht me Qeverinë, respektivisht me Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, do të shikojë se ku është e mundur brenda këtij kuadri buxhetor të bëhen lëvizje të caktuara dhe të plotësohen kërkesat dhe nevojat e shumë agjencive, të cilat kanë shtruar edhe pas ardhjes së këtij projektbuxheti, kërkesat e tyre të veçanta që në disa raste edhe mund të jenë të arsyeshme.

Dua të them edhe një qëndrim të Komisionit për Buxhet se në pjesën e shkurtimeve që u janë bërë Zyrës së Kryeministrit, Zyrës së Kuvendit dhe Zyrës së Presidentit, kur është fjala të Kuvendi, është dashur të bisedohet pak më gjatë rreth kësaj çështjeje, duke pasur parasysh vetë faktin se të gjitha donacionet që i ka pasur Kuvendi në mbështetje deri në këtë vit, nuk ekzistojnë më dhe pastaj nuk di sa do të mund të jetë funksional në këtë drejtim aktiviteti i Kuvendit për vitin 2009. Po ashtu, një problematikë që dua publikisht ta them këtu dhe që është diskutuar edhe në Komisionin për Buxhet, është pikërisht mënyra e financimit të disa agjencive të pavarura që kanë buxhetet e veta të veçanta dhe sidomos në pjesën e pagave dhe të mëditjeve. Pra, ka kërkesa që i tejkalojnë edhe mundësitë buxhetore dhe në këtë drejtim vërtet do të ishte mirë që edhe Kuvendi, bashkë me Qeverinë, të gjejnë një modus rreth zgjedhjes të kësaj problematike të buxhetimit të këtyre agjencive.

Dhe, krejt në fund, dua të them se ky projektbuxhet është ofruar rreth kësaj pjesës normative, por janë të diskutueshëm nenet 11 dhe 16 të cilët Komisioni për Buxhet, po ashtu, bashkë me Ministrinë dhe me kontributin e deputetëve, do ta analizojnë këtë pjesë. Dhe, është një çështje tjetër që nuk është më pak e rëndësishme, e që ka të bëjë me titullin e këtij projektligji. A është Projektligj për buxhetin e konsoliduar për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2009, a është Projektbuxhet, Projekt për ndarjet buxhetore për vitin 2009? Unë mendoj se edhe në pjesën normative përsëriten këto çështje, herë si Projektbuxhet i konsoliduar, herë si ndarje buxhetore, herë si fond i Konsoliduar i Kosovës, prandaj në këtë drejtim unë konsideroj se do të duhej të ishte Ligji për ndarjet buxhetore për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2009.

Zoti Kryetar, kam edhe një kërkesë, sepse unë në këtë rast fola si kryetar i Komisionit për Buxhet. Pra, po e shoh numrin e diskutuesve, që janë diku 40 veta, por ta kisha pasur këtë të drejtë në fillim, bile i 15- ti do të isha si deputet që të diskutoj. Prandaj, po ruaj edhe mundësinë që të diskutoj si deputet rreth këtij projektbuxheti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Jo, unë po ju njoftoj se nja 50 janë paraqitur për diskutim. E falënderojmë Qeverinë që e ka shfrytëzuar mirë kohën, pastaj mendoj që edhe ne kemi kohë sot e nesër.

Shkojmë sipas radhës. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, deputetja Safete Hadergjona e ka fjalën.

SAFETE HADERGJONAJ: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti Kryeministër,
Zëvendëskryeministra, anëtarë të Kabinetit qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Miratimi i Buxhetit për vitin 2009 ka arsyeshmëri të plotë, sepse për herë të parë kemi një buxhet të përgatitur mirë që mbështet progresin ekonomik, duke i marrë parasysh

prioritetet të Qeverisë dhe duke hapur perspektivën për thellimin e reformave për zhvillim.

Në materialin e ofruar janë paraqitur treguesit makroekonomikë të cilët i paraprijnë planifikimit të buxhetit, korniza makrofiskale, politikat prioritare të Qeverisë, politikat e reja fiskale që kanë qenë kërkesë e vazhdueshme për t'u krijuar lehtësi investitorëve të brendshëm e të jashtëm e që përmbliken në paketën e ligjeve të reja me reforma në Administratën Tatimore që reflektojnë në ndërtimin e një administrate fiskale efikase.

Ne sot kemi një material që i plotëson standardet e një dokumenti buxhetor, që na mundëson për herë të parë të votojmë bazuar në shifra reale e jo përmendësh, siç na ka ndodhur në të kaluarën.

Pjesa tekstuale e Projektligjit të buxhetit, sipas të cilës bëhet ndarja e mjeteve dhe rrjedha e menaxhimit të tyre, është e përgatitur dukshëm më mirë, kurse në pjesën tabelare vërejmë se fondet janë kanalizuar nëpër politika që janë shpallur si prioritete në programin e Qeverisë. Nëse i analizojmë me kujdes shifrat, vërejmë se janë ulur shpenzimet operative dhe mjetet janë përqendruar në projekte të rëndësishme kapitale, në: infrastrukturën rrugore, në energjetikë, në arsim, në shëndetësi, në bujqësi e tjera. Në këtë projektbuxhet vërehet një transparencë më e madhe, një efikasitet dhe efijencë në përdorimin e parave të taksapaguesve që është nga objektivat primare të Qeverisë.

Të hyrat buxhetore të projektuara për vitin 2009 janë 956 milionë €, që do të thotë 204 milionë € më shumë nga ato të projektuara në vitin 2008, duke arritur kështu 23% të bruto produktit vendor.

Nga kjo vërehet se politikat e reja fiskale do të kenë rolin nxitës në rritjen e investimeve dhe zgjerimin e bazës së tatimit, duke zvogëluar ekonominë informale dhe evazionin fiskal.

Të nderuar deputetë,
Shpenzimet e planifikuara buxhetore prej 1.094.300.000 € që përbëjnë 26% të bruto produktit vendor, mundësojnë rritjen e efektivitetit të institucioneve.

Siç u tha këtu edhe nga Kryeministri edhe nga ministri i Financave, për herë të parë pas tetë vjetëve Qeveria ka planifikuar rritje të pagave të shërbyesve civil, rritjen e pensioneve, ka bërë zvogëlimin e shpenzimeve operative në administratë, sidomos në institucionet e nivelit më të lartë dhe mjetet i ka drejtuar për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve publike, sidomos në arsim dhe shëndetësi.

Qeveria ka programuar fonde për t'i minimizuar implikimet e ekonomisë nga ndikimi i krizës globale.

Projektbuxhetin për vitin 2009 e karakterizon rritja e investimeve kapitale në vlerë prej 413 milionë eurove. Nëse e analizojmë me kujdes këtë projektbuxhet, vërejmë se Qeveria ka përdorur kriteret e qarta të vlerësimit të prioriteteve për investimet kapitale, në mënyrë që të arrihen efekte të pritshme nga investimet dhe janë përdorur kriteret e qarta dhe të drejta për shpërndarjen territoriale të investimeve kapitale, duke iu shmangur alokimeve ad-hoc, siç ka qenë praktikë në të kaluarën.

Ndarja e 37.800.000 eurove për investime kapitale në arsim bën të kuptosh se Qeveria ka vlerësuar mirë nevojën e investimeve në kapitalin njerëzor, duke u orientuar në krijimin e kushteve për një sistem cilësor shkollor, e bindur se investimi në arsim është faktor që ka ndikim në rritjen dhe zhvillimin ekonomik, sidomos tek ne ku më se gjysma e popullsisë është nën moshën 23 vjeçare.

Ndarja e 103.000.000 eurove për ministrinë e Transportit dhe Postë Tetelekomunikacionit për prioritetet e saj sidomos në infrastrukturën rrugore në ndërtim apo për projekte të reja të rëndësishme, jep pa dyshim efekte në zhvillimin ekonomik.

Janë ndarë 12.500.000 € për investime kapitale në shëndetësi, ku prioritet i është dhënë Qendrës Klinike Universitare, për të cilën janë ndarë afër 5.000.000 euro, duke mos lënë anash as spitalet rajonale, si në Gjilan, Prizren, Gjakovë, Pejë, Mitrovicë, Vushtri, Ferizaj, e tjera.

Për Mjedisin dhe Planifikimin Hapësinor janë ndarë 10.200.000 euro për investime kapitale, të cilat janë orientuar në mbrojtjen e mjedisit dhe për burimet e ujit.

Investimet kapitale në bujqësi janë rritur nga 4.000.000 €, sa kanë qenë në vitin 2008. në 7.000.000 euro për vitin 2009.

Në investimet publike janë mbështetur, sidomos ministritë prioritare, si Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Forcës së Sigurisë.

Është rritur dukshëm buxheti i të gjitha komunave, sidomos në investimet kapitale.

Në komunën e Gjakovës buxheti është rritur për 2.880.000 €.

Në komunën e Prishtinës, për 7.033.000 €.

Në komunën e Prizrenit, për 5.400.000 €.

Në atë të Podujevës, për 2.800.000 €.

Në komunën e Glogocit, për 1.500.000 €.

Në komunën e Deçanit buxheti është rritur për 1.088.000 euro.

Rritje ka pasur, pothuajse në të gjitha komunat.

Nga kjo vërehet se Qeveria është treguar e gatshme për të investuar në projektet për ta konsoliduar zhvillimin nëpër komuna, është treguar e gatshme për të investuar në projektet ku përfiton taksapaguesi dhe rritet mirëqenia e qytetarëve.

Qeveria nëpërmjet këtij buxheti investon në të tashëm dhe në të ardhmen e Kosovës, investon në rritjen e efikasitetit ekonomik, në zhvillimin e kapaciteteve njerëzore dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve.

Ne, si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike, përkrahim Projektbuxhetin për vitin 2009 për t'i mundësuar Qeverisë që t'i realizojë objektivat e veta programore. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputeti Haki Shatri.

HAKI SHATRI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit!

I nderuar Kryeministër,

E nderuar Qeveri e Kosovës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, si partner i koalicionit qeverisës, konsideron që ligjet për ndarjet buxhetore vjetore janë dokumentet më të rëndësishme që miratohen në Kuvend, pasi që ato sigurojnë bazë materiale të funksionimit të institucioneve të shtetit dhe të institucioneve në veçanti.

Projektligji për ndarjet buxhetore për vitin 2009 është shqyrtuar dhe analizuar disa herë në disa takime pune nga Grupi Parlamentar i LDK-së, ku kanë qenë të pranishëm edhe vetë Kryeministri, ministri i Financave, zëvendësministri e të tjerë, për sqarime të nevojshme.

Me këtë rast kemi evidentuar përparësitë dhe mangësitë e këtij dokumenti, por edhe domosdoshmërinë e procedimit dhe të miratimit përfundimtar para 1 janarit 2009.

Për të realizuar këtë qëllim, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka marrë vendim që në seancën e sotme ta votojë, në parim, këtë projektligj, në mënyrë që t'i hapet rruga e shqyrtimit të tij në komisione dhe në grupe parlamentare.

Jam i autorizuar që disa nga mangësitë e evidentuara të këtij dokumenti nga ana e Grupit Parlamentar të LDK-së, t'i prezantoj në këtë seancë, me shpresë që do të gjejmë rrugë të eliminimit të tyre dhe në këtë mënyrë të krijohen kushtet për miratimin e Buxhetit 2009 në afatet e duhura, ndër të cilat mangësi po veçoj:

Te pjesa e të hyrave, kemi dy dilema dhe shqetësime: E para, që sot duket shumë më shqetësuese -të hyrat nga doganat dhe taksat që vilen në kufi do të realizohen vetëm nëse nuk implementohet njëra nga 6 pikat e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që ka të bëjë me doganat. Në rast se kjo ndodh, Ministria e Financave dhe Qeveria duhet të përgatisin versionin alternativ me më pak të hyra buxhetore dhe rrjedhimisht me kufijtë e reduktuar të shpenzimeve.

E dyta, rekomandimi për kredi të re të KEK-ut për 80 milionë € dhe parashikimi i kthimit të kësaj kredie brenda po këtij viti, bashkë me kredinë e parë të vitit 2008, konsiderojmë që është e pamundur të realizohet, prandaj Qeveria duhet, po ashtu, të ketë alternativë. Në rast tjetër, në qoftë se parashihet që kjo kredi të kthehet nga një kontratë me investitorin e ri, atëherë duhet të parashihen në buxhet të hyrat e gjithëmbarshme të kontratës jo vetëm 160 milionë euro nga kredia e dhënë deri më tash KEK-ut.

Sa u përket shpenzimeve, duhet të bëhen përpjekje deri në fund për harmonizimin me rregullat fiskale të Fondit Monetar, përndryshe do të përballemi me situata të pakëndshme me Komunitetin e Donatorëve nga të cilët presim shumë.

Buxheti duhet t'i reflektojë prioritetet e Qeverisë. Në këtë aspekt konsiderojmë se duhet të merren më tepër në konsiderim nevojat e Sektorit të Drejtësisë dhe sundimit të ligjit, shëndetësisë, bujqësisë dhe ambientit. Projektet investive të sektorëve duhet t'i reflektojnë realisht prioritetet sektoriale të përcaktuara nga Qeveria në Kornizën e shpenzimeve.

Çështje e veçantë që kërkon rishqyrtim të rekomandimit është shpërndarja më proporcionale e projekteve që realizohen nëpër komuna. Duhet të respektohet i njëjti kriter për kategorinë e mallrave dhe të shërbimeve, si për organet qendrore, ashtu edhe për njësitë lokale- komunat. Duhet të shikohet mundësia e trajtimit të veçantë të Prishtinës, si kryeqytet i vendit, me rastin e ndarjes së granteve qeveritare për komunat.

Duhet të mbulohet me buxhet kostoja e implementimit të të gjitha ligjeve të miratuara në Kuvend, që kanë hyrë në fuqi ose që do të hynë në fuqi gjatë vitit 2009, si dhe të respektohen të gjitha vendimet që i ka marrë Kuvendi me rastin e buxhetimit të shpenzimeve.

Të respektohen në mënyrë strikte dispozitat e Ligjit për financat publike dhe të Ligjit për financat lokale dhe aktet e tjera nënligjore, të cilat përcaktojnë rregullat e përgatitjes dhe procedurat e nxjerrjes së buxhetit, sidomos procedurat dhe kërkesat që duhet t'i plotësojë kërkesa për buxhetimin e një projekti investiv. Në këtë aspekt kemi vërejtur lëshime të konsiderueshme të tabela 3A të projektet kapitale, ku shumat nuk përputhen ose mungojnë elemente esenciale për projektet e rekomanduara.

Rekomandimi për kreditimin e KEK-ut me 80 milionë €, nuk është shoqëruar me asnjë kërkesë konkrete se për çka dhe ku do të shpenzohen këto para, ashtu siç nuk është arsyetuar me asnjë veprim përcjellës shuma prej mbi 40 milionë € për importin e energjisë dhe vërejtjet tjera që do t'i përmenden kolegët e tjerë deputetë.

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së do të përpiqet maksimalisht të kontribuojë në eliminimin e mangësive nëpërmjet angazhimit në Komisionin për Buxhet dhe në komisione të tjera. Për këtë qëllim, ka formuar një grup të veçantë pune, që do të merret me amendimin e nevojshëm të këtij dokumenti të rëndësishëm, me qëllim që të krijohen kushtet që ta kemi një dokument më të mirë të mundshëm në rrethana të caktuara për vitin 2009.

Dhe, krejt në fund, që të jem korrekt, nuk është qëndrim i Grupit Parlamentar i LDK-së, por në ekspozitën e Kryeministrit dëgjova vlerësim për menaxhimin e financave në të kaluarën. Kisha propozuar që Kryeministri t'i ketë një konsiderim raportet e Komisionit Evropian dhe raportet e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për Kosovën për periudhën e tashme dhe të kaluarën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka deputeti dhe kryetari i Partisë, Behxhet Pacolli.

BEHXHET PACOLLI: Faleminderit, Kryetar!

Ju përshëndes Juve, Kryeministrin, ministrat dhe kolegët deputetë,

Dëgjua tani edhe kontributin që dhanë në këtë seancë zonja Safete dhe zoti Shatri, të cilët e lavdëruan Qeverinë, e lavdëruan Projektbuxhetin. Ata sigurisht kanë të drejtë ta bëjnë këtë, është detyrë e tyre, por kanë harruar se, për shembull, te një ministri kemi rritje të buxhetit prej 40,6%, te një ministri tjetër mbi 40%, kurse te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale vetëm për 1,4%. Është absurd, sikurse Kosova të jetë një shtet që nuk ka probleme as të punësimit, as të mirëqenies sociale.

Prandaj, unë kam shënuar disa pika të Projektbuxhetit që Qeveria ka parashtruar dhe dua të them se projektbuxheti i Kosovës në vitin 2009 dhe projektimi deri në vitin 2011 nuk është kompatibil me prioritetet e caktuara që synon t'i implementojë Qeveria e Kosovës. Pra, ai nuk pasqyron as nevojat e qytetarëve, as objektivat tona për ndërtimin e shtetit të Kosovës.

Projektbuxheti, si i tillë, ka mangësi të shumta. Sidoqoftë, është e pakuptueshme që në periudhën e ardhshme trevjeçare të kemi rritje të buxhetit vetëm për 5,6% në vit, çka do të thotë që nga 888 milionë euro të vitit 2008, të ketë rritje vetëm për 213 milionë euro për tri vitet e ardhshme. Nga kjo del se në vit kemi rritje vetëm 71 milionë euro, çka është shumë e ulët dhe është në kundërshtim me pritjet e qytetarëve të Kosovës.

Deri tani ende nuk janë miratuar katër ligjet në të cilat mbështetet ky projektbuxhet. Sot kërkohet, ndoshta, të votohet për Projektbuxhetin e Kosovës, para se të miratohen edhe katër ligje të tjera. Në këto ligje mbështetet Projektbuxheti i Kosovës: Ligji të hyrat nga korporatat, Ligji për tatimet mbi vlerën e shtuar, Ligji për tatimet e të ardhurave individuale dhe Ligji për tatimet e normës së akcizës. Ka qenë e drejtë që së pari këto katër ligje të miratohet, të shihen se çka përmbajnë këto ligje, e pastaj të diskutohet për Projektligjin e buxhetit.

Një prej ligjeve të pamiratuara është Ligji për të hyrat nga tatimet e korporatave. Është absurde që edhe në tri vitet e ardhshme ndërmarrjet publike të mos jenë mbështetëse të buxhetit të Kosovës, por edhe më tutje të jenë shpenzuese të buxhetit. KEK-ut nuk i tolerohet më t'i shpenzojë paratë e qytetarit të Kosovës, të mos i ofrojë atij asgjë tjetër pos kokëçarjes. Me mungesë të rrymës, qytetari i Kosovës ka vetëm kokëçarje. Tani është e patolerueshme që prapë prej buxhetit, prej parave të taksapaguesve, prej qytetarëve të Kosovës, KEK-ut t'i jepen 80 milionë euro në njërin anë, e në anën tjetër edhe për importin e rrymës elektrike mbi 47 milionë euro. Sigurisht, me këto para ne do të kishim shansin të formojmë, ndoshta, sigurimin shëndetësor, pa të cilin Kosova do të mbetet edhe për tri vjetët e ardhshme.

Në Projektligjin e afruar nga Qeveria parashihet ulja e tatimeve prej 20 në 10% që deri në vitin 2011 Buxheti i Kosovës nga këto të hyra do të ketë 29,45 milionë euro më pak. Është fjala për tatimet që vinë nga korporatat.

Zbutja e tatimeve të korporatave është reale dhe reformuese, këtë e dimë të gjithë që duhet të kemi tatime më të ulëta, por kurrë nuk duhet të paraqet deficit për Buxhetin e Kosovës. Kjo rënie duhet të zëvendësohet absolutisht me të hyrat shtesë të korporatave të reja që do të dalin nga programet qeveritare, gjegjësisht nga reformat ekonomike që kjo qeveri është dashur sot t'i paraqesë.

Prandaj, Qeveri e nderuar, lirojeni kompanitë publike nga ndikimi politik, e do të shihni se ato do të dinë dhe do të mund të punojnë në mënyrë ekonomike dhe në favor të qytetarit të Kosovës.

Vetë fakti se ka tendencë të rritjes të TVSH-s, nga 15 në 16% në vit, e jo të uljes, tregon se Qeveria nuk ka një plan të mirëfilltë që bazohet në reforma të qëndrueshme ekonomike. Të ardhurat nga tatimet individuale zbriten për 17 milionë euro në tri vjetët

e ardhshme, që për vitin 2009 kjo shumë tejkalon 13,46 milionë euro. Kjo tregon se qytetari i Kosovës është i destinuar të jetojë në varfëri dhe papunësi.

Në vendet ku Qeveria angazhohet për një ekonomi të mirëfilltë, ky faktor është gjithmonë në rritje, e kurrësi në rënie, prandaj duhet të punojmë që të krijojmë vende pune, që të krijojmë mirëqenie, atëherë do të kemi edhe më tepër të ardhura buxhetore.

Do të ishte shumë reale po që se Qeveria do të parashihte zbritjen e taksave doganore, ndoshta t'i përgjysmonte ato. Aty do të kemi stimulim më të madh, do të kemi rritje të importit dhe rritje ose shanse të rritjes së prodhimit në vend. Makineritë që importohen sot doganohen me 26%. Qytetari i Kosovës është e pamundur që ato t'i blejë, t'i importojë, të ndërtojë dhe të krijojë subjekte ekonomike që do të ndikojnë drejtpërsëdrejti në të ardhurat tatimore për Qeverinë, gjegjësisht për buxhetin e Kosovës.

Sipas meje, rritja e të hyrave buxhetore nga akcizat prej 16,12 milionë euro është shumë e vogël. Besoni se rritja e shpenzimit të kafes, alkoolit, derivateve të naftës, duhanit, është e njëjta si përpara, pra ka tendenca të rritjes dhe këtu kemi një rritje të të hyrave buxhetore vetëm prej 16,12 milionë euro, që është e vogël, prandaj në të ardhshmen dhe në tri vitet e ardhshme ne i kemi lënë fushë të hapur korrupsionit, spekulimeve të ndryshme dhe kontrabandës.

Nuk flitet askund për të hyrat buxhetore, prej atyre që ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndotjen e ambientit. Ndotësit e ambientit, shkatërruesit e shëndetit të popullatës së Kosovës duhet paguajnë dhe në buxhetin, të cilin e kemi përpara, ne këto nuk i shohim, prandaj kemi restorantet, barnat që i gjejmë kudo qoftë, kemi shitësit e derivateve të naftës, kemi shitësit e duhanit, të kafes, e tjera dhe të gjitha këto drejtpërdrejt ndikojnë në shëndetin e popullatës, të qytetarit të Kosovës dhe nuk kemi të hyra buxhetore. Në vendet normale, me një ekonomi të mirëfilltë, këto formojnë një hyrje shumë të rëndësishme të buxhetit.

Eksporti parashihet të rritet prej 343.000.000 në 694.000.000 euro. Besoni, është joreale. Është joreale se tani Kosova jeton në kushte shumë të ndërlikuara, vepron sipas konventave të CEFT-ës dhe Qeveria nuk ka arritur absolutisht të formojë një ambient ekonomik, në mënyrë që ta stimulojë eksportin. Ne nuk kemi prodhim, nuk di nga çka do të rritet eksporti.

Ne nuk kemi ende mallra të certifikuar dhe në reformat ekonomike të Qeverisë nuk flitet për këto, prandaj vetëm se mund të ëndërrojmë se do të kemi rritje të eksportit.

Buxheti i Kosovës i projektuar nga Qeveria nuk bazohet në rritje ekonomike, ngritjet e mirëqenies qytetare, rritjet e punësimit, indikatorë që ndikojnë drejtpërsëdrejti në të hyrat buxhetore, por bazohet në të hyrat hipotetike që nuk kanë mbështetje në burime të qëndrueshme ekonomike.

Buxheti është i bazuar kryesisht në të hyrat nga doganat. Në ekonominë bashkëkohore këto të hyra trajtohen si burime terciare, e jo primare, si të ne, sepse vlera e tyre asnjëherë nuk mund të jetë reale dhe, për më tepër, krijon një varësi ekonomike, e cila...

KRYETARI: Regjia, t'i vazhdohet fjala!

... destimulon iniciativën e faktorëve prodhues. Buxheti i projektuar nuk subvencionon bujqësinë si faktor kryesor për ekonominë e Kosovës dhe mirëqenien e qytetarit të saj. Nuk ka logjikë që buxheti i ndarë prej 7.000.000 euro për investime kapitale në bujqësi, në krahasim me investimet në fushën e infrastrukturës rrugore 103.000.000 euro. Edhe këto rrugë i nevojiten Kosovës, por është dashur që të mendohet edhe për bujqësinë pak. Bujqësia është shumë me rëndësi. Ajo do të jetë faktor shumë me rëndësi për ardhmërinë e Kosovës, gjegjësisht për mirëqenien e qytetarit të Kosovës.

Investimet kapitale prej 7.000.000 euro në shëndetësi, më falni, janë banale. Ato absolutisht nuk mund t'u përballojnë problemeve me të cilat qytetari i Kosovës përballohet çdo ditë. Buxheti nuk parasheh qoftë as pjesërisht ndonjë masë mbrojtëse sociale shëndetësore dhe pensionale për vitin 2009. Kjo do të thotë që qytetarët tanë do të presin deri në vitin 2011 në të njëjtën situatë si tani, pa sigurim shëndetësor, pa sigurim social dhe pa sigurim pensional.

Buxheti, si i tillë, ka disproporcion në mes të hyrave dhe shpenzimeve të parapara dhe shtrohet pyetja: - nga ku mbulesat? Sigurisht nuk ka menduar ashtu sikurse edhe Qeveria e kaluar, e cila të ardhurat i inkasoi prej shitjes së operatorit të parë të telefonisë mobile. Kjo Qeveri, sigurisht, do të jetë më e mençur, do të hartojë Ligjin për privatizimin e ndërmarrjeve publike. Nuk kemi ligj, zoti Kryetar i Parlamentit të Kosovës, nuk kemi Ligj për privatizimin e ndërmarrjeve publike, prandaj ky Parlament duhet të vendosë shumë shpejt dhe duhet të hartohet ligji, ku do të shkruhet çdo gjë, si të procedohet me privatizimin e ndërmarrjeve publike. Ky buxhet që ne e kemi përpara, nuk duhet të bazohet në të hyrat që do të vijnë nga shitja e ndërmarrjeve publike.

Shitja e ndërmarrjeve publike është e drejtë privatizimi, është e drejtë, por ato para nuk janë të kësaj Qeverie, nuk janë të anëtarëve të këtij Parlamenti, por ato para janë të qytetarëve të Kosovës, ato para janë të foshnjave tona, të nipërve tanë, të mbesave tona. Ata do të pyesin njëherë se çka ju kemi lënë atyre këtu në këtë Kosovë? Prandaj, ne duhet të mendojmë për këtë. Këto para nuk duhet të jenë si hyrje shtesë, që do të mbulojnë mangësitë e buxhetit të Kosovës.

Siç shihet, kritikën e opozitës se Qeveria nuk ka strategji të zhvillimit ekonomik, po vërtetohen edhe nëpërmjet këtij projektbuxheti, i cili nuk krijon bazë për zgjidhjen e problemeve kyçe, si: luftimin e varfërisë, rritjen e shkallës së punësimit, stimulimin e rritjes ekonomike dhe përmirësimin e situatës sociale dhe shëndetësore.

Ne do të propozojmë që ky projektbuxhet të mos të miratohet sot, por të paraprihet me miratimin e katër ligjeve, në të cilat mbështetet ky projektbuxhet. Pra, duhet t'i jepet shansi Qeverisë që edhe pak kohë të përgatisë këtë buxhet, ta korrigjojë këtë buxhet në bazë të kritikave që do të dalin, gjegjësisht debatet që do të dalin nga kjo seancë.

Këtë e them për interesin e qytetarëve të Kosovës. Kjo është shumë me rëndësi që së bashku të mobilizohemi, të punojmë për një buxhet më të mirëfilltë, për një ardhmëri më të mirëfilltë, që qytetarit të Kosovës tani i nevojitet më tepër se kurrë.

Tani, Qeveri e nderuar, më pyetni për çka keni nevojë. Ne duam të jemi në ndihmën tuaj, t'ju ndihmojmë, por na jepni shansin që edhe ne të kontribuojmë në buxhetin të cilin ju sot e parashtroni para nesh. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Radha është e Grupit Parlamentar të AAK-së, kryetari i Grupit, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zoti kryeministër,

Kolegë të nderuar,

Derisa po i dëgjoja fjalimet e gjata, fillova ta shoh dekorin e Kuvendit dhe mendoj se duhet nderuar këtë lule këtu, nuk e di armani a çka është, e ta vënë ndonjë simbol të Kosovës se gjatë na ka mbetur dhe nuk po dihet se çka është, i kemi simbolet tona. Vetëm kështu, si vrojtim gjatë kohës sa isha nja një orë duke dëgjuar.

Çështja është kështu: një pyetje, e para që shtrohet, të cilën e përmendi edhe Gani Koci me elokuencë, sa është buxheti i Kosovës? Kemi fjalë të ndryshme që i dëgjojmë këtu, shifra të ndryshme. Zoti Koci, me elokuencë po edhe një herë, e përmendi se duhet t'i japim emër se për çka po flasim. Shikoni faqen 3, paragrafi 2, rreshti i parë, në fund të rreshtit është ligj, është te fjala e ministrit, thotë 1 miliard e 97 milionë, përderisa këtu dëgjojmë 1 miliard e 400 milionë. Pra, tani a t'i besojmë ligjit që e kemi marrë në dorë, apo t'u besojmë fjalëve. Duhet pasur kujdes këtu. Kur i shohim shifrat, na del kështu: të hyrat e parapara janë 956 milionë dhe thuhet që 1 miliard e 400 milionë do të jenë në buxhetin e Kosovës, 450 milionë i kemi diferencë. Prej nga vijnë këto 450 milionë? Mos harroni se 450 milionë janë gjysma e të hyrave të parapara të gjithëmbarshme të Kosovës për vitin 2009, shumë tepër e madhe për të pasur diferenca brendapërbrenda. A e dini prej nga vijnë? Pjesa më e madhe vijnë prej suficitit sivjet, e prapë ministri me shumë elokuencë i thotë suficitit, qysh i thotë, nënshpenzim, janë shpikje fjalësh.

Ju kujtohet kur kemi biseduar për rishikimin, në vend se të thuhet reprezentacion, kanë thënë përfaqësim, që të mendojë dikush se është për përfaqësim jashtë a kush e di se çka, e ka qenë fjala për dreka e për darka.

Çështja tjetër, për të cilën duhet të flasim, është se Fondi Monetar Ndërkombëtar a e ka mbështetur këtë buxhet a jo dhe është pyetje esenciale, nuk është pyetje retorike për t'ia bërë qejfin dikujt. Nëse Fondi Monetar Ndërkombëtar nuk e mbështet këtë buxhet, besoni që pjesa dërmuese e donacioneve për të cilat jemi mburrur në qershor, kanë për t'u ngrirë. Është kusht dhe me sa e dimë ne, nuk është përkrahur dhe letra e Fondit nuk na ka ardhur këtu, nuk i është bashkëngjitur dokumentit të cilin e kemi përpara.

Çështja tjetër është rritja e buxhetit. Kërkohet rritje e buxhetit, por shikoni tash, nëse i përcjellim 400 milionë € prej këtij viti në vitin tjetër, e prapë synojmë që ta rrisim buxhetin dhe nuk jemi në gjendje që t'i shpenzojmë ato mjete, se kanë qenë suficit, a e dini çka po bëjmë? Po i tërheqim paratë prej tregu dhe prej xhepave të njerëzve dhe po i fusim në kasafortë? Ky është varfërim, nuk është zhvillim ekonomik. Kjo është metoda më interesante për t' i varfëruar njerëzit kur paratë tërhiqen prej qarkullimit e futen në kasafortë për t' i shpenzuar më vonë. Është njëjtë sikur t'ia heqësh dikujt bukën e t' i thuash që ta hajë javën tjetër.

Janë disa pika të posaçme, të cilat dua t' i përmendi para se të kaloj te gjashtë pikat, sepse i kam tetë, i kam tetë pika për buxhetin, jo gjashtë. Një çështje është "Rilindja", objekti i "Rilindjes". Besoni që është një e problematikës buxhetore në Kosovë. Qe, po

ju tregoj pse është një. Fillimisht, ky Kuvend e ka refuzuar rindërtimin ose renovimin e objektit të “Rilindjes”. Pra, e ka refuzuar, është vendim i Kuvendit. Qeveria përkundër vendimit të Kuvendit, e ka filluar punën në rindërtim, pa hyrë në aspektin se si është fituar tenderi, kush e ka fituar, ai ka qenë tender i fituar ende pa u shpallur. Do të thotë, ka filluar jashtë ligjit, është shkelje flagrante e ligjit që t’i fillosh punët në një projekt të cilin e ka refuzuar Kuvendi i Kosovës. Edhe deputetët e partisë në pozitë, në pushtet, e kanë refuzuar.

Çështja tjetër është, po e thashë, fillimi i punimeve pa tender, pa vendim të Kuvendit, pa kurrëgjë. Qysh fillojnë punët ashtu?

Çështja tjetër është çmimi i ndërtimit. Besoni që është shumë problematik për disa çështje. Çështja e parë është që është shumë më i madh se çmimi i tregut në ndërtim sot për mëtej katror, jashtëzakonisht më i madh dhe çështja e dytë është se Qeverisë së Kosovës i ndodh që vlera e investimit të jetë më e madhe se vlera në treg e objektit. A dini çka mund të ndodhë? Kur përfundon investimi në “Rilindje”, e nëse “Rilindja” del në shitje, e ka për të dalë në shitje, askush nuk ka për të paguar më shumë se 3 ose 4 milionë euro për atë “Rilindje”. Domethënë, ne investojmë 13, përpos çka është investimi real aty, ekzistues, dhe e shesim për një të gjashtën e vlerës për të cilën flasim sot. Me siguri e blen dikush prej Qeverisë, se përndryshe askush nuk e bën tërë këtë investim e t’i humb paratë. Është e papabesueshme!

Një çështje tjetër pjesore, është pse po kryhen pagesa pa filluar punimet nëpër objekte, pse kryhen pagesat sot? Ministrisë së Arsimit, të gjitha ministrive, pse po kryhen pagesat pa filluar puna? Pa filluar puna, lëre më pa u krye. Për shkak suficitit ose për shkak se edhe duhet të rregullohen tarifat shpejt e shpejt, ama kur po kryhet pagesa pa ia filluar punës, është shkelje serioze e ligjit, prapë është shkelje shumë serioze e ligjit.

Pse në Buxhetin e vitit 2009 ka pozicione për pagesa, për punë që janë kryer sivjet? Qysh bën një punë që ne e shohim që është kryer, ka përfunduar, ta kemi në buxhet të vitit 2009? A e dini si bën, se janë kryer pa tender, pa kurrëgjë hiq sivjet dhe duhet të hapet disi tenderi se është shumë zor për ta mbuluar.

KEK-u, është një problem tepër serioz, prapë për çështje buxhetore në Kosovë. 80 milionë euro jepen, edhe 40 milionë tjera jepen për blerjen e rrymës, por po e abstrahojmë për një minutë këtë 40 milionëshin, 80 milionë euro jepen. Çka ndodhë tani? Kur të shitet distribucioni, kthehen këto 80 milionë. Çka ndodhë? I kemi dhënë 80 milionë, i kemi marrë 80 milionë euro, pra kemi mbetur pa distribucion, ka shkuar distribucioni. Sikur këto 80 milionë euro të ishin futur në ndonjë bankë me interesin më të ulët të mundshëm, sikur njerëzit që i deponojnë 3000 €, do ta kishim minimum 5 milionë euro në vit vetëm interesin. Nëse do të ishin investuar 10 milionë, domethënë, çka bëjmë ne? I japim 90 milionë euro për një vit, i marrim 80, edhe distribucionin e lëshojmë. Domethënë, e kemi humbur distribucionin dhe 10 milionë euro interes, me një lëvizje. Me siguri, nuk e kanë pyetur ministren, se nuk i kish lënë të veprojnë kështu, se di më mirë, por s’e ka pyetur kurrkush hiq e çka po di unë çka ka ndodhur?

Çështja tjetër është Raporti i nëntëmujorit të shpenzimeve. Pse nuk ka ardhur raporti nëntëmujor tani, në mënyrë që ta ketë një orientim Kuvendi, shoqëria civile, Qeveria e të gjithë, se çka kemi në dorë, cilat janë mjetet që i kemi në dorë, me çka po manipulojmë, çka bartet herën tjetër? A e dini pse nuk ka ardhur? Për shkak se kjo qeveri

ka shpenzuar 15% më shumë për dreka dhe darka se Qeveria paraprake për nëntë muaj, shumë interesant, është në raport, e keni marrë raportin, lexoni e shihni!

Çështja e qirasë, çka të bëjmë me qira tash? Shikoni! Prapë po kthehem te "Rilindja". Është shumë problematike çështja e qirasë. Është thënë se nuk kemi për të paguar qira më, s'ka më qira. Shikoni çka ndodhë? Përpos qirasë që paguhet, shkojnë edhe 13.6 milionë euro në "Rilindje", të parapara këtu për 5 vjet. Do të thotë, 3.5 milionë euro në vit për "Rilindje", e cila pas 5 vjetëve duhet të shitet. Realisht, çka po ndodh? Për qira po paguhet dy herë më shumë se sa që është paguar në vitin e kaluar, për shkak se në krye të 5 vjetëve duhet të shitet "Rilindja". Pra, po bëhen 14 milionë € investim vetëm për 5 vjet, ka thënë vetë ministri në televizion.

Çështja tjetër janë ligjet. U përmendën katër ligje: për TVSH, për akcizën, për korporatat, për të ardhurat dhe për taksat në të ardhura. Këto ligje janë propozuar që të miratohen në pako, sikur pakoja e Ahtisarit, bashkë me buxhetin. Do të thotë, dikush e ka planifikuar këtë buxhet, duke presupozuar se këto ligje do të ndryshohen. Po, sikur të mos ndryshohen këto ligje? Ky buxhet do të thotë është hartuar disi në ajër, me shumë supozime. Me supozime të rritjes së eksportit, me supozime të rritjes së importit, krejt janë supozime thuaja se dikush ka shkuar te një orakull dhe i ka qitur fall.

Çështja tjetër janë 6 pikat. Nëse këto 6 pika do të jenë këtu, atëherë ky buxhet prapë është buxhet i çuditshëm për shkak se sipas pikave 1 dhe 31 që bëjnë diku 30% e të hyrave, nuk ka për t' i kontrolluar Qeveria e Kosovës, as të hyrat, as kurrgjë tjetër.

Çështje tjetër, e teta, është përfundimi. Çka mund të themi në total tash. Kur i kemi dëgjuar fjalimet sot, kemi dëgjuar fjalët të cilat cilido që e ka përcjellë politikën, i ka dëgjuar edhe para një viti. Shkolla të reja, kompjuterizim të gjitha shkollave të Kosovës, autostrada të reja, barëra pa para. Këto kanë qenë premtimet e fushatës zgjedhore, domethënë po ndodhin prapë, të njëjtat, asgjë nuk ka ndryshuar, 24 orë rrymë prapë.

A dini çka ka ndodhur me "Kosovën C"? Një vit është humbur vetëm për t'ia ndërruar emrin nga "Kosova C" në "Kosova e re". Kurrgjë nuk ka ndodhur, vetëm emri i është ndërruar që një vit.

Çështja tjetër që duhet të përmendet sot, është, mbani në mend premtimet që kanë ndodhur dhe krahasoni me premtimet që po i dëgjoni sot.

Çështja tjetër, është se...

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: Regjia, t'i vazhdohet diskutimi!

... po shpenzohet si para xhepi, mbani në mend "Rilindjen", mbani në mend KEK-un, mbani në mend premtimet e porealizuara, mbani në mend premtimet e sivjetme që paguhën në vitin e ardhshëm.

Çështja tjetër është që kjo Qeveri po e befason vetveten për të keq, e lëre më të tjerët, për shkak se plani legjislativ nuk është i harmonizuar me buxhetin. Nuk e dimë çfarë ligje do të prodhojmë vitin e ardhshëm dhe a do të mundet ky buxhet t'i mbulojë edhe ligjet që do të hartohen vitin e ardhshëm për shkak se nuk ka harmonizim, se nuk ka as

plan legjislativ. Do të thotë, tash ne çka po bëjmë, po themi ne e kemi hartuar buxhetin, kaq duam të shpenzojnë, tani ligjet ua përshtatni shpenzimeve të cilat i kemi paraparë. Paramendoni, në fund të fundit, mos u befasoni kur raportet e Komisionit Evropian, të Fondit Monetar, të gjitha raportet të vijnë të këqija. Këto janë arsyt kryesore. Dhe, në fund të fundit, po ia tregoj njëfarë gjysmë barcolete ministrit të Financave. Është ajo çështja kur shefi i ka ndjekur dy hamall duke e bartur një piano në katin e 20-të. Këta të lodhur, pyetnin a mbërrimë, a mbërrimë, kurse ky ju thoshte, edhe pak, edhe pak. Kur mbërrin, ju tha: po ju tregoj një lajm të mirë, e një lajm të keq. Lajmi i mirë është që mbërrimë në katin e 20-të, e i keqi është që e kemi gabuar hyrjen. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Gjini!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së është paraqitur Besa Gaxherri.

BESA GAXHERRI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Zoti Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Zoti Kryeministër, sot është data 25 nëntor, është Dita Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Gruas, ndaj femrës.

Kemi të dhëna që ka ngritje të madhe të dhunës ndaj gruas. Ky është një shembull që vërtet në Kosovë ka ngritje edhe të dhunës ndaj gruas, që është celula e familjes dhe unë e shfrytëzoj rastin që t'ju lus, pasi që jeni këtu, që të merreni dhe t'i zbatoni ligjet që edhe kjo çështje të eliminohet.

Sa i përket këtij dokumenti, Projektligjit për buxhetin e vitit 2009, zoti Kryeministër, ky material është një material që konstaton gjendjen reale në Kosovë, është një material që paraqet fontanë dëshirash, por është një material i cili vazhdon me të njëjtin ritëm të buxhetit, pra edhe të hyrave, edhe të shpenzimeve për vitin 2009.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë që në start, po ju them, nuk mund ta mbështet apo ta përkrahë një projektligj të tillë, të cilin në të vërtetë nuk e mbështet as Fondi Monetar Ndërkombëtar, i cili në të vërtetë nuk i plotëson kushtet as për të ardhur në procedurë këtu sot, sepse në bazë të asaj, të atij ndryshimi të politikave fiskale që parashihni ju, e që vërtet nuk thonë asgjë, asnjë lloj ndryshimi, kjo pako e ligjeve nuk ka ardhur ende në Kuvendin e Kosovës dhe ju si Qeveri, që mendoni se mund t'i bëni të gjitha gjërat në formën jodemokratike, vjen para këtyre ligjeve, vjen edhe Projektbuxheti që vërtet nuk është çështje e pranueshme.

Njëkohësisht, Lidhja Demokratike e Dardanisë nuk përkrah këtë projektligj sepse, zoti Kryeministër, me Projektligjin e Buxhetit për vitin 2009 nuk garantoni asnjë vend pune për qytetarët e Kosovës. Në vitin 2009, me këtë projektligj nuk garantoni energji elektrike as për parapaguesit, e lëre më shumë. Me këtë projektligj nuk u garantoni qytetarëve të Kosovës që të kenë ujë të pijes, nuk u garantoni qytetarëve të Kosovës arsim më cilësor, shëndetësi çfarë e meritojnë. Me këtë projektligj, zoti Kryeministër, Qeveri e nderuar, kolegë deputetë, shërbyesve civilë nuk u garantohet apo nuk ju ofrohet asnjë rritje që proklamojnë që 10% ka ngritje të pagës, do me thënë nuk ka ngritje të pagave.

Me këtë projektligj, pensionistët e Kosovës nuk do të kenë pensionet e merituar. Me këtë projektligj shtresat sociale, kategoritë me nevoja të veçanta dhe kategoritë e dala

nga lufta, që presin që shteti t'ua zgjatë dorën, sepse shumë nga këta persona lanë duart dhe gjymtyrët e tjera për këtë shtet, ata meritojnë më shumë, ndërsa me këtë projektligj nuk u ofrohet asgjë më shumë se sa kanë deri sot.

Me këtë projektligj, qytetarët e Kosovës kërkojnë më shumë siguri, zoti Kryeministër, por me këtë projektligj nuk i ofrohet siguri më shumë. Nuk ju sigurohet përveç asaj nga policët e Kosovës, të cilët më shumë kontribuojnë në baza vullnetare se sa iu ofrohet mbështetje dhe pagë. Jeta e policit në Kosovë kushton 200 euro.

Qytetarët e Kosovës kërkojnë sundim të ligjit edhe të Kushtetutës, kjo nuk iu garantohet. Qytetarët e Kosovës kërkojnë dhe presin që të luftohet krimi dhe korrupsioni, jo vetëm me mënyra deklarative, por presin që nga ky Projektligj të ndahen mjete konkrete, të bëhen projekte konkrete, strategji konkrete, të cilat nuk i shohim.

Të gjitha këto që në vija të trasha i përmenda, edhe njëherë ju pyes, Qeveri e nderuar: A i ofron ky projektligj, qoftë vetëm një nga këto probleme apo obligime që i ka marrë kjo qeveri për t'ua zgjidhur këto probleme qytetarëve të Kosovës? Unë përgjigjem - jo, sepse ky dokument, thotë: -jo!

Kjo qeveri pati premtuar se të gjitha këto probleme do t'i zgjidhë dhe do të fillojë vitin 2008, asnjë lëvizje. Po hyjmë në vitin e dytë, dy vjet të kësaj Qeverie dhe, përveç asaj që nuk ka asnjë zgjedhje të problemeve, vërtet ky projektligj na tregon se është një krizë apo veç sa po thellohet kriza.

Ky projektbuxhet nuk ofron as shumë të hyrave reale, sepse sot nuk e kam ndërmend, unë jam edhe anëtare e Komisionit të Buxhetit, dua të merrem shumë pak me shifra, sepse kam dhënë atje, vërejtjet do t'i jap prapë, por megjithatë, ky projektbuxhet nuk ofron as shumë të hyrave reale çfarë e kemi në dokument, sepse nga papërgjegjësia juaj politike, të nderuar, ne jemi në mëdyshje që do t'i kemi ato të hyra doganore që i parashikoni ju këtu në këtë material.

Nga raportet e shpenzimeve të vitit 2008, shohim se kjo Qeveri nuk ka kapacitete për shpenzimin e parasë, pra ka shumë suficit, si dhe keqmenaxhim të parasë publike. Por, ju Qeveri e nderuar, ju nuk keni bërë asnjë ndryshim në planifikim për vitin 2009, as në politikat fiskale dhe as në orientimin e investimeve kapitale. Çfarë do të thotë kjo? Kjo do të thotë se viti 2009 për qytetarët e Kosovës do të jetë më i vështirë se ky që po e lëmë pas.

Të nderuar kolegë deputetë,
Edhe viti 2009 do të ketë subvencione për KEK-un. Sa? 80 milionë euro në investime kapitale, 15 milionë për mirëmbajtje, 45 milionë për import. Është e patolerueshme. Ndërsa, gjithsej investime kapitale për sektorin të cilin presim që të ketë zhvillim apo punësim, siç është për shembull bujqësia, janë vetëm 7 milionë investime kapitale.

Të gjithë qeshin, paratë e freskëta ju i orientoni në dikasteret e njëjta të vitit 2008, në tendoromani, e që realisht në këto dikastere mund të bëhen investime nëpërmjet koncesioneve, kredive apo donacioneve që tashmë i janë ndarë Kosovës 1.2 miliardë euro. Nuk e dimë a do të mund t'i shfrytëzojmë, por kështu e kemi informatën.

Nga ky projektbuxhet nuk shohim zvogëlim të shpenzimeve në mallra dhe shërbime, ashtu siç deklaroni ju, se do t'i ulni shpenzimet luksoze, të karburanteve, të drekave, të telefonave, e tjerë. Mbi të gjitha këto, shtrohet pyetja: A është bërë ndarja buxhetore e drejtë në investimet kapitale, si dhe për komuna? Jo! Ka shumë shembuj konkret, e unë do të mundohem të ndalem vetëm në një prej tyre.

Po ndalem tek investimet kapitale pa ndonjë qëllim konkret, por janë mbi 116 milionë, pra Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, ose 17 milionë, por shumë pak... ka për këtë vit buxhet. Prej tyre, 103 milionë janë infrastrukturë rrugore. Për çudi, vetëm 3 milionë kjo ministri i ndanë për hekurudhat. Nuk di a ka nevojë ta diskutojmë se sa ka nevojë Kosova që t'i vejë në funksion hekurudhat? Pra, sa është ndarja e drejtë në këtë aspekt? E marrim shembull sektorin e ndërtimit, ndërtimet e reja, gjithsej 22 milionë e 300 mijë euro. Nga kjo shumë, të nderuar kolegë deputetë, 40% e kësaj shume totale shkojnë në një komunë, ndërsa të gjitha komunat e tjera i kanë 60% të mjeteve, ose në një komunë të caktuar 9.564.525 euro. Për shembull, sektori i bashkëpunimit me kuvendet komunale, që i kisha preferuar Qeverisë që Sektorin për Bashkëpunim me kuvendet komunale duhet t'ua lë..., pse t'i marrë t'i menaxhojë Ministria këto para? Le t'i ndajnë nëpër kuvende komunale dhe ata t'i shpenzojnë, t'i menaxhojnë këto mjete.

Megjithatë, dihet qëllimi pse janë ndarë. Janë gjithsej 11 milionë e 875 euro, 4 milionë euro thuhet, bashkëfinancim, nuk dihet çka, nuk ka asnjë projekt, vetëm janë 4 milionë euro për bashkëfinancim. Prej kësaj shume që i heqim 4 milionë euro, vërtetë mbeten 7.000.875 euro.

Të nderuar kolegë,

Nga kjo shumë, gjithsej 50% shkojnë prapë në të njëjtën komunë, kurse 50% mbesin për të gjitha komunat e Kosovës. A është kjo një ndarje e drejtë, kjo nuk do koment. Shfrytëzoj rastin të them, fatbardhësisht, jemi të gjithë të kënaqur që këtë vit vërtet janë shtruar me shumë rrugë më asfalt se sa, ndoshta, shumë vite më parë. Por, ju lutem, në këtë shtruarje të këtyre rrugëve nuk shohim qoftë një kilometër shtigje për biçikleta. Në këto rrugë nuk shohim që vërtet të investohet ujësjellësi dhe kanalizimi që vërtet të mos kemi nevojë

KRYESUESI: Regjia, t'i vazhdohet diskutimi!

... në vitin tjetër për ta thyer këtë asfalt dhe ta fusim prapë kanalizimin dhe ujësjellësin, sepse në të ardhmen që po pretendojmë të integrohemi në Bashkësinë Evropiane, nuk shkon me kesi lloj investimesh.

Nga këto fakte shohim se ju keni dalë komplet nga struktura buxhetore, pra ndarja bëhet pa kritere, andaj vërejtjet vijnë edhe nga institucionet monetare ndërkombëtare. Si pasojë e kësaj, kjo qeveri nuk ka fituar besimin që t'i menaxhojë 1.2 miliardë, bile as t'i bashkëmenaxhojë edhe sikur të kishte ndodhur kjo, atëherë do ta kishim pasur shumë më lehtë të bëjmë ndarjen e investimeve kapitale me prioritet tjera, por këto 1.2 miliardë do ta shohim tash se kush do t'i menaxhojë dhe si do t'i menaxhojë.

Në tërë këtë material që e keni ofruar, keni përshkruar pra, e thashë edhe më herët, vetëm gjendjen reale dhe keni paraqitur dëshira qysh do të ishte mirë të jetë në të ardhmen. Unë kisha pasur qejf të them diçka edhe sa u përket komunave, pra

kuvendeve komunale. I kam fokusuar vetëm shtatë komuna: Podujevën, Prizrenin, Gjakovën, Pejën, Gjilanin, Ferizajn dhe Mitrovicën.

Të nderuar kolegë deputetë,

E dimë të gjithë se në çfarë gjendje e kemi pjesën veriore të Kosovës. Unë veç po theksoj, Mitrovica i ka 11.524.978 euro njësoj si komuna e Podujevës. Kjo na jep për të kuptuar se sa është e interesuar kjo qeveri për t'i zgjidhur problemet, qoftë politike, qoftë ekonomike në këtë pjesë të Kosovës. Pra, nuk kam qare dhe kërkoj ndjesë se, natyrisht ne nuk jemi deputetë të zonave, jemi deputetë të një zone për tërë Kosovën, por është krejt e papranueshme që Peja t'i ketë 12 milionë euro, Gjakova 12 milionë dhe Prizreni, për shembull, 22 milionë, Ferizaj e Gjilani 13 milionë euro, domethënë, ju lutem shumë, nuk ka asnjë kriter, as për banorë, as për të gjitha kriteret që duhet t'i plotësojë një kuvend komunal. Këtu shihet qartë se ndarja bëhet sipas dëshirës e vullnetit të Qeverisë sonë.

Unë ju falënderoj, natyrisht se kolegët e mi do ta plotësojnë, sepse njëri prej folësve këtu tha se duhet të jepni alternativa. Pra, ne ju kemi dhënë alternativa dhe jemi në gjendje për t'ju dhënë alternativa, por ju kisha thënë se ndryshimet reale do t'i bëjmë atëherë kur ju do ta lëshoni vendin, sepse kështu nuk shkon. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Falënderojmë deputeten Gaxherri,

Në emër të Grupit parlamentar "7+", është paraqitur Myfera Shiniq. I kisha lutur folësit që t'i përmbahen, mundësisht, terminin 10 minutësh.

MYFERA SHINIQ: Teşekkür ederim,

Sayın Başbakan, bakanlar milletvekilleri, hepinizi saygıyla selamlıyorum,

2009 bütçesini incelediğimizde oldukça iyi hazırlanmış olduğunu gördük. Ancak toplulukların yaşadığı bölgelere ağırlık verilmesinden yanayız. Örneğin, Türklerin ve Boşnakların çoğunlukta yaşadığı Prizrenin "Motra Çirijazi" okulunda öğrencilerimizin bodrumlarda, izbelerde ders gördükleri görülmektedir. Bu okula ek binanın acilen yapılmasına ihtiyaç duyulmaktadır. Onun dışında Prizren, Priştine, Gilan, Mamuşa ve Mitroviçada ana sınıfları yani ana okullarının acilen yapılmasına gerek duyulmaktadır. Eğitim yasalarına göre ders kitaplarının Kosova Eğitim Bilim ve Teknoloji Bakanlığı tarafınca basılması gerektiği bilinmektedir. Bugüne kadar 52 ders kitabının basıldığı görülmektedir, bu sürecin hızlatılmasının gereğini vurgulamak istiyoruz. Mamuşada gençlerin gö. Etmemeleri için vatanları olan Kosovada kalabilmeleri için spor ve kültür merkezinin acilen yapılma ihtiyacı duyulmaktadır. Bilhasa toplulukların yaşadığı yerlerde topluluklara ait Kültür merkezlerinin inşa edilmesi gerekmektedir. Eğitim kültür ve diğer konularda toplulukların projelerinin desteklenmesi gerekmektedir, onun dışında Prizrenin ak deresine lahim yani kanalizasyon suları akıyor, bütün yaz Prizrende kanalizasyon kokuları yayıldı. Derenin yatağının acilen yapılmasının gerektiğini, aynı zamanda kanalizasyon sorunun da ortadan kaldırılma gereğini vurgulamak istiyorum. Yine Prizrende ve tabi ki Kosovanın diğer yerlerinde de su şebekesi hem eskimiş hem de su sıkıntısı çekiliyor. Bu sorunun da ortadan kaldırılabilmesi için 2009 bütçesine ek olarak katılma gerekmektedir. Tüm bunları ekleyerek tabi ki 7+ Parlamenter Grubundan gene milletvekillerimiz söz alacaktır, ancak bütün bunları ekleyerek, 2009 yılı bütçesini 7+ Parleментар Grubu olarak kabul ediyoruz, teşekkür ediyorum ve 2009 yılında da başarılı çalışmaları diliyorum.

KRYESUESI: Falënderojmë, deputeten Shinik!

Në emër të Grupit Parlamentar SLS, është paraqitur deputeti Bojan Stojanoviq.

BOJAN STOJANOVIĆ: Hvala vam uvaženi predsjedavajući!

Poštovani gospodine premijeru,

Cenjeni ministri i uvažene kolege poslanici,

U ime Parlamentarne grupe SLS, mogu odmah na početku da kažem da mi naravno po prirodi stvari podržavamo ulazak u skupštinsku proceduru jednog ovakvog budžeta. Ima onih stvari koje su dobre, ima onih koje možda mi želimo da promenimo, naravno ima vremena, ali eto da se malo ostvrim i da damo neke komentare na celu ovu priču.

Čuli smo i cele priče šta ima, ko je za i ko ima protiv. Naravno, ja ne smatram da ovde sedi jedan čovek koji ne želi dobro svima, koji ne želo da izgradimo i mostove, i puteve, i aerodrome, da imamo i dobre biciklističke staze, da imamo sportske terene i sportske hale, infrastrukturu za omadinu, bolje obrazovanje i bolju kulturu. Svi mi to želimo, samo je pitanje, da se možda i našalimo, da kažemo nemam para, a i da imam, odakle mi. Treba da pogledamo i drugu realnost, da li je to realno u ovom momentu i dali ćemo nekim nerealnim prisutupima oko toga moći sve to da rešimo ili ćemo da zasučemo...

KRYESUESI: Regjia, t' i vazhdohet koha, se eshte nje gabim.

... i da krenemo polako korak po korak napred. Svakako ovaj budžet je ambiciozan i mi podržavamo što je za 15% povećan, to će doneti boljitak svima. Povećanje je u putnoj infrastrukturi koje će iznositi 100 miliona. Koristimo svi i naravno tu ne treba odvajati zajednice. Postoje mnoge stvari koje su zajedničke i da će koristiti svima redom. Medjutim, ono što želim da istaknem jeste moja zabrinutost vezano za budžet za zajednice.

Ne radi se samo o budžetu koji je predviđen za Ministarstvo za zajednice. Ne želimo svi mi nešto posebno više od rugih i niti imamo pravo da kukamo, neke stvari i neku sutbinu delimo zajednički svi, bez obzira na pripadnost zajednica, ali vas molim da sagledate i poziciju u kakvoj situaciji trenutno živi Srpska zajednica. Nećemo da se vraćamo u prošlost zbog čega je to, nego samo de fakto stanje.

U ruralnoj sredini bez kanalizacije, vodovoda, bez izgradjene infrastrukture na svim nivoima, i to jednostavno moramo da popravimo, mora nekako da se pokaže da ima vizije za budućnost. I mi želimo napred, i mi želimo u bolje sutra, svakako, i ne želimo da nas bilo ko vuče. Budite sigurni da smo i mi spremni da krenemo napared. Svak se lako navikne na bolji život i svak teži boljitku za sebe, naravno ne protiv interesa bilo kog drugog.

Ali ono što predstavlja činjenicu jeste da ovde, kada se spominjalo povećanje budžeta, neko Ministarstvo za povratak nisam čuo da je spomenuto i, naravno, nije bez razloga, jer povećanja nije ni bilo. I ako pričamo o Ministarstvu za povratak, moramo da kažemo da je to Ministarstvo za povratak i zajednice. S ovim budžetom ne znam kada će se desiti povratak i ne znam kada će se desiti razvoj zajednice.

Nadam se i verujem da ova Vlada ima viziju kako će pomoći zajednicama i kako će napraviti boljitak za sve jer, sigurno, ovaj put u mnoge integracije jeste i stanje sa

zajednicama na Kosovu. Ono što jeste činjenica, jeste da ako uzmemo ovakav budžet, mi od prilike povratak možemo rešiti 3092 godine, to je okvir, a nako cifra. Ne ulazim u pojedinačne cifre vezano za zajednice, znači postoje zvanični podaci vezano za sve to.

Naravno, Ministarstvo za zajednice predstavljamo kao da je Vlada u malom, a to je samo jedan sklop Vlade. Pitamo se šta je sa ostalim sredstvima ostalih ministarstava, koliko će ostala ministarstva uložiti i koliko su ostala ministarstva predvidela za zajednice.

Iz budžeta smo mogli da vidimo da je samo Ministarstvo zdravlja predvidelo 700 hiljada eura za jedjedice, naravno to predstavlja 1% od ukupnog budžeta Ministarstva zdravlja i da Kancelarija za Ministarstvo unutrašnjih poslova, na ime Kancelarije za saradnju za zajednicama ima budžet od 10 hiljada eura, kao i to da Kabinet premijera ima Kancelariju za zajednice sa budžetom od 1 milion eura, da iz budžeta nismo mogli jasno da vidimo zašto su predviđena ta sredstva.

Ja smatram da to stvarno jeste malo, i znam da će se složiti sa mnom i ne znam odakle dolazimo do tog procenta od 1%. Naravno, nije to samo kapitalne investicije, to su dnevnice i plate, robe i usluge, komunalne usluge, subvencije i transferi. Normalno da većinska zajednica, pošto je većinski zastupljen u institucijama i javnim preduzećima, troši veći deo novca, ali vi znate da je predviđeno da oko 12% u svemu tome učestvuje Srpska zajednica. Ne znam dali smo ispunili sve to, po ovim podacima to ne možemo videti.

Onda, imamo opštinski budžet koji iznosi 3,8 miliona za zajednicu. Od ovog budžeta na lokalne kancelarije se izdvaja 2,8 miliona eura, Od 2,8 miliona, na kapitalne investicije odlazi 1,9 miliona. I, pazite sada situaciju, 58% od ovog opštinskog budžeta za zajednice ide severno od Ibra. Možete pogledati. Ja bih voleo da grešim, ali postoji tu još puno stvari koje su neusaglašene. Naravno, mi smo uradili jednu dosta ozbiljnu analizu, i ne želim sve ovde da vas zamaram i da zamaram uopšte kosovsku javnost sa tim. Ja mislim da ima vremena da u razgovorima sa nama pokušate da sagledate naše probleme i šta je ono što nama treba i zašto je ono što ćemo se mi zalagati u narednom periodu kroz Komisiju za budžet i finansije da imamo svog predstavnika i gospodja Kosora Nikolić, u saradnji sa nama, napravila je jednu detaljnu analizu.

Ja vas stvarno molim da nam pomognete i ka pokažemo svima da razmišljamo iskreno da krenemo napred, da zajednice moraju da imaju neka sredstva za razvoj. Ako želimo da kažemo da su zajednice ovde dobrodošle, što ne sumnjam, to stalno ponavlja i premijer i ova Vlada, i moramo to da uradimo i na delu. Naravno, neću da ulazim u priču za KEK i ostale investicije, jer smatram da je ova Vlada što se tiče ostalih investicija imala kapacitete i da je taj kapacitet sigurno zadržala, da zna dobro da menadžira ta sredstva i da je pravilno odredila.

Situacija nije baš najbolja. Vlada će se potruditi da bude bolje i nije to ono što me brine. Još jednom vas pozivam da nam pomognete da vas podržimo. Znači, nas trebate da ubedite da mi imamo svoje mesto i u budžetu, kroz budžet i u društvo i sigurno ćemo, ukoliko budemo napravili neke izmene koje smo mi već pripremili za Komisiju za budžet, i podržati usvajanje ovog budžeta, u načelu. Hvala vam!

KRYESUESI: Falenderojmë deputetin Stojanoviq. Të nderuar deputetë, meqë numri i të paraqiturëve për debat është shumë i madh, është 47 deri më tani, propozojmë që të kemi një pauzë për drekë deri në orën 14,30.

Vazhdimi i sencës pas pauze

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Në sallë janë 70 deputetë, prandaj menjëherë mund ta vazhdojmë debatin. Fjalën e ka deputeti Agim Veliu.

AGIM VELIU: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

Të nderuar zëvendëskryeministra,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se të kaloj konkretisht në prioritetet strategjike arsimore, në të cilat duhet të ndalem pak më gjatë, dhe te buxheti i komunave, dua t'i them disa vërejtje në përgjithësi për buxhetin.

Krahasuar me buxhetin e mëparshëm, ky buxhet shënon avancim vetëm për nga sasia e mjeteve në investimet në infrastrukturë, por edhe më tutje mbetet një buxhet i natyrës emergjente, me qasje jozhvillimore.

Nëse është e vërtetë se prioritetet strategjike dhe politike duhet të përcillen me ndarjen e mjeteve përkatëse, qofshin ato materiale, financiare apo njerëzore, atëherë ky buxhet nuk i reflekton prioritetet.

Buxheti ka probleme në disa aspekte për nga struktura, qasja dhe ndarja e mjeteve në kundërshtim me prioritetet e deklaruara nga Qeveria.

Problemet sa i përket strukturës së qasjes i hasim sidomos te sistemi i arsimit të lartë, i cili identifikohet me Universitetin e Prishtinës, mungojnë fondet për financimin e masave për ndërtimin dhe funksionalizimin e arsimit të lartë, për avancimin dhe promovimin e procesit të Bolonjës dhe, mbi të gjitha, për zbatimin e autonomisë së shtuar të institucioneve të arsimit të lartë.

Në fushën e kërkimeve shkencore planifikohet vetëm përkrahja e instituteve, pa konkurrencë dhe pa kurrfarë programesh zhvillimore në fushën e shkencës.

Mungon përkrahja substanciale e arsimit profesional, mungon një informacion relevant dhe sinergji e bashkërenditjes me mjetet e donatorëve, mungojnë prioritetet e deklaruara të Ministrisë, por edhe të strategjive arsimore, mungon buxheti për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës, kurse sigurimi i cilësisë dhe akreditimi është prioritet i deklaruar qartë.

Në fushën e aftësisë të mësimdhënësve, shuma prej 120 mijë € është rreth 4 € për kokë mësimdhënësi, pra është një shumë kjo shumë e ulët në kohën kur pritet të bëhet zbatimi i licencimit të mësimdhënësve. Ky ka qenë njëri prej prioritetëve kryesorë të Ministrisë dhe të Planit strategjik 2007 – 2017. Po ashtu, mungojnë masat zhvillimore për përkrahjen e shkencës dhe të Këshillit Kombëtar të Shkencës. Mjetet priten të investohen

në shkencë pa konkurrencë, pa ofrimin e planeve dhe të projekteve nga institutet shkencore.

Kosova ndanë për Akademinë e Shkencës dhe të Arteve të Kosovës dhe institutet më pak se 1 milion €, që është më pak se gjysmë promili i bruto produktit vendor për shkencë, kurse nëse krahasohet kjo me vendet evropiane është 50 herë më pak se mesatarja e Evropës, e cila ndanë rreth 2% të bruto produktit vendor për shkencë.

Arsimi profesional është deklaruar si prioritet, ndërkaq nuk parashihen mjete të veçanta për zbatimin e këtij prioriteti.

Po ashtu kam vërejtje tek arsimi special për arsye se ky buxhet nuk parasheh më shumë mjete se buxheti i vitit të kaluar apo është tërësisht identik me buxhetin e vitit të kaluar, ndërsa dihet që përfshirja e kësaj kategorie në arsimin e Kosovës është vetëm 1%, ndërsa të gjithë treguesit thonë se kjo nuk dallon nga vendet tjera, diku kjo kategori është 11 ose 12%.

Anët pozitive të këtij buxheti, konkretisht për arsim, janë të parapara mjetet për implementimin e projekteve nga marrëveshjet bilaterale, që është mirë. Mjetet për zhvillimin e plan programeve, po ashtu, mjetet për infrastrukturë, mjetet për aftësimin e mësimdhënësve janë në rregull në aspektin struktural, por po e përsëris, nuk është sasi e mjaftueshme apo është e gabueshme sasia e mjeteve të alokuara.

Sugjerim: infrastruktura duhet planifikuar, investimet, projektet kapitale me dinamikë për t'i përfshirë jo vetëm ndërtimin, renovimin dhe sanimin e ndërtesave shkollore, por edhe projektet kapitale për kompjuterizimin e informatizimin e arsimit, futjen e lerningut në sistemin arsimor, demokratizimin e sistemit në përgjithësi dhe të shkollës, si dhe avancimin e qeverisjes në institucionet arsimore.

Sa i përket buxhetit të komunave, të gjitha komunat kanë përgatitur buxhetin e tyre konform Qarkores buxhetore 2009/1, e cila u është dërguar komunave në muajin gusht 2008. Sipas kësaj qarkoreje buxhetore, komunat është dashur ta miratojnë buxhetin e tyre gjatë shtatorit dhe t'ia dorëzojnë atë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, më së largu më 30 shtator 2008.

Në këtë qarkore buxhetore kanë qenë të definuar kufijtë buxhetor, të cilët kufij komunat i kanë respektuar dhe ia kanë dorëzuar me kohë buxhetet e miratuara Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Ndërkohë, më 24 tetor 2008, Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka nxjerrë Qarkoren e re buxhetore 2009/2, e cila ka përcaktuar kufijtë e rinj buxhetor, pas vendimit për rritjen e pagave të arsimtarëve. Me këtë qarkore buxhetore kërkohet nga komunat që vetëm për 5 ditë ta ndryshojnë buxhetin komunal, ta miratojnë atë në kuvende komunale dhe ta dorëzojnë në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave. Për shkak të kohës së shkurtër, disa komuna apo shumica e komunave nuk ishin në gjendje t'i përgatisin dhe t'i miratojnë buxhetet e tyre dhe, si rrjedhojë, buxhetet komunale të paraqitura në Projektbuxhetin 2009 nuk janë të miratuara në kuvendet komunale. Kjo i bën këto buxhete që të jenë në mospërputhje me ligjin, pasi që vetëm kryetarët e komunave i kanë nënshkruar këto buxhete.

Në buxhetet komunale janë ndryshuar disa pozicione. Pozicioni i mallrave dhe shërbimeve, ta zëmë, për vitin 2009 është 10% më pak se në vitin 2008. Duke ditur se ka

pasur rritje të çmimeve të furnizimit, zvogëlimi i buxhetit në këtë kategori do ta bëjë të pamundshëm furnizimin e rregullt të shkollave, të shtëpive të shëndetit dhe të institucioneve tjera komunale. Po ashtu, kisha kërkuar që pjesëmarrja në mallra dhe shërbime në nivelin qendror të jetë e barabartë me nivelin komunal. Unë vetëm po e theksoj se pjesëmarrja e nivelit qendror në mallra e shërbime është 15%, ndërsa në nivelin lokal është vetëm 8%.

Janë zvogëluar subvencionet, kurse në nivel qendror janë shtuar pagat e mësimdhënësve. Kur jemi te pagat e arsimtarëve, diku rreth 4 milionë nga grandet komunale u janë hequr komunave për ta mbuluar rritjen e pagave. Po e marr shembull vetëm komunën e Prishtinës, ku janë hequr nga kjo kategori rreth 700 mijë euro. Për shkollat e Prishtinës, por edhe të Kosovës në përgjithësi, kjo do të thotë më pak mjete mësimore, kështu që higjiena do të jetë më e keqe dhe do të ketë më pak mirëmbajtje, më pak ngrohje. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Ndoshta, do të ishte mirë që të mos diskutoni më shumë se 5 minuta, se sigurisht keni qejf para orës 17,00 të jeni në RTK. Pra, shkurtoni pak diskutimet, bëjeni një vetëcenzurë! Fjalën e ka deputeti Numan Baliq, le të përgatitet Fatmir Rexhepi.

NUMAN BALIQ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Mendoj që do të më lejoni të vazhdoj.

Selam svima koji su prisutni. Ja želim da kažem nekoliko riječi koje smatram važnim a vezano za ovu raspravu i da pokušam da dam jedan skroman doprinos ovoj diskusiji.

Ako je u pitanju budžet države, onda je to naravno pitanje prvog reda. Jasno je da nije ni malo lako napraviti budžet, da je to odgovaran posao pun izozova i da je naravno i pravljenje ovoga budžeta bilo takođe jedan veliki posao, naravno i sa velikim nedostacima.

Ja ću nastojati da, rukovodeći se onim upustom koje smo čuli, odnosno preporukom gospodina ministra, dam i neke predloge kojima bi moglo da poboljšam ovo što se radi na pravljenje budžeta Kosova.

Mislim da trebamo razdvojiti dve važne stvari. Mi najpre imamo glavne stubove ovoga društva, a oni se tiču penzionog fonda, socijalnog fonda, zdravstvenog sistema, obrazovnog sistema i policijsko pravosudnog sistema. To su osnovne poluge na kojima počiva jedno društvo. Nažalost, ima veoma malo promena u finansiranju ovih glavnih poluga. Ova vlada, ako pledira da bude uspešna vlada, da bude istorijska vlada, da napravi velike zaokrete, ona mora napraviti prave korake. Ovo jeste jedan korak napred, ali nije onaj odlučujući iskorak koji je potreban da bi se napravio istorijski zaokret i da bi ova vlada ostala zapamćena kao pravedna vlada i dobra vlada, koja bi bila dobra vlada za sve stanovnike, sve građane i sve narode koji u njoj žive. Ovo, naravno, govorim sa najboljim namerama.

Na drugoj strani, imamo dve osnovne stvari koji se tiču budžeta. Na jednoj strani, sistem sticanja dohotka, para, povećanja ukupnog dohotka, ekonomskog rasta, porasta društva, jačanja Kosova u svih smerovima. Nažalost, to za sada nemamo. Kosovo je i dalje najzaostalija država ne samo u Evropi, nego i regiji. I dalje imamo najniže lične dohotke, i dalje živimo u siromaštvu i sa vrlo malo perspektive. Samo oni najoptimističniji misle

drugačije. Znači, glavno je pitanje kako povećati ukupni budžet Kosova, kako riješiti sistem ubiranja poreza i taksa, kako napraviti efikasan sistem ubiranja carina, kako riješiti velike probleme, kako se suočiti sa kriminalom, korupcijom i svim negativnostima, zloupotrebama, krađama i svim onim lošim stvarima u svakome društvu, pa i u ovome, a koje značajno oštećuju budžet Kosova. Da bi smo imali para, moramo se obračunati sa onima koji troše, zloupotrebljavaju ili krađu te pare. Znači, rame uz rame sa borbom za povećanje ukupnog prihoda, odnosno budžeta Kosova, jeste obračun sa korupcijom i kriminalom. Nemamo jasnu viziju, nažalost, nemamo ponudjenu jasnu viziju u vladinom programu vezano za ovo korijenito pitanje kojim se može povećati ukupna vrijednost budžeta Kosova. Na drugoj strani, imamo pitanje povećanja plata. Molim vas, ovo je ključno pitanje. Pogledao sam u ovu šarenu brošuru ovdje i video sam da je šarena na njoj autoput i ono što mi je privuklo pažnju jeste, ne ovaj lijepi autoput o kome tek treba da ga doživimo, nego brojka 2009. Mi pripremamo novac za Kosovo za 2009 godinu, dakle tačno 10 godina od završetka rata, i gdje smo mi deset godina u našem Kosovu, novom Kosovu, sa našim institucijama, sa privremenim prije, a sada i konačno državnim vlastima na Kosovu. Naravno da je ovo prva vlada nakon sticanja nezavisnosti, ali su izazovi stari i, nažalost, problemi stari. Deset godina poslije, naše su plate potpuno iste, mi nemamo povećanje plata. Molim vas, gospodine ministre i gospodine premijeru, koji nije ovde, njegovi zamenici, mi nemamo povećanje plata. Povećanje plata od deset posto nije povećanje plata. To je neozbiljna šala. Pravo povećanje plata jeste najmanje 50% u prvoj polovini 2009. godine, i naravno narednih 50% u drugoj polovini te iste godine u okviru razmatranja ili čuvenog rebalansa budžeta. Ovo je pitanje kojim se bave vrhunski ekonomisti. Dakle, mi moramo povećati plate najmanje 50% za policiju, sudove, zdravstvo, obrazovanje, penzioni i socijalni sistem. Šta sada imamo, pogledajte samo molim vas, pregled tabelarnih prihoda po kolonama, inače sam primetio da te najvažnije kolone su pisane najsitnijim slovima. Tamo gde ima najviše para, najmanja su slova. Dakle, molim vas, uvećajte ta slova i uvećajte te pare koje su namenjene svim javnim službenicima.

Evo nekih prijedloga koje bih dao: vezano za penzije – penzioni sistem mora pretrpjeti korijenite promene, mora. Moraju se razdvojiti penzije koje su nastale kao proizvod doprinosa i davanja od tkz. osnovnih univerzalnih penzija. Naravno, neko ponovo pametan se našao pa je izmislio ovaj rogobatni famozni naziv osnovne univerzalne penzije koje, u stvari, trebaju se napraviti pripreme da se one smeste u kategorije socijalnih izdataka, a ne penzija. Dalje, Vlada mora konačno dati javno odgovor – šta je sa doprinosima koji su dati do 99-te godine. Šta je sa starim penzionerima. Gdje su pare za stare penzionere i šta je sa tim, jer nijednom nijesmo dobili zvanični izveštaj. Da li čekamo da ti stari penzioneri poumru, pa da to pitanje nestane, ili će ova vlada ili neka naredna vlada dati odgovor na pitanje – šta je sa penzionim davanjima. Drugo, socijalna oblast. 34. miliona evra, molim vas, premalo je za socijalna pitanja i za socijalne slučajeve i familije sa socijalnim problemima. To je manje od 3% ukupnog kosovskog budžeta. Naravno da ne želimo da Kosovo ima budžet socijalne države, ali je 34. miliona premalo za socijalno ugrožene i oni se moraju povećavati u skladu sa ukupnim povećanjem svih plata.

Vezano za Ministarstvo za zajednice, ovde želim da kažem nešto veoma važno. Budžet koji je, navodno, predstavljen veoma afirmativno od 8,7. miliona i koji je pohvaljen kao onaj koji je, eto, učinkovit i kojim će se nešto popraviti u pitanju zajednice i njihovog povratka, ja moram da kažem, sa 8. miliona evra nema ni zajednica, ni povratka, molim vas. Ispod svakog nivoa je da 0,6% ili 0,7% od ukupnog budžeta Kosova bude

namenjeno za zajednice i povratak. Taj budžet mora biti 15 puta veći, ali ako je to preveliko, krenimo bar dvostruko ili trostruko više. Saznao sam u pauzama da je Ministarstvo za povratak tražilo udvostručenje tog budžeta. Mislim da je to bio jedan nužni minimum od koga se moralo poći.

Vezano za zdravstvo, naravno da ohrabruje činjenica da je povećan budžet na 66. miliona evra i da to povećanje iznosi oko 15% u ministrovnoj verziji, odnosno u popravljenoj premijerovoj verziji 14,5%, odnosno zamenio sam uloge. Dakle, budžet Ministarstva zdravstva mora biti značajno povećan. Mi smo, molim vas, sinoć čuli zastrašujuću izjavu predsednika ili predstavnika Svjetske zdravstvene organizacije koji je govorio da na Kosovu nema zdravstvenog sistema. Mi moramo biti ozbiljno zabrinuti time da na Kosovu, bukvalno sada, imamo zdravstvo kome, izgleda, nema ozdravljenja. Moramo naći načina da izlečimo zdravstvo, moramo povećati budžet Kosova, moramo promijeniti sistem menadžiranja i uložiti u menadžiranje, moramo promijeniti sistem organiziranja i uložiti u organiziranje, moramo riješiti i ovaj sistem, odnosno ovu stavku koja se tiče programa za lijekove uprkos tome da je količina novca povećana, i to je ohrabrujući potez od 16. miliona evra, to je i dalje veoma malo. Međutim, stavka koja se tiče familijarne medicine je veoma mala. Ako familijarnu medicinu tretiramo kao predstražu ukupnog liječenja i ako se podrazumijeva da će ona izliječiti 80% bolesti, onda 1.1 milion evra je zaista premalo, tako da svi ovi problemi, zajedno sa ključnim problemom u zdravstvu, a to je formiranje zdravstvenog osiguranja. Fond za zdravstveno osiguranje, gospodo, još uvek nije osnovan. Mi ne možemo imati zdravstvo bez fonda za zdravstveno osiguranje. Apelujem na ovu vladu da ozbiljno razmotri i da u prvo polugodište naredne godine uvrsti obavezno one finansijske implikacije koje se tiču pokretanja šeme za pravljenje fonda za zdravstveno osiguranje. I naravno da je fond za liječenje van Kosova, odnosno u inostranstvu, tek oko 1. milion evra, što je daleko od onog što je poželjno. Da napomenem i to još da Kosovo, kao tipična ruralna sredina, kao tipična seoska sredina, u Ministarstvu za poljoprivredu ima predviđenih tek 2,1. milion evra za seoski razvoj. Molim vas, to je ispod 0,2% . Kosovo koje je tipična seoska sredina, odvojila je tek dva hiljadita dijela budžeta Kosova za razvoj sela. Mislim da je to nevjerovatno, da je to zaista za podsmijeh ukupnog razvoja poljoprivrede i seoskih područja...

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Fatmir Rexhepi, le të përgatitet deputeti Driton Tali.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Debati parlamentar ka rëndësinë e vet për arsye se edhe impakti që ka buxhetin në jetën politike dhe ekonomike të vendit është i madh, kështu që unë me këtë rast do të theksoj shqetësimin tim se si do ta nisim vitin 2009 përballë sfidave si problemet që derivohen nga çështjet politike dhe ambienti për investime, problemet sociale dhe problemet të transicionit ekonomik, problemet energjetike dhe politika e investimeve të gabuara, mbajtja e fondeve të privatizimit dhe Trustit të Pensioneve, sistemi arsimor dhe formimi profesional jo kompatibël me kohën, problemet e qarkullimit të lirë dhe liberalizimi i vizave, iniciativa dhe strategjia e privatizimit të ndërmarrjeve publike, si dhe implikimet e mundshme të krizës globale në ekonominë tonë vendore.

Duke i potencuar këto, provoj të vi deri të konstatimi se viti 2009 do të jetë me shumë sfida dhe aspak i lehtë për Qeverinë e koalicionit dhe institucionet kosovare në përmbushjen e synimeve zhvillimore, të kërkesave për paga dhe të mbajtjes së parametrave makroekonomikë.

Pas analizës së Projektbuxhetit, unë përkrah në parim objektivat dhe elementet që i ka ky buxhet, siç është pretendimi që të jetë buxhet i qëndrueshëm dhe në funksion të zhvillimit të ekonomisë, politikat e harmonizuara të koalicionit që do të rrisin fonde për arsimin, shëndetësinë, kulturën dhe sundimin e ligjit, ndryshimin e politikave fiskale dhe lehtësimet tatimore për biznes, objektivat për rritjen e bruto produktit vendor dhe stabilitetit makroekonomik, përmirësimin e bilancit tregtar dhe zvogëlimin e deficitit buxhetor, ndryshimin e mënyrës së menaxhimit dhe të shpenzimeve të parasë nga arka e shtetit. Pra, përkrah parimisht krijimin e fondit rezerv, si dhe kodin e shfrytëzimit të tyre në rastet emergjente.

Lus ministrin e Financave që të japë një shpjegim në mënyrë që ta heq dilemën time që ky si buxhet i qëndrueshëm, a garantojnë të hyrat e planifikuara se kjo, vërtet, do të jetë kështu për vitin 2009?

Mendoj që duhet të ndryshohen disa nga strategjitë dhe politikat në këto raste, që të kemi një ndarje të investimeve nëpër komuna më mirë se kjo që ka ndodhur këtu brenda këtij buxheti, që të kemi investime më të mëdha në arsim, shëndetësi dhe në Fondin për rini dhe ambiente sportive. Të parashihen investime në rehabilitimin e ujësjellësit në disa qytete, sepse humbjet janë shumë të mëdha e furnizimi gjatë verës është shumë i vështirë. Po ashtu, të parashihen më shumë mjete në ruajtjen e ambientit dhe trajtimin e ujërave të zeza. Më këtë rast, edhe njëherë e ritheksoj atë borxhin që ka mbetur për komunën e Gjilanit, pra edhe një milion € të tjera, bashkë me Suharekën edhe ndonjë vend tjetër, si dhe të rritet Fondi për kreditim dhe subvencionim në sektorin e bujqësisë, i cili nuk është në projektbuxhet.

Nuk pajtohem në asnjë mënyrë me politikat në sektorin e energjisë. Jam kundër kreditimit të subvencionimit të KEK-ut- 80 plus 40 milionë për import. Është detyrë e Ministrisë, e KEK-ut dhe përgjegjësi e këtij të fundit për të prodhuar energji elektrike me kapacitete prej 950 megavat, sepse që disa vjet janë bërë të gjitha investimet, remontet janë krye, prandaj duhet t'i kthehet përformanca dhe menaxhimi më i mirë i KEK-ut. Nuk ka asnjë arsye që të vazhdohet më tutje me kreditimin dhe subvencionim në KEK, mund të jenë ndonjë rezervë e caktuar 10 – 15 milionë për ndonjë rast krize, por në asnjë variant me atë shumë çfarë është bërë. Pra, mjetet tjera duhet të orientohen në sektorë të tjerë dhe në infrastrukturë.

Po ashtu, edhe njëherë dua ta ritheksoj përsëritjen e gabimit sa i përket politikave të investimeve në infrastrukturën rrugore për vitin 2009. Edhe në shkurt, kur e kemi miratuar buxhetin e këtij viti, unë kam reaguar edhe me këtë rast po reagoj, sepse është një politikë e njëjtë.

Pra, janë planifikuar gjithsej 103 milionë euro, që është në rregull sa i përket infrastrukturës, por nga strategjia që është ofruar dhe politikat e ndarjes nuk keni paraparë ndërtimin e asnjë rruge magjistrale, rajonale dhe urbane në rajonin e Gjilanit dhe të Ana Moravës prej Ferizajt në Viti e deri në akset rrugore Preshevë – Bujanoc. Prandaj, më së miri këto mund t'i shohim në tabelat edhe në atë që e vërtetoi Kryeministri në ekspozenë e vet, i cili, po ashtu përmendi shumë autostrada e të tjera, por nuk e tha asnjë fjalë të vetme për këtë rajon se a ka auto-udhë apo auto-hekurudhë në këtë rajon? Ja ku janë këto që i ka projektuar Qeveria, pra asnjë auto-udhë dhe asnjë auto-hekurudhë për këtë territor.

Mendoj që u mbetemi borxh 300 mijë qytetarëve edhe mbi 12 mijë afaristëve për kontributet që i japin. Unë kërkoj investimet të jenë harmonike për zhvillim të barabartë të gjitha rajoneve, mendoj se nuk e meritojnë as rajoni, as Gjilani këtë diskriminim.

Ndoshta, na ka habitur ai decentralizimi i famshëm, por për fat ende Gjilani ka mbetur pjesë e Kosovës, kështu që duhet të investojmë më shumë të mos na krijohet një zonë çfarë veç ka pretendime.

Në fund, duke ju falënderuar, megjithatë më lejoni, domethënë që të kërkoj edhe nga koalicioni qeveritar, nga grupi parlamentar dhe deputetët ndryshimet e nevojshme dhe një harmonizim të plotë deri në leximin e dytë, në mënyrë që vërtet të kemi investime harmonike dhe perspektivë të zhvillimit të barabartë ekonomik në të gjitha zonat e vendit. Prandaj, deri në leximin e dytë, kur do t'i kodifikojmë dhe amendojmë këto, unë e përkrah në parim, kurse për leximin e dytë do t'i shqyrtojmë bashkërisht dhe do të marrim vendimin se a duhet të votohet apo jo më tutje buxheti i ofruar? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Driton Tali, le të përgatitet deputetja Synavere Rysha.

Ju lutem për mirëkuptim, sepse është bërë një ngatërrim, por jo me qëllim.

DRITON TALI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Fillimisht më lejoni të shpreh një dëshirë se Televizioni Shtetëror do të na përcjellë, sidomos Redaksia e lajmeve qendrore të Televizionit Shtetëror t'i japë pak më shumë hapësirë Parlamentit, në mënyrë kështu speciale, kur të kritikohet Qeveria. E di se pastaj do të kemi problem me shefat e tyre, por megjithatë, për hir të shikuesve të tyre, le të jenë më objektiv, e jo veç të na humbin kohën atje me selame, me zahrete, kush erdh e kush na pa.

(Ndërhyrje e Kryetarit, Televizioni, nuk të ka veç ty, o Driton)

Ishte një kritikë për shkak se e paguaj edhe unë Televizionin Shtetëror, kështu që si shikues. Sidoqoftë, t'i kthehem buxhetit. Duke pasur parasysh se shumë deputetë këtu folën dhe shumë të tjerë do të flasin, për të mos ua marrë edhe atyre kohën, por edhe për të mos i përsëritur gjërat, do të ndalem në dy-tri pika që mendoj se janë esenciale: në të hyrat, që mendoj se nuk qëndrojnë në mënyrën se si janë planifikuar këto, dhe në ato premtimet që partia më e madhe në koalicion i ka dhënë në funksionalizimin e aparatit shtetëror në rritjen e efikasitetit. Nëse e shikojmë këtë buxhet dhe i bëjmë analizat, do të shohim se trendët do të vazhdojnë ngjashëm. Ndonëse, po them edhe njëherë, kjo rritje e të hyrave 68 milionë nuk qëndron, por megjithatë planifikimi është bërë në mënyrë të ngjashme. Për shembull, nëse e marrim e shikojmë përqindjen e të hyrave tatimore në krahasim me të hyrat e përgjithshme, do të shohim se nuk ka ndonjë ndryshim, domethënë 77% sivjet, vjet ka qenë 87%, në 2007 ka qenë 79%, në vitin 2006 ka qenë 87%, domethënë kjo veç tregon se aparati shtetëror nuk do ta rritë efikasitetin e vet në kuptimin e rritjes së të hyrave tatimore karshi të hyrave të përgjithshme.

Po ashtu, edhe shpenzimet janë në trendin e njëjtë. Nëse i marrim dhe i shikojmë pagat dhe mëditjet, do të shohim se një gjë e tillë, është një përqindje e tillë, p.sh. në vitin 2009 parashihet të jetë 27%. Përqindja e shpenzimeve në paga dhe mëditje krahasuar me të

hyrat e përgjithshme ka një rritje. Vjet ka qenë 25%, në realitet 23 për qind, në vitin 2006- 28%, domethënë aty është një përqindje shumë e vogël në rritje apo në ulje.

Po ashtu, edhe shpenzimet në mallra apo përqindja e shpenzimeve në mallra, krahasuar me të hyrat e përgjithshme vazhdon ngjashëm. Domethënë, e kemi sivjet 16.8%, vjet ka qenë 17.22%, e kështu me radhë. Pra, këto përqindje tregojnë se filozofia e mbledhjes së buxhetit dhe e shpenzimit të buxhetit nuk ka ndryshuar, përkundër premtimeve të shumta, madje edhe sot ministri me plotë gojë tha se ky buxhet është ndryshe, por të dhënat nuk e tregojnë këtë.

Tash t'i kthehem pak kësaj rritjes reale 68 milionëshe, ku parashihet apo është llogaritur në bazë të rritjes së tatimeve në kufi, që parashihen të jenë 80.6 milionë apo 665.3 milionë, pra 13.7% rritje e tatimeve në kufi. Është interesant, në faqe 11, dikush ndonjë makro ekonomist aty, që të paktën i kupton këto gjëra, ka paraqitur që inflacioni do të ulët në vitin 2009, po ashtu madje pritet edhe deflacion. Dhe, nëse nisemi nga fakti se tatimet në kufi mbushen apo merren nga fatura apo llogariten nga shuma totale e faturave të mallit, unë nuk di si i kanë llogaritur këto 80.6 milionë, kur çmimet e produkteve të importit në Evropë do të bien. Veç kemi zbritje të madhe në industrinë apo në fushën e patundshmërisë, kemi zbritje në industrinë automobilistike, kemi zbritje të çmimit të naftës, nafta ka rënë në 53 dollarë për barelë, që domethënë kjo do të reflektohet shumë shpejt dhe është çmimi më i ulët që një vit e sa dhe pritet që të bjerë. Pastaj, janë edhe çmimet e konsumit të gjerë që bien, do të thotë, do të ulen. Kushdo që e ka lexuar një libër të mirë të ekonomisë, por jo të këtyre ekspertëve tanë që nuk merr vesh gjë në dynja në to, e di që në kriza ekonomike ka deflacion, për shkak se ndërmarrjet i ulin çmimet e produkteve të tyre për ta stimuluar konsumin, qofshin ato produkte fizike apo shërbime, madje punojnë edhe nën margjinë. Atëherë, po them, duke supozuar se ne do t'i menaxhojmë pikat kufitare 1 dhe 31, pra duke pasur parasysh edhe këtë, unë nuk di prej nga do të rriten këta 80.6 milionë në dogana kur çmimet e importeve, të produkteve do të ulen për shkak të trendit. Vetvetiu do të ulen edhe faturat e kamionëve me mall që vijnë këtu. Unë po them se kushdo që merret pak me makroekonomi, që ka pak njohuri në ndërmarrësi, sidomos në tregti, është dashur t'i dijë këto gjëra, por nëse është tentuar që të na hidhet hi syve, ajo është çështje tjetër.

Është mirë që sa u përket tatimeve të brendshme, keni parë se do të ketë ulje dhe supozimi është se do ta bëni ndryshimin e politikës fiskale, që përsëri po them, duke pasur parasysh, sidomos PDK-në, e cila njihet si parti e majtë socialdemokrate, parti e masave, me këtë paketë fiskale ua tejkalon edhe partive më radikale liberale. Domethënë, nga tash PDK-ja më nuk është e masave, por është e elitës, është e biznesmenëve, e korporatave të mëdha. Shikoni, ju me këto ndryshime fiskale, sidomos në të ardhura që i propozoni, do të prekni në mënyrë direkte fukaranë. Nuk thuhet kot: "fukaraja i mbanë dy shtëpi". Me këtë politikë tuajën fiskale, njëmend do t'i mbajë dy shtëpi dhe tri. Domethënë, ia ngritni TVSH-në, që në mënyrë direkte e prek fukaranë.

Pak është një farë ndryshimi në të ardhurat mesatare. Nëse i marrim 250 euro, do të jetë shumë minimale, diku të them, i bie një euro e diçka. Në realitet, po ju tregoj edhe saktësisht, në 250 euro do të përfitojnë 2.5 euro. Do të jenë më mirë ata që i kanë 250 euro, që marrin paga, kurse këta që marrin më shumë se 700 euro, do të kursejnë rreth 40%, e këta mbi 1500 euro, që janë ministra, për shembull, edhe deri 100% në tatim në të ardhura. Andaj, po them, kjo parti po tregohet shumë më miqësore ndaj milionerëve, por jeni parti e milionerëve, atëherë edhe është mirë ta shikoni veten.

Tashti do të ndalem edhe në një përparësi konkurruese, të cilën ky koalicion qeveritar mundohet ta fitojë dhe, në realitet, jeni treguar më të shkathtë se Qeveria e kaluar në investimet kapitale. Por, megjithatë, edhe në investimet kapitale çaloni, domethënë, keni realizuar apo keni utilizuar 23%, që nuk është aq mirë sa pretendoni të jeni. Aq më shumë, keni edhe suficit, që është 250 milionë, domethënë, sipas ministrit që thotë se 118 milionë janë suficit, kurse 131.2 nënshpenzim. Mirë boll!

E nderuara Qeveri, dita- ditës ato premtimet tuaja që në fillim i dhatë me entuziazëm, jeni kah i anashkaloni. Edhe ky buxhet është konform menaxhimit tuaj. Me shpresë se do të përmirësoheni, unë po iu përshëndes, më falni, s'po ju përshëndes, por po e përfundoj këtu. Këtë buxhet nuk mund ta miratoj, ani pse e di se do të kalojë. Po ashtu, e di se kah korriku përsëri do të na sillni Projektligjin për ndryshimin e këtij buxheti, se nuk do të dalin shifrat. Shifrat i keni të fryra, nuk janë të qëndrueshme 80 milionë që...

KRYETARI: Faleminderit, deputet!

Fjala është për Synavere Ryshën, le të përgatitet, pasi po kërkon rend, Naser Rugova. Driton, veç një fjalë, e djathta dhe e majta i kanë ndërruar rolet.

SYNAVERE RYSHA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, kur po diskutojmë për buxhetin e Kosovës, respektivisht për ndarjet buxhetore për vitin 2009, duhet pasur parasysh se bartim me vete përgjegjësi të lartë para qytetarëve të Republikës së Kosovës, sidomos tatimpaguesve, andaj duhet kushtuar vëmendje dhe kujdes të veçantë ndarjes së drejtë dhe në mënyrën sa më të mirë të mundshme.

Tashmë është bërë praktikë që buxheti të përgatitet dhe të hartohet për një periudhë afatmesme, domethënë për një periudhë tri vjeçare, por si është pasqyruar ky buxhet në materialin të cilin na e ka ofruar Qeveria apo në Projektbuxhetin për vitin 2009, apo cili është buxheti të cilin do ta kenë qytetarët në disponim të Republikës së Kosovës për vitin 2009?

Buxheti i planifikuar për vitin 2009 kap shumën 1.094.300.000 euro shpenzime, karshi të hyrave që do të jenë 956.000.000 euro të planifikuara. Nga kjo shihet një mungesë e mjeteve prej 138.000.000 dhe nuk jepen sqarime të mjaftueshme se si do të kompensohet kjo shumë, ndoshta nga donatorët, sepse edhe jemi mësuar.

Dy gjërat që e karakterizojnë Buxhetin e vitit 2009 janë ndarja e mjeteve në një shumë kaq të madhe për Ministrinë e Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, për rrugët dhe urat dhe, shikuar nga aspekti i pozicionit në buxhet, mallra dhe shërbime, del se kjo ministri është ministri lidere, apo ministri - prioritet i Qeverisë.

Një çështje tjetër është kredia ndaj KEK-ut në vlerë prej 80.000.000 eurosh, edhe këtë vit për KEK-un ndahet kredi, më vonë për t'u shitur.

Një çështje që të shqetëson dhe të brengos është brengosëse edhe për qytetarët e Republikës së Kosovës, është mosparaqitja e mjeteve të grumbulluara nga Fondi i Privatizimit në Buxhetin e vitit 2009. Asnjë fjali e vetme e shkruar për ato mjete nuk në këtë material, nuk është dhënë asnjë shifër në tabelat e buxhetit për këto mjete dhe këtu

do të ndalem pak dhe do t'i shtroj këto pyetje për Qeverinë apo edhe për ministrin dhe kërkoj përgjigje në këtë pyetje.

Zoti ministër, a ekziston Fondi i Privatizimit dhe, nëse po, sa është shuma e mjeteve nga privatizimi? Ku janë ato mjete, në cilin vend po ruhen, pse nuk i keni pasqyruar në Buxhetin e vitit 2009 dhe çfarë ka ndërmend Qeveria të bëjë me ato mjete? Dhe, së fundi, në cilin raport do t'i paraqesë ato mjete Qeveria, pasi që në buxhet nuk janë paraqitur?

Po ashtu, nuk thuhet asnjë fjali e vetme për Trustin Pensional të Kosovës, asnjë sqarim për deputetët, por edhe për qytetarët.

Do të vazhdoj më tutje me investimet në Ministrinë e Arsimit, 37.000.000 €. Nëse analizohet mirë ajo që përshkruhet në atë që paraqitet në tabelë, del se nga katër synimet që ka kjo ministri, vetëm një është i arritshëm dhe atë ndërtimi i objekteve shkollore. Referencë, tabela nr. 3.15 - Financimet e projekteve të arsimit, që nga projekti i parë e deri te projekti i fundit ka vetëm ndërtime. Fillon me ndërtimin e shkollës në komunën e Skenderajt dhe përfundon tabela e projekteve- vazhdimi i punimeve në konviktin numër 4 në Prishtinë. Dhe, kur merren parasysh investimet në Ministrinë e Transportit dhe në Ministrinë e Arsimit, del se 140.000.000 euro po investohen vetëm në ndërtime. Kjo mund t'i gëzojë, ndoshta, bizneset ndërtimore, por jo edhe bizneset tjera sepse, të paktën, kanë mbetur të diskriminuara, por jo edhe pritjet tjera të shoqërisë, sepse shoqëria nuk pret vetëm ndërtime, vetëm ura, vetëm rrugë, pret edhe më tepër.

Ju keni premtuar edhe projekte tjera për vitin 2009, por ato mbetën vetëm premtime. Më tej, në material thuhet se ka kursime të konsiderueshme në pozicionin - mallra dhe shërbime nëpër organizata buxhetore. Po jap vetëm një argument, që e thotë të kundërtën. Në tabelën 2A - Buxheti i nivelit qendror, pas Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave është radhitur Agjencia Kosovare e Privatizimit, që punëson 17 punëtorë. Kategoria e pagave është 34,000.500 euro, që i bie 169 euro pagë mujore për të punësuarit.

Në pozicionin - Mallra dhe shërbime është ndarë shuma 3.106.213 € dhe i bie që për një punëtor të shpenzohet për kategorinë për mallra dhe shërbime 15.226 euro në muaj, domethënë 169 euro pagë mujore, 15.226 euro për mallra dhe shërbime në muaj. Çka thotë kjo? Nuk e di!

Dy kategoritë më të rëndësishme që mund të ndikojnë dukshëm në zhvillimin ekonomik, pa dyshim se janë përkrahja e bujqësisë, që është më lehtë e realizueshme dhe më pak e kushtueshme dhe përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, nuk janë përfillur në ndarjet buxhetore. Qeveritë e mëdha dhe të zhvilluara në botë ecin përpara apo zhvillimin ekonomik e shohin duke i përkrahur ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndërsa shteti ynë i varfër, Kosova, po ua rikujtoj anëtarëve të Qeverisë, me 15% varfëri të skajshme, me 46% varfëri në përgjithësi, me më tepër se 80.000.000 euro ka përkrahur korporatat e mëdha për t'i privatizuar më vonë.

Edhe ato pak mjete që janë ndarë për bujqësi dhe pylltari, një pozicion që më ka bërë përshtypje në projektet për bujqësi, ndahet në këtë mënyrë: 158.000.000 € për pyllëzim të sipërfaqeve të zhveshura, që është një veprim shumë konkret, dhe 214.555€ planifikohen të shpenzohen për hartimin e planeve menaxhuese. Për të mos vazhduar më tutje me një përmbledhje të shkurtër, Buxheti i vitit 2009 karakterizohet edhe më tutje me një qasje vetëm nga rrugët dhe urat, diku me 103.000.000 euro, me kredi 80 milionëshe për KEK-

un, mandej për ta shitur, pa u ditur fare mjetet nga Fondi i Privatizimit, me injorim të mëtutjeshëm dhe mospërkrahje të sektorëve të rëndësishëm të ekonomisë, e çka tjetër.

Pensionistët në vitin 2009 do të kënaqen vetëm me 5 € shtesë, sepse kështu ka menduar Qeveria për ta, edhe pse ndryshe iu ka premtuar. Arsimtarët do të vazhdojnë të punojnë dhe për ta nuk do të ketë rritje. Qeveria, rritje pagash ka planifikuar të ketë vetëm 10% për shërbyesit civilë, por kur llogariten trendët e zhvillimit apo edhe inflacioni që është shkaktuar, edhe këtu nuk do të ketë rritje. Ky pra është Buxheti i konsoliduar i Kosovës për vitin 2009. Si të tillë, nuk mund ta përkrahim, prandaj kërkoj që ta ktheni në rishqyrtim, t'i inkorporoni vërejtjet e deputetëve dhe të na e sillni në seancë tjetër për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka Naser Rugova, le të përgatitet Gani Geci.

NASER RUGOVA: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuari Kabinet qeveritar,

Më lejoni që në fillim të them se ky buxhet as për së afërmi nuk plotëson kërkesat dhe nevojat e shumta të qytetarëve të Kosovës dhe më së paku iu ofrohet premtimeve pompoze të koalicionit aktual qeverisës. Po citoj fjalën hyrëse të ministrit të Ekonomisë dhe Financave: "Struktura e buxhetit respekton prioritetet kyçe të kësaj Qeverie, që janë: rritja ekonomike, implementimi i statusit, qeverisja e mirë dhe stabiliteti social" Vazhdon: "Duhet të gjenerojmë rritje ekonomike, duhet të përpiqemi për të siguruar një mjedis, ku sektori privat mund të shtojë aktivitetet e tij dhe të fillojë me krijimin e vendeve të reja të punës". Do të ishte mirë, zoti ministër, por gjithnjë thoni - duhet të përpiqemi, por si dhe me çka? Me këtë buxhet, kurrësi! Këto që ju i keni cekur, janë vetëm dëshira të mira dhe asgjë më shumë. Citoj më tutje: "Për ata persona që janë në situatë të pafavorshme, duhet të përpiqemi për sigurimin e një rrjeti të sigurisë sociale". Po, çka nëse nuk arrihet të sigurohet përkujdesje sociale për një pjesë bukur të madhe të shoqërisë sonë, dhe përgjigja është e gatshme: rritja e shkallës së varfërisë, e papunësisë, dhe venitje shpresash të qytetarëve të vendit tonë se jemi në rrugë të gabuar.

Në faqen 4, te politikat prioritare të Qeverisë dhe Korniza makro fiskale thuhet: "Buxheti i shpenzimeve kapitale në vlerë prej 413.000.000 eurove i mbështet prioritetet kryesore të dakorduara nga ana e Qeverisë. Nga kjo shumë, 103.000.000 € janë ndarë për infrastrukturën rrugore, 37.000.000 € për arsim dhe 12.500.000€ për shëndetësi. Këto shifra flasin se çfarë zhvillimi ekonomik na pret në vitin 2009 dhe çfarë diskrepancash buxhetore ka në mes të Ministrisë së Transportit dhe Postë Telekomunikacionit, asaj të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë. Cili është mesazhi për qytetarët e Kosovës, se në vitin 2009 të shpresojmë që do t'i ruajë Zoti, sepse Qeveria nuk është lodhur fare për përkujdesjen shëndetësore minimale dhe kjo flet mjaft.

Po citoj faqen 5 të këtij Projektbuxheti: "Me përjashtim të mësuesve të cilët janë duke përfutur aktualisht nga ngritja substanciale e pagave, Qeveria gjithashtu, ka përfshirë edhe rritjen uniforme të pagave për të gjithë shërbyesit civilë në vlerë prej 10%".

Të nderuar qeveritarë,

Ku janë punëtorët shëndetësorë, ku është Policia e Kosovës, ku është administrata publik? Nuk paska rritje pagash 100% që keni premtuar? Fjala publike e një kryetari të partie, e një udhëheqësi, e një ministri, kur thuhet para qytetarit, nëse nuk mbahet, dihet cilat janë komentet, pastaj. Kjo flet mjaft për seriozitetin e kësaj Qeverie karshi qytetarëve të vendit tonë.

Zoti ministër, çka do të bëhet në vitin 2009 me pensionistët dhe invalidët e punës, a e keni paraparë në buxhetin tuaj koston e zbatimit të Ligjit për pensionet dhe invalidët e punës, i cili fatkeqësisht nuk na ka ardhur ende në Parlament dhe e keni premtuar me të madhe se, bile, do të kalojë procedurat parlamentare në këtë vit? Siç po shihet, premtimet tuaja pompoze do jenë edhe një zhgënjim i radhës për këtë kategori me vetëm 5 € rritje. Bëhet fjalë për 189 mijë familje kosovare.

Në faqen 50, ku flitet për zbatimin e ligjit, thuhet: “Të gjitha agjencitë që janë në funksion të zbatimit të ligjit, do të vazhdojnë t’i hetojnë dhe t’i ndjekin penalisht veprimtaritë kriminale dhe korrupsionin” Por, me ndarje buxhetore e bëni të kundërtën. Vallë, a mjaftojnë vetëm 439.103 euro për Agjencinë kundër Korrupsionit të Kosovës, që ta luftojë korrupsionin në rritje, sidomos në këtë vit. Vetëm bëni një krahasim të pagave ndërmjet Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe agjencive tjera të zgjedhura nga ky Kuvend dhe do të shihet diskriminim i hapur.

Keni premtuar si Qeveri se do t’i plotësoni të gjitha kërkesat e Agjencisë kundër Korrupsionit, por po e bëni të kundërtën. Çfarë agjencie me 15 punëtorë mund ta luftojë këtë ortek që e ka përfshirë prej Presidence, Qeverie, edhe Kuvendin, që sot e kësaj dite Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk ka përgjegjësi për prokurim. Herë vjen dikush prej një komune, herë tjetër me korrespondencë, në institucionin më të lartë legjislativ të vendit.

Kjo ndarje buxhetore flet mjaft për mungesën e vullnetit politik të këtij koalicioni qeverisës që të sundojë rendi dhe ligji dhe të luftohet korrupsioni. Nuk na pranon Evropa me këto prioritete buxhetore, me këtë qasje politike që jeni duke vazhduar në kontinuitet.

Edhe sektori i bujqësisë, si një nga sektorët kyç për zhvillimin ekonomik të vendit tonë, është lënë në mëshirën e fatit nga Qeveria e vendit. Çka do t’ju thoni bujqve, fermerëve dhe agro-prodhuesve të Kosovës me vetëm 12.000.000 €? Mesazhi i këtij buxheti për ta është - gjenduni si të dini e të mundeni!

Kurse për kulturën, rininë dhe sportin kosovar, Qeveria e vendit nuk ka paraparë buxhet, por ka ndarë një farë lëmoshe dhe kjo nuk mund të quhet ndryshe, përveç se paradoks për një kategori më të madhe në numër dhe më vitale të kombit, ku e përfshinë edhe sportin, tani duhet të anëtarësohen nëpër federata ndërkombëtare, të ndërkombëtarizohet si shtet, i keni ndarë diku 11.000.000 euro.

Tek sektori i shëndetësisë, pika ma e zezë e shëndetësisë kosovare, na tha shkoqur Organizata Botërore e Shëndetit: ”Vërjani drynin këtij sistemi shëndetësor dhe kësaj ministrie”! Vërtet, nuk është kritikë opozitare, kjo i ka kalua kornizat, por është një apel për gjendjen e tmerrshme që sundon në sistemin shëndetësor të vendit. Dhe, me të drejtë keni konstatuar se gjendja shëndetësore është ndër më të rëndat në Evropën Juglindore.

Të nderuar qeveritarë,

Tash e paskeni kuptuar që sistemi shëndetësor i vendit është para kolapsit të plotë. Para ca muajve keni pasur fjalë të tjera. Me këtë ndarje buxhetore i pret një vit tejet i vështirë pacientët e lodhur kosovarë dhe punëtorët shëndetësorë tashmë të mbështetur për muri.

Të investohen për dy vjet më tepër se 150.000.000 euro në asfalt dhe të ndahet një buxhet i mjerë për shëndetin e qytetarëve të vendit, është më tepër se papërgjegjësi.

Me këtë buxhet nuk ka fond të sigurimeve shëndetësore, nuk ka barëra për nevojat e qytetarëve, por me këtë buxhet, të nderuar qeveritarë, ju ua keni hapur dyert pacientëve të vendit tonë drejt Shkupit dhe Beogradit, që është në rritje ky trend fatkeq për qytetarët e Kosovës, sepse nuk kanë Qeveri, nuk kanë Ministri të Shëndetësisë, nuk kanë institucione.

Kur të gjitha këtyre ua shtojmë edhe vërejtjet serioze të Fondit Monetar Ndërkombëtar, drejtuar këtij projektbuxheti, atëherë vërtet qytetarët e Kosovës do të vazhdojnë të jetojnë me përditshmërinë tejet të rëndë, gati të papërballueshme dhe pa shpresa për rrugëdalje. Secili deputet normal nuk mund t'i thotë po këtij projektbuxheti. Ju faleminderit!

KRYETARI: Është mirë që po kritikoni, veç është mirë t' i kontrolloni edhe fjalët kur gaboni politikisht. Pra, ke gabuar shumë. Fjalën e ka Gani Geci, le të përgatitet Hajdin Abazi.

GANI GECI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Unë e kam shikuar dhe rishikuar buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009 dhe jam ndalur si anëtar i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri në Sektorin e Sigurisë dhe në buxhetin që është ndarë për Sektorin e Sigurisë. Mua më duhet të veçoj sektorin më të rëndësishëm të Shtetit të Republikës së Kosovës, Agjencionin Kosovar të Inteligjencës, që është rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Buxhetin për vitin 2009 nuk është paraparë asnjë cent për këtë sektor dhe për këtë agjenci të inteligjencës. Ndoshta ju keni paraparë që nga buxheti rezervë të merrni para sa të doni, por kjo nuk është e lejuar me ligj.

Në faqen 44, ju keni shkruar për ndarjen e buxhetit për sektorin e sundimit të ligjit dhe të rendit, në pikën 3. Gjithashtu, keni shkruar në pikën 3.1 për Sektorin e Drejtësisë dhe keni paraparë formimin e Gjykatës Kushtetuese dhe keni ndarë një buxhet prej 1.100.000 euro, edhe pse nuk është formuar Gjykata Kushtetuese dhe nuk di ku i keni marrë ata njerëz, që keni thënë se duam ta bëjmë.

Flitet tërthorazi për rrjedhën dhe shtrirjen e inteligjencës në Republikën e Kosovës, por nuk flitet asgjë konkrete dhe, ju lutem, në nenin 129 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thuhet se "Agjencia Kosovare për Inteligjencës zbulon, heton dhe mbikëqyrë kërcënimet ndaj sigurisë në Republikën e Kosovës" dhe këso kërcënimesh kemi mjaft, jemi duke i parë të gjithë.

Në tabelat 3.11 dhe tabela 3.12 propozohen vija buxhetore për Sektorin e Sigurisë, por prapë harrohet dhe nuk përmendet Agjencia Kosovare e Inteligjencës.

Tabela 3.13, për financimin e projekteve brenda sektorit ndahen 1.4 milionë euro për operacione speciale dhe 1.3 milion euro janë vazhdimësi e buxhetit të këtij viti, do të thotë 1.3 milion euro janë projekte të vazhdueshme, ndërsa 112 milionë euro janë projekte të reja në sektorin e sigurisë.

Ju lutem, ka kaluar koha e ZKZ-ve, e SHIK-ave, ka kaluar koha e bashibozukut, ka ardhur koha e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka ardhur koha e ligjeve dhe ne duhet të sillemi konform Kushtetutës dhe konform ligjeve, sepse gjithë bashkësia ndërkombëtare po vjen këtu dhe po na thotë - silluni si shtet, kurse ju hala po silleni si katund.

Nuk do të thotë që bashkësia ndërkombëtare prej Amerike të vijë këtu dhe të na thotë: - ne ju kemi pranuar si shtet dhe ju formoni organet shtetërore.

Edhe diçka rreth Forcës së Sigurisë. Për Forcën e Sigurisë së Kosovës janë paraparë 2.800 trupa. Në buxhetin e këtij viti ju keni paraparë 1.900 trupa. 900 trupa nuk janë paraparë në buxhetin e këtij viti dhe kjo është papranueshme, sepse ne duhet të sillemi si shtet dhe të gjithë duhet ta dinë që ne do të krijojmë Forcë të Sigurisë së Kosovës, plus të gjitha 1900 trupat janë me stafin dhe me Ministrinë, që është e papranueshme për qytetarët, por edhe për ju, si udhëheqësi.

Nga 15 qershori ka hyrë në fuqi Kushtetuta e Republikës së vendit dhe dikush po harron se ka hyrë në fuqi kjo Kushtetutë. Neni 127 tregon qartë se duhet të formohet Këshilli i Sigurisë, këshill i cili duhet t'i japë këshilla Presidentit dhe Kryeministrit për atë që po ndodh në sektorin e sigurisë së vendit. Kjo është anashkaluar, pra është harruar fare në këtë buxhet, apo do të merren nga rezervat e shtetit më vonë.

Unë do të dal edhe në një pikë tjetër që është shumë e rëndësishme për buxhetin e Republikës së Kosovës. Pra, e kam këtu një aktvendim të Gjykatës Ekonomike të Qarkut në Prishtinë. Në këtë aktvendim, një ndërmarrje private, ndërmarrja "Çlirimi" e ka paditur Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe kjo ndërmarrje ka fituar kontestin gjyqësor. Kësaj ndërmarrjeje ia keni borxh 1.542.000 €, me aktvendimin IVC nr. 202/2006, dhe aktvendimi i nxjerrë më 23.04.2008, thotë: "Kërkesa e paditësit- detyrohet e paditura që paditësit në emër të fitimit të humbur t'i paguajë këtij shumën prej 1.442.000 euro si dhe në emër të dënimit material shumën prej 99.793 €- gjithsej 1.542.000 € me kamatë vjetore prej 3.5% nga dita e parashtrimit të padisë më 3.11.2006 gjer në pagesën definitive, plus 4.000 euro buxhet për shpenzime. E gjithë kjo duhet të bëhet në afat prej tri ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi. Pra, ju me siguri keni bërë ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, por kjo lëndë në Gjykatën Ekonomike të Kosovës është bërë për shkak të shkeljes së njëanshme të kontratës me një kontraktues privat. Dhe, zoti Kryetar e di më së miri se në kohën kur e ka udhëhequr Ministrinë e Shërbimeve Publike, ndërmarrja "Çlirimi" e ka fituar tenderin. Firma "Mabeteks" është më e fortë se ndërmarrja "Çlirimi", por Qeveria e Republikës së Kosovës i ka borxh, sepse e ka fituar kontestin gjyqësor, nëse nuk intervenon dikush në Gjykatën Supreme që atyre t'ua marrin këtë kontest gjyqësor.

Këto para nuk i keni paraparë në buxhetin e Republikës së Kosovës 1 milion e 500 mijë euro, që keni për t'ia paguar ndërmarrjes "Çlirimi", pra është dashur dikush t'i parashih, ose prapë do t'i merrni në atë buxhetin e rezervës, se ashtu - kështu po besoj që edhe në

këtë vit do të kemi mjaft rezervë, se nja 200 milionë euro kanë mbetur suficit dhe kanë për të mbetur edhe në buxhetin tjetër.

Mendoj që ky projektbuxhet nuk i përmbush as për së afërmi kushtet, në rend të parë për sektorin e sigurisë së vendit. Ju e dini dhe disa parafolës këtu e përmendën edhe Mitrovicën. Mitrovica është e diskriminuar në lidhje me buxhetin e Republikës së Kosovës. Ju e dini se Mitrovica tani për tani dhe disa banorë të Mitrovicës kanë probleme dhe hallet më të mëdha për kthimin në vendet e tyre dhe Qeveria e Serbisë gjithçka po bën në këtë drejtim, ndërsa ne si Qeveri dhe asnjë parlament nuk bëjmë as hapin e miut në këtë drejtim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë po e shfrytëzoj pozitën dhe po bëj një replikë me Ganiun, por si shkurt, sepse ai e përmendi emrin tim. Unë për atë që the, kam paralajmëruar me kohë dhe jo vetëm një herë në këtë sallë, prandaj dihet se paralajmërimi ka qenë me kohë se do të dënohet Qeveria për shkeljet të njëanshme të kontratës.

Fjalën e ka deputeti Hajdin Abazi, le të përgatitet Lulzim Zeneli.

(Ndërhyrje: Nuk është këtu Hajdin Abazi)

KRYETARI: Atëherë, le të përgatitet, le të vazhdojë Lulzim Zeneli, e pastaj Xhavit Haliti, në vend të Hajdin Abazit

LULZIM ZENELI: Faleminderit, Kryetar!

Është fakt se u thanë shumë dhe u specifikuan të metat e këtij projektbuxheti. Pra, është vështirë që në mesin e krejt kësaj për çka kemi pasur rastin të dëgjojmë edhe ta analizojmë këtë projekt, të gjejmë ndonjë fjalë të mirë që mund të konkludonim se ai personel apo ai staf i cili e ka ndërtuar, e ka planifikuar këtë buxhet, ka pasur rastin të jetojë me realitetin në Kosovë. Nëse kjo qeveri ka pasur parasysh shkallën e papunësisë në Kosovë, shkallën e varfërisë, atëherë si është e mundur që me aq komoditet të krijojë apo të hartojë një filozofi të tillë, e cila nuk e ka për bazë realitetin e krijuar në vend. Kjo tregon më së miri se Qeveria aktuale ka një krizë të thellë apo një recesion të plotë, çfarë më së miri mund të tregojë se nëse vazhdon kështu, është provokimi më i madh që mund t'i bëhet qytetarit të Kosovës. Ndoshta është momenti i fundit që Qeveria e Kosovës mos të krijojë politika ditore dhe para qytetarit të Kosovës të mos paraqitet me dy standarde. Kolegët këtu thanë shumë po presin dhe pritjet janë të mëdha lidhur me ato premtimet megalomane, mirëpo nëse u fokusohemi premtimeve që i u kanë dhënë punëtorëve shëndetësorë dhe ato premtime të cilat është dashur të realizohen për këtë periudhë kohore, që nuk janë realizuar, dhe ato premtime që presin të realizohen prej 1 janari, asgjë deri më tash në këtë projekt, asnjë cent nuk është paraparë. Kjo tregon më së mirë se nëse vazhdojmë kështu ose duam me vetëdije të plotë ta provokojmë situatën në vend në aspektin social, ose jemi të thirrur që të krijojmë politika të cilat edhe faktori ndërkombëtar, mirëpo edhe raportet të cilat kanë monitoruar punën e institucioneve të vendit dhe situatën në vend, e dëshmojnë më së mirë se ku qëndrojnë. Këtë po e themi duke pasur për bazë shkallën e lartë të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, e deri më tash Agjencinë Antikorrupsion jo që nuk kemi shkuar për ta përkrahur, por ia kemi ulur buxhetin, institucionit Avokatit të Popullit, po ashtu, dhe këto janë dëshmi më e mirë se çdo institucion që vepron jashtë ombrellës qeveritare, ne nuk jemi të interesuar ta mbështesim. Këto shqetësime janë shprehur edhe nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Të nderuar deputetë,

Unë do t'ua fotokopjoj, ja kjo është letra e Fondit Monetar Ndërkombëtar, e nënshkruar, iu kam drejtuar Kryeministrit të Kosovës, zotit Hashim Thaçi, ministrit të Financave dhe kryetarit të Komisionit për Buxhet, Gani Kocit. Të tretë kanë pasur rastin ta marrin. Kjo tregon më së mirë se një regjim qeverisës, çfarë është aktualisht, nuk mund të krijojë politika zhvillimore. Ky buxhet është shpenzues. 70% të hyrave në kuadër të këtij buxheti vjelën nga tatimi në kufi. Kjo tregon më së miri se cila është filozofia apo projeksioni i zhvillimit të vendit. Është për keqardhje se të gjitha sinjalet të cilat kanë ardhur edhe nga fondi Monetar për rritjen e TVSH-ës nga 15 deri në 16%, u tha nga kolegët se cilën kategori e ngarkon më së shumti.

Subvencionet apo huat KEK-ut për 140 milionë, tash po tregoj, këto janë shqetësuese. Në qoftë se mendoni kësisoj që do ta administroni shoqërinë kosovare me një buxhet të tillë, me një planifikim të tillë dhe me një politikë të tillë, atëherë definitivisht Kosova nuk meriton një gjendje çfarë është. Kosova meriton shumë më shumë dhe kjo Qeveri duhet t'i ketë në konsideratë të gjitha këto çka u thanë prej deputetëve. Nëse mendoni se vetëm duhet thënë fjalë të mira, atëherë unë po e përfundoj me konkluzionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar, i cili thotë kësi soji: "Qeveria e Kosovës nuk i ka përfillë rekomandimet tona. Ia kujtojmë Qeverisë së Kosovës se pa një buxhet të planifikuar mirë, që është parakusht për t'i iniciuar diskutimin për pakon fiskale...". Kjo lidhet në mënyrë direkte me procedurën e anëtarësimit tonë.

I nderuar zoti ministër, Shala,

Në qoftë se ju pretendoni t'i mbani mbyllur këto kritika dhe këtë qasje, atëherë definitivisht pasojat do të barten diku tjetër. Provokimi është shumë i hapur dhe lirisht mund të them se me një qasje të tillë nëse administrohet, dje patëm rastin ta dëgjojmë prej Organizatës Botërore të Shëndetësisë, mirëpo në qoftë se po e përgjithësojmë, Qeveria e Kosovës do të shndërrohet në një kompani publike, apo në një ndërmarrje private, atëherë do t'i kishim parë shumë shpejtë pasojat. Për ministrin e Arsimit, lirisht mund të them që ende edhe pas 8 vjetëve pas luftës asnjë cent Qeveria e Kosovës nuk e ndanë për shkencë. Prandaj, këtu qëndron realiteti, nëse ne nuk kemi nevojë për punë krijuese, punë kërkimore-shkencore, atëherë nuk di ku do të bazohet dija, ku do të bazohet zhvillimi i arsimit në Kosovë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, Gani Koci e ka fjalën, replikë!

Regjia, e ka fjalën Gani Kocit, për replikë!

GANI KOCI: Vetëm sa për informim, jo replikë.

Vërtet, unë e kam pasur një letër nga Fondi Monetar që është adresuar në adresë që i përmendi edhe Luli, por mua më ka humbur në zyrë. Dhe, tash po e di se e paska marrë Luli, prandaj ai duhet të japë sqarime ku e ka marrë atë letër, sepse ka qenë shumë individuale, jo publike. Prandaj, unë po dyshoj se dikush ma ka thyer zyrën time të kryetarit të kuvendit, atje.

KRYETARI: Zyrën nuk ta thyer askush, por s'e ke ruajtur mirë!

Urdhëro Lulzim!

Replikë e deputetit Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Unë me keqardhje konstatoj se gjithçka sa i përket respektimit të normave dhe kritereve, respektimit të Kushtetutës, të ligjeve dhe të standardeve, në këtë

Kuvend të Kosovës po banalizohet. Pra, kjo është për keqardhje. Në qoftë se unë kërkoj përgjegjësi prej deputetit Gani Koci, i cili nuk ka pasur vullnet që këtë letër ta diskutojë në Komisionin për Buxhet, në qoftë se Qeveria e Kosovës i mbanë të mbyllura këto dokumente, atëherë cili do të jetë fati i zhvillimeve tjera? Ne presim përkrahje prej faktorit ndërkombëtar, presim anëtarësim, ndërsa rekomandimet të cilat kanë qenë shumë të sinqerta dhe kanë qenë rekomandime shumë të aplikueshme, ne nuk i kemi marrë për bazë. Kjo është një fatkeqësi që po na ndodhë po na përcjellë.

Prandaj, zoti Gani Koci, ju keni të drejtë që flisni kështu për arsye se nëse vazhdoni me këtë politikë, recesioni do të shpërndahej edhe në sfera të tjera. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti, le të përgatitet deputeti Berim Ramosaj.

XHAVIT HALITI: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit!

Zotëri anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderur kolegë,

Pa pretenduar të jem i kualifikuar dhe kompetent për politikën ekonomike politike, që janë në bosht të projektbuxhetit të këtij projektligjit tepër të rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm të shtetit tonë, dëshiroj t'i parashtoj me modesti para jush disa mendime rreth tij.

Duke ju referuar këtij projektbuxheti që Qeveria po na parashtron për shqyrtim e miratim, dua të ripërsëris e të theksoj dy cilësime të bëra në hyrje të këtij projektbuxheti.

1. Hartimi, parashtrimi, shqyrtimi dhe miratimi i këtij projektbuxheti nga Kuvendi është një ngjarje historike për të gjitha institucionet tona shtetërore, si dhe për qytetarët tanë, sepse konfirmon funksionalitetin e shtetit tonë të pavarur dhe njeh e respekton statusin e barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia etnike në kuadër të këtij shteti.

2. Është projektbuxheti i parë i iniciuar, i hartuar, i miratuar i plotë jo vetëm për zëra, por edhe për përgjegjësinë para shtetasve dhe institucioneve vendore e qendrore të Qeverisë së shtetit të pavarur të Kosovës, të njohur tashmë si të tillë nga 52 vende të bashkësisë ndërkombëtare. Pas këtyre cilësimeve dëshiroj të tërheqë vërejtjen tuaj, të nderuar deputetë të pranishëm në këtë sallë, që në shqyrtimin e miratimin e këtij projektbuxhetit të mbajmë parasysh statusin në rrugë të pavarësisë të sovranitetit të shtetit tonë ende të panjohur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe të kërcënuar hapur nga Serbia dhe Rusia. Krizën financiare me të cilën ekonomia botërore ka pak kohë që të përballet dhe shteti ynë me një ekonomi të hapur po shumë të vogël në kapacitetet prodhuese dhe eksportuese është shumë i ndjeshëm për t'u prekur prej saj. Ky projektbuxhet është hapi i parë me të cilin fillon çdo rrugë qoftë dhe e gjatë, me miratimin e projektit që po e shqyrtojmë jo vetëm nuk garantojmë, por as nuk pretendojmë mbarësinë e ecures finansiare gjatë vitit 2009. Mendoj, se miratimi i tij prej nesh është i domosdoshëm për konfirmimin tonë shtetëror, për ecurinë tonë në vitin pasardhës, por kryesisht për zhvillimet perspektive të Kosovës pas zhvillimeve politike ekonomike ndërkombëtare dhe pas përmasave të njohjes dhe të kompetencave kushtetuese të institucioneve të shtetit të Kosovës.

Ky është një projektbuxhet i veçantë që hapur e ligjërisht pretendon se nuk përfshinë e nuk mbulon vetëm një vit çka paraqitëm më lart, pra e ka detyruar projektin e parashtruar para nesh që të mos orientohet vetëm në vitin pasardhës, por në një kornizë afatmesëm.

Realizimi i shpenzimeve buxhetore në kudër të kësaj kornize është vetëm një hap i parë yni drejt zhvillimit. Miratimi prej nesh i këtij projektbuxheti do të shënojë fillimin në rrugën e këtij zhvillimi. Në hartimin dhe strukturimin e këtij projektbuxheti janë marrë parasysh të gjitha çka thashë më parë, si dhe objektivat parësore për zhvillimin e shtetit të Kosovës, këto objektiva i dimë të gjithë ne, megjithatë do t'ju kërkoj t'i përmendë.

Së pari, ky projektbuxhet pretendon rritjen ekonomike prej rreth 6% më 2009 me argumentin se siguron stimulimin fiskal për Kosovës. Dëshiroj të uroj që ky objektivi të ishte i realizueshëm jo thjeshtë për përmbushjen e premtimit qeveritarë, por kryesisht për përmirësimin e jetës së mbarë të qytetarëve të Kosovës. Megjithatë e kam vështirë t'i vë fre dyshimit në realizimin e këtij objektivi. Mëdyshja ime nuk kushtëzohet aspak nga predispozita dhe angazhimi i Qeverisë së Kosovës por nga kriza financiare që po shfaqet në botë dhe që në një mënyrë apo tjetër do të shfaqet në ecurinë ekonomike të shtetit tonë të ri. Vazhdojë të dyshoj edhe për faktin se të ardhurat e buxhetit tonë të sigurohen kryesisht nga importi, të ardhurat vendase nga territori shtetëror i Kosovës vinë kryesisht nga tregtia dhe jo prodhimi vendës. Sidoqoftë pavarësisht nga sa thashë vendet fqinjë me ne duke mbajtur në konsideratë krizën reale financiare të sapo shpërthyer i kanë reduktuar ritmin e zhvillimit ekonomik në rritmë 3 deri 4.5%. Ne jemi tashmë objekt dhe subjekt i globalizmit ndaj sugjeroj që të jemi më realistë.

Së dyti, Projektbuxheti parasheh të ardhurat dhe shpenzimet. Thuhet se me 2007 fondet nuk janë shpenzuar, pretendohet mosrealizimi i premtuar për kilometrat e rrugëve, për ndërtimin e shkollave, ujësjellësve e kanalizimeve. Por ky pretendim përfundon me thënien. ka mbetur të bëhet më shumë jam dakord për këtë përfundim, duhej dhe mund të bëhej më shumë. Por shpresoj dhe besoj se me një planifikim realë, me shkurtimin ligjor të afateve të procedurave tenderuese dhe me sanksionimin ligjor për respektimin e afateve për zbatimin e projekteve do të kapërcehej ky ngërç i djegies së fondeve buxhetore. Në këtë kuadër do të bjerë çdo pretendim përmbushje të buxhetit nga fondet e përdorura nga viti i kaluar.

Së treti, me synimin për të gjeneruar rritje ekonomike, angazhohet të sigurojë një mjedis të përshtatshëm stimulues sektorit privat për të shtuar veprimtarinë dhe për të krijuar më tepër vende pune. Nuk mund të mos e cilësojë lavdërueshëm këtë synim por e kam të vështirë të besojë në realizimi i tij i bindur në predispozitën dashamirëse të Qeverisë, hezitoj të shprehem për kapacitetet dhe mundësinë financiare të saj në mbështetje të sektorit privatë.

Së katërti, stabiliteti social i parashikuar nga një Projektbuxhet shteti nuk është problem politikë por ekonomik. Sot nuk po diskutojmë për situatën politike në Kosovë por për stabilitetin social. Sot ne do të diskutojmë dhe do të vendosim për arsimimin dhe kushtet dhe mundësitë e arsimimit të rinisë, për nivelin e pagave të punësuarve në sektorin publik dhe privat, për statusin e invalidëve dhe të paaftëve për punë, për sigurimin e një rrjeti të sigurisë sociale.

Së pesti, është reduktimi dhe eventualisht eliminimi i shpenzimeve për shpenzimet publike. Ky është edhe një nga qëllimet kryesore të këtij Projektbuxheti.

Së gjashti, përmes tatimeve mbi të ardhurat si për bizneset ashtu edhe për personat fizikë synohet të përfitojë çdo individë qytetari i Kosovës qoftë punëmarrës apo punëdhënës.

Duke përfunduar, ju bëj thirrje të gjithë kolegëve, pa shmangur reflektimin e arsyeshëm të Qeverisë, ta votojnë e miratojnë këtë Projektbuxhet.

Kam dy çështje të cilat do t'i shtroja tani ministrit përkatësisht Qeverisë.

Nuk e di cili është hapi që ka ndërmarrë Qeveria lidhur me sistemin bankar në Kosovë. A i ka thirrur Qeveria përfaqësuesit, drejtuesit e bankave të Kosovës dhe a kanë garantuar këto banka kursimtarët e tyre për shumat që i kanë të garantuara në këto banka.

Së pari, ku janë paratë e kursimtarëve në bankat e Kosovës dhe kush garanton kursimtarët në kohën e krizës botërore.

Së dyti, pyetje a ka në plan Qeveria të sigurojë rezerva të grurit ashtu qysh i ka rezervat e naftës dhe ku janë rezervat e grurit në shtetin e pavarur të Kosovës dhe se treti- propozoj për një arsye, dihet se borxhet nga KEK- u në Kosovë, nga shpenzuesit e rrymës elektrike janë diku rreth 400 milionë euro. Propozoj që Qeveria ta hartojë një ligj për amnisti për të gjithë shpenzuesit e energjisë elektrike që kanë borxhe me një kusht që brenda 3 muajve të gjithë borxhlinjtë të cilët duan t'i shlyhet borxhi i paguajnë 30% të këtij borxhi KEK-ut. Me këtë rast KEK-ut do t'i paguheshin rreth 120 milionë € borxhe dhe në një farë mënyre do të zbutej kriza financiare e KEK-ut. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputeti Berim Ramosaj, le të përgatitet deputeti Ibrahim Gashi.

BERIM RAMOSAJ: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë, vërtet, duke marrë parasysh krejt ato që i thanë deputetët e nderuar, në fakt ishin mjaft të qëndrueshme, respektivisht atë që i thanë pjesa opozitare dhe disa individë nga koalicioni, të gjitha janë të qëndrueshme, por me qëllim që të kontribuojë në këtë projektbuxhet i cili, në fakt, në aspektin konceptual nuk është asgjë tjetër veç një plan për vitin 2009 i shprehur midis raportit të të hyrave potenciale dhe të dalave potenciale. Unë mendoj se me një analizë të cilën do të mundohem në një gjuhë të kapshme të bëj, do të kem edhe si sugjerim, respektivisht si mundësi për ministrin që ta implementojë në këtë projektbuxhet sepse, tek e fundit, ky buxhet nuk është buxhet i Qeverisë, por buxhet i qytetarëve të Kosovës, respektivisht i tërë Republikës së Kosovës.

Së pari, duhet ta identifikojmë këtë boshllëkun midis të hyrave totale të planifikuara dhe të dalave totale që është 138 milionë. Për qytetarët e nderuar dhe juve deputetëve, iu bëj me dije se 138 milionëshi nuk është në fakt e hyrë e 2009, por është rezultat i suficitit që ka mbetur nga mos mos implementimi i projekteve nga ky vit dhe vitet e kaluara dhe që të jemi më korrekt, një pjesë është nga bilancet e të hyrave që kanë mbetur nga vitet e kaluara që janë grumbulluar si mjete të pashfrytëzuara. Andaj Qeveria ka planifikuar 138 milionë i ka futur si të hyra për vitin 2009, që në fakt nuk janë mjete të bartura nga vitet e kaluara.

Subvencionet. Kur është fjala te subvencionet, faktikisht unë në këtë projektplan nuk kam parë ndryshim nga periudhat, respektivisht nga planet buxhetore të viteve të kaluara, përveç ngritja 80 milionë e kredisë për KEK-un, 40 milionë për ata që nuk paguajnë rrymën, respektivisht për importin e rrymës që në fakt tregon se ata që paguajnë rrymën do t'i financojnë ata që nuk e paguajnë dhe 15 milionëshi i thënë nga ministri i Ekonomisë dhe Financave për Rrjetin e Shpërndarjes për mua janë shifra të pakapshme, duke marrë parasysh edhe sugjerimet që i ka bërë Fondi Monetar Ndërkombëtar, respektivisht Banka Botërore se kjo shumë nuk ishte dashur ta kalojë shifrën 4 milionë euro.

Mandej, kur jemi te rritja e parashikuar që planifikon të ketë kjo qeveri në vitin e ardhshëm 2009, domethënë të ketë rritje 6%, kjo rritje për mua është e pakapshme, duke marrë parasysh shumë tregues makroekonomik. Edhe nëse i shikojmë para supozimet e rritjes ekonomike në Evropë, në rajon., duke marrë parasysh krizën globale, unë nuk besoj që rritja ekonomike në Kosovë ta kalojë nivelin mbi 4%.

Këtu, sigurisht, do të ketë ndikim deficiti i madh tregtar, i cili do ta përcjellë edhe vitin 2009, sepse edhe në aspektin nominal edhe në aspektin real importet do të rriten, duke marrë parasysh raportin me eksportin, sigurisht ka me qenë mjaft i disfavorshëm për Kosovën dhe do të ndikojë në politiken makroekonomike.

Në politikën tatimore, vërtet ka veprime të cilat kanë menduar të bëjnë diçka në ndryshim në aspekt të ngritjes apo uljes së disa taksave, të cilat kanë efekte. Disa prej tyre kanë efekte në ngritjen e të ardhurave, mirëpo disa nuk kanë. Për shembull, ulja e taksave për tatimin në fitim të korporatave nga 20% në 10%, nuk ka konsekuenca të larta buxhetore, duke marrë parasysh atë se sa ka pasur konsekuenca buxhetore kjo taksë në korporata në fitimin e korporatave nga vitet e kaluara, nuk ka pasur konsekuenca. Shumica e kompanive, të cilat në fakt i kanë ikur, qoftë me ri investim, qoftë me forma plotësuese qoftë të ikjes të mosparaqitjes së fitimit, andaj, këtu nga kjo ulje nuk duhet pritur ndonjë konsekuencë buxhetore.

Kur është fjala te tatimi në të ardhura personale u tha mjaft, nuk dua të shtoj në njëfarë forme janë stimuluar ata që marrin të ardhura të larta, sepse për ata zbritja nuk është aq e madhe. Për ata zbritja e taksës është 50%, ndërsa atyre që marrin nga 150 euro, 200 euro nuk ua kanë zbritur taksën në të ardhura individuale prej 5% në 4%, që, domethënë, tregon ndoshta diku deri 10%, ndërsa ata me të ardhura të mëdha kanë ulje të taksave 50%.

Te disharmonia, gjegjësisht propozimet e planifikuara për kategoritë e rritjes së të ardhurave për shërbyesit civil në 10%, unë mendoj se duke marrë parasysh edhe shkallën e inflacionit që kemi pasur këtë vit edhe inflacionin që do ta kemi vitin e ardhshëm, në fakt të ardhurat reale të shërbyesve civil nuk do të jenë më të mëdha, andaj kjo është vetëm një formë apo aspekt formal i shtyrjes së qytetarëve të mendojnë se diçka është përmirësuar në atë drejtim.

Duke marrë parasysh të gjitha këtu dhe shumë vërejtje tjera që dua të jem shumë parimor në këtë drejtim, unë kam edhe propozimet konkrete, që të mos jem vetëm kritikues, do t'i theksoj ato të cilat i kam bërë në një analizë që nuk do të bëj ndryshim nga buxheti edhe në aspektin e të hyrave dhe shpenzime.

TVSH-ja duhet të mbahet në 15%, jo të ngritët në 16%, sepse ngritja në 16% e TVSH-së, a e dini kush e pëson më së shumti, e pësojnë qytetarët? Pra, e pësojnë ata qytetarë të cilët janë në fakt konsumues të mirave materiale, ai 1% i cili do të ngritët prej 15 në 16% për buxhetin është shumë e madhe, ndërsa për qytetarët, të cilët në fakt edhe kështu 40% të tyre domethënë janë në varfëri, të mos të themi për 15 apo 20% që janë në varfëri të skajshme, për ata, domethënë edhe më shumë.

Tatimi në të ardhura, aty ku keni planifikuar zbritjen nga 20% në 10%, unë mendoj 15%, aty ku keni planifikuar zbritjen nga 5% duhet të jetë 3% dhe atë 10% që e keni planifikuar në 8%, unë mendoj se duhet të jetë 6%.

Te rritja ekonomike më mirë është ta korrigjoni, sepse është ambicie e madhe ju të planifikoni rritje ekonomike 6%. Unë mendoj që 4% është mjaft ambicioz për ekonominë e Kosovës.

Te subvencionet për ndërmarrjet publike edhe ashtu ndërmarrjet publike janë edhe kancer i madh, respektivisht burim i madh i keqpërdorimeve, andaj nuk kemi nevojë ne t'ua shtyjme jetën, respektivisht t'iu japim shans të jetojnë në kushte jo të barabarta, se në njëfarë forme janë monopoliste në tregun kosovar. Sa i përket KEK-u, mendoj se kur është fjala te rrjeti i shpërndarjes, me qenë se po shkojmë në procesin e privatizimit të rrjetit të shpërndarjes a ka kuptim ne t'iu japim 15 milionë euro në 2009 për rrjetin e shpërndarjes, duke marrë parasysh një shumë e madhe e donacioneve janë veç në projekt, janë veç në proces të implementimit në Rrjetin e Shpërndarjes. A ka kuptim që rrjetin e shpërndarjes ne në fakt ta shesim pas një apo 2 vjetëve që e kemi në fazën edhe të thithjes të donacioneve, por në të njëjtën kohë edhe në fazën e implementimit të këtyre projekteve prej 15 milionëshit, domethënë nuk ka rezon. Dhe së fundi harmonizimi i buxhetit të bëhet me kornizën afatmesme të shpenzimeve, sepse është një ndër parakushtet elementare të implementimit të donacioneve që na u kanë premtuar në Konferencën e Donatorëve. Në këtë drejtim, te investimet kapitale jeni munduar të bëjmë hap të madh, domethënë që ta rrisim nivelin. Mirëpo në qoftë se e shihni se bash te investimet kapitale kemi ngecur në aspektin e implementimit të projekteve, unë planifikoj që edhe këtë vit buxhetor të kemi më shumë suficit në këtë proces, madje edhe në Ministrinë e Transportit ...

KRYETARI: Ju faleminderit! Po, mirë, edhe një minutë, por kryeje brenda 1 minute.

...ndërsa sa i përket, të nderuarit deputetit Tali, unë kam rezerva në aspektin e asaj se do të kemi inflacion apo deflacion. Këto ishin që i kisha ndërmend t'iu them, por unë do t'ia jap ministrit këto propozime dhe dhashtë Zoti që t'implementojë, sepse në këtë formë si është, ky buxhet shpresoj që nuk do të jetë i përshtatshëm për miratim.. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ndoshta këto është mirë t'ia jepni Komisionit.
Fjalën e ka për replikë, Driton Tali.

DRITON TALI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Me gjithë nderimet dhe respektin që e kam për deputetin Ramosaj, por unë po flas në bazë të të dhënave që i kemi, domethënë në krizë ekonomike dihet se bie kërkesa për shkak të rritjes së papunësisë dhe ndërmarrjet i ulin çmimet e veta për ta stimuluar kërkesën. Po, ajo që unë do të doja të thosha, është se FMN-ja nuk e ka miratuar këtë

buxhet për shkak se në elementin kryesor, akumulimin buxhetor e keni ngatërruar, domethënë nuk ka kurrfarë logjike që të jetë 80,6 milionë. Pra, në atë që zoti Lulzim, mendoj që gabimisht e tha se është 80% e të hyrave tatimore në kufi, krahasuar me të hyrat e përgjithshme tatimore, domethënë me elementin kryesor e keni ngatërruar 80 përqindëshin, 80 milionë rritje që nuk ka, 13.6, 78%, edhe sikurse të ketë rritje të kërkesës në tregun e Kosovës, që e dimë që nuk do të ketë rritje të kërkesës, duke marrë parasysh edhe këtë 6 përqindëshin e famshëm të rritjes ekonomike që ishalla bëhet, ishalla prej gojës së ministrit shkon në vesh të Zotit, por nuk ka kurrfarë imputi aty, domethënë ...

(Ndërhyrje e Kryetarit- Driton, me kënd je duke zhvilluar replikë?)

...zoti Kryetar, poenta, unë e di që nuk je ekonomist, por janë shumë sende, janë ekonomistët që na përcjellin. Është shumë esenciale, ky buxhet nuk do të realizohet. Pika kryesore, rritja, stimulimi i buxhetit nuk do të jetë, kjo është ajo. Tash, nuk jemi të gjithë ekonomistë, ndoshta nuk është interesant për ty, por megjithatë për të tjerët është...

(Ndërhyrje e Kryetarit: Të lutem, të lutem, replikën e pate me Berim Ramosaj, e jo me ministrin)

...unë e thashë shumë mirë se ka deflacion, nuk do të ketë inflacion, bile edhe në buxhet shkruan aty se ka ulje të inflacionit, pra janë çështje shumë teknike për të cilat...

KRYETARI: Të kisha lutur që të jesh më i kujdesshëm. Replikën e ke pasur me deputetin Berim Ramosaj, e jo me ministrin. Bëhu më i sjellshëm, të lutem! Fjalën e ka Ibrahim Gashi, le të përgatitet Riza Smaka.

IBRAHIM GASHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zoti Kryeministër,

Zëvendëskryeministër, ministra

Të nderuar kolegë deputetë,

Në diskutimet e deritanishme, në mënyrë shumë të argumentuar u prezantuan shumë mangësi përmbajtjesore të këtij projektbuxhet, të cilat konsistojnë sa në shpërndarjen jo mjaft të analizuar të buxhetit të paraparë sipas prioritetëve qeveritare, po aq edhe në qëndrueshmërinë e projeksioneve të propozuara buxhetore.

Në cilësinë e jo profesionistit, por të një vëzhguesit të vëmendshëm do të mundohem të kontribuoj sidomos në dy fusha që i konsideroj të afërta me aktivitetet e mia të përditshme parlamentare dhe profesionale. Fjala është për pjesën e buxhetit që është paraparë për ta mbuluar koston e aktivitetëve të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Ministrisë së Arsimit të Republikës së Kosovës.

Para se të flas për këta dy sektorë, dua ta nënvizoj edhe një fakt që lidhet me ato që quhen prioritetë të Qeverisë së Kosovës, faqe 7, Po qe se e shikojmë me vëmendje, 4 prioritetet e Qeverisë, për nga përmbajtja secili më i rëndësishëm se tjetri, kur analizon mbështetjen financiare që e propozon Qeveria për këto, ka një shpërputhje të madhe që i bën këto të jenë të renditura njëri ndër tjetrin, Kuvendin e fundit sipas buxhetit që është i ndarë e zë zbutja e varfërisë dhe stabilitetit social.

Dua t'i rikthehem Ministrisë së Punëve të Jashtme. Subjekti politik që përfaqësoj, konsideroj se me kohë i ka ngritur shqetësimet e veta lidhur me performancën e shtetit të Kosovës pas 15 qershorit të këtij viti, kur Kosova de jure duhet të sillet si subjekt legal në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Kjo koïncidon me hyrjen në fuqi të Kushtetutës dhe krijimin e Ministrisë të Punëve të Jashtme, ministri e cila asnjëherë nuk arriti të konsolidohet në shkallën e dëshiruar dhe t'i marrë përsipër përgjegjësitë për promovimin e shtetit të Kosovës dhe krijimin e njohjeve nga grupi i shteteve të fuqishme, siç janë ato të Amerikës Latine apo të botës islamike.

Të nderuar deputetë,

Vërejtjet tona për mosfunksionalizimin e kësaj ministrie, përveç tjerash u arsyetuan edhe për mungesë të mbështetjes financiare. Tani kur kjo pengesë mund të evitohet, duke e mbështetur më shumë financiarisht këtë ministri, përmes në nëpërmjet këtij projektbuxheti, kjo nuk ka ndodhur. Kjo ministri në total i ka të ndarë 24.739.107 euro. Nga këto 13 milionë, 040.300 euro janë paraparë për shpenzime kapitale.

Në këtë projektbuxhet të propozuar për këtë Ministri nuk është dhënë fare një përshkrim i synimeve dhe i prioriteve. Vetëm në një draft-tabelë 3 A janë dhënë disa sqarime të pakta se cili do të jetë destinacioni kryesor.

Shuma më e madhe e buxhetit në këtë ministri edhe për vitin 2009 do të shpenzohet për blerjen e ndërtesave për ambasada. Kemi nënvizuar edhe më herët se, ndoshta, kjo nuk do të duhet të ishte prioritet i Qeverisë së Kosovës se është një luks i madh për kohën dhe mendojmë se është dashur që buxheti në këtë ministri të orientohet e destinohet në ngritjen e kapaciteteve.

Nuk ka asnjë specifikim tjetër që do të shkonte në ndërtim të strukturës, veç se është indikative me ia dhënë gjithsesi hipotetike që vjen nga kjo ministri se në vitin 2009 do të ketë 211 të punësuar. Deri me tani nuk kemi pasur në dorë ose nuk është bërë publik një plan zhvillimor i kësaj ministrie, ku do të shihnim se cilat do të ishin, domethënë mbi cilën bazë do të ndodhte ky punësim, për faktin se aktualisht e dimë që nuk e ka as gjysmën e këtij potenciali njerëzor.

Kur kihet parasysh punën e madhe që e pret Kosovën në planin ndërkombëtar, lidhur me detyrimet që dalin nga dokumenti Ahtisari, lidhur me praninë evropiane këtu pra të EULEX-it, por sidomos me aktivitetet lotuese për njohje, dua të nënvizoj se me shumën që është përcaktuar si propozim prej 8 milionë, 421 mijë e 484 euro për shërbime dhe mallra, shtrohet pyetja se a do të mund Kosova të krijojë kapacitete profesionale për fushën shumë specifike të punës në diplomaci? A mund të sillen ekspertë në fushën e diplomacisë që ndodhen jashtë, a mund të realizohet me sukses lobimi për njohjen e Kosovës, a mund të iniciohet lidhja e marrëveshjeve bilaterale me të gjitha shtetet që e kanë njohur Kosovën? A mund që të fillojë shpejtë edhe rundi i dytë i hapjes së ambasadave të Kosovës dhe sa ambasada mund të hapen eventualisht me këto mjete? A mund të promovohet Kosova dhe resurset e saj ekonomike jashtë vendit? A mund të imponohet Kosova në takimet e rëndësishme ndërkombëtare? A mund të aktivizohet ndonjë kompani lobuese që do të punonte për Kosovën me shtete dhe grup shtetesh që e kundërshtojnë njohjen? A mund të organizohet në Kosovë ndonjë konferencë ndërkombëtare apo samit i nivelit më të lartë evropian apo botëror me paratë që i janë paraparë Ministrisë të Punëve të Jashtme?

Në fund, e thërras edhe një herë Qeverinë që të ketë më shumë konsiderata për ministritë e sapoformuara, siç janë: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes. Këto janë tri ministri që përformojnë dhe reflektojnë më së shumti shtetësi në raport me shtetet fqinje dhe bashkësinë ndërkombëtare, por edhe me qytetarët e Kosovës.

Propozoj që Qeveria ta rishikojë buxhetin për Ministrinë e Punëve të Jashtme, nëse duam që shteti i Kosovës të ketë një paraqitje të respektueshme në marrëdhëniet ndërkombëtare, së paku në nivelin e vendeve të rajonit.

Sa i përket fushës së arsimit, dua ta fokusoj vetëm segmentin e arsimit të lartë. Edhe këtu projektbuxheti ka dy mangësi, sipas meje. Së pari, buxheti i propozuar është i vogël për të mos thënë i papërfillshëm kur kihen parasysh synimet që ia ka vënë vetës Qeveria e Kosovës kur e ka shpallur arsimin projekt nacional. Mangësia tjetër është paqartësia që e krijojnë pasqyrimet tabelare ku asnjëherë nuk dihet ekzakt se cilat investime do të jenë në arsimin e lartë.

Thuhet se një milion euro do të dedikohet për aktivitete shkencore hulumtuese, pastaj kur e kërkon në këto tabela, ky 1 milion humbet, paraqitet diku te Qendra e Studentëve si investim kapital, i cili sigurisht se nuk nënkupton investimet në aktivitetet shkencore dhe hulumtuese. Me këtë emërtim të destinimit, në fakt, nuk ka ndonjë shumë në tabelën e shpërndarjes. Tek arsimi i lartë figuron vetëm një shumë, pra, diç më shumë se 300 mijë euro për shërbime dhe mallra, nëse është menduar që këto të përdoren edhe për investime në zhvillimin e shkencës dhe të hulumtimeve, atëherë kjo nënkupton që është shumë e papërfillshme që nuk e ndryshon gjendjen në këtë fushë.

Të nderuar deputetë,

Dua, po ashtu, ta bëj një digresion në mes të fjalëve të mëdha që janë në vijimësi për të investuar në ngritjen e cilësisë së studimit, në atë që quhet kthim i trurit, në bursa për studime jashtë vendit, në hulumtime shkencore, në promovimin e formave alternative të studimit, siç është ilerning dhe distance learning, të gjitha këto kam përshtypjen se me këtë planifikim shpërndarës buxhetor do të mbeten vetëm dëshirë dhe vullnet i mirë i kësaj Qeverie.

Nëse për arsimin janë në tërësi afro 44 milionë euro dhe nga kjo shumë për arsimin e lartë vetëm 2 milionë e 700 mijë euro, kjo të bën të mendosh se jemi larg krijimit, përkatësisht një arsimimi që përgatit kuadro konkurruese për tregun evropian të punës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjalën e ka deputeti Bajram Kosumi, le të përgatitet Riza Smaka. Unë i dhashë përparësi si kryeministër që ka qenë.

BAJRAM KOSUMI: I nderuari Kryetar,

I nderuar Kryeministër dhe Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot u diskutua thellësisht dhe gjerësisht për buxhetin e vitit 2009, pra është mirë kjo që ndodh kështu. Do të ishte mirë që të vazhdonte diskutimi edhe nesër, në orën 17,00.

Ta mbyllim sot diskutimin dhe të vazhdojmë nesër. Diskutimi për buxhet është çështja themelore gjatë një viti për një Qeveri dhe për një Kuvend dhe mirë është të diskutohet thellësisht.

Unë do të mundohem të jap kontributin tim, qoftë nga përvoja ime, qoftë nga diskutimet që kanë dal sot këtu për disa ndërhyrje të mundshme gjatë përgatitjeve për shqyrtimin e dytë për buxhetin e vitit 2009.

Çështja e parë që do të flas, janë ndryshimet e politikave fiskale të cilat i ka miratuar Qeveria dhe ky buxhet është përgatitur sipas këtyre ndryshimeve. Ndryshimi i politikave fiskale është arsyetuar nga Qeveria për shkak të konkurrencës në rajon të politikave fiskale dhe për shkak të nxitjes së investimeve të kapitalit të huaj në Kosovë, kjo ka qenë arsyeja pse janë ndërruar politikat fiskale dhe nuk them se është në arsye e keqe kjo. Arsyeja mund të jetë e mirë dhe politikat fiskale duhet të përshtaten me zhvillimet ekonomike edhe në vend edhe në rajon.

Këto politika fiskale kanë rezultuar me reduktimin e tatimit të korporatave nga 20%, 10% dhe i keni shkallët tjera të mëposhtme.

Pastaj, me reduktimin ose zvogëlimin, më mirë të them zvogëlimin e tatimit në të hyrat personale, në paga prej 20% në 10% e më poshtë dhe, duke i zvogëluar këto tatime rrezikon të zvogëlohet edhe buxheti i Kosovës, por Qeveria e Kosovës e ka gjetur modelin më të lehtë që të mos e lejojë uljen e buxhetit të Kosovës, duke e ngritur TVSH-në nga 15 në 16%. Edhe një folës para meje e përmendi këtë çështje këtu, është çështja më thelbësore që duhet ta rishikojnë Qeveria edhe Kuvendin në këtë buxhet.

Po ta përkthejmë me fjalë më të thjeshta, kjo i bie kështu: do të thotë ulen tatimet e korporatave dhe ulen tatimet e pagave, të gjithë ata që janë të punësuar në Kosovë, do të përfitojnë nga këto politika fiskale, ndërsa ajo zbrazësia e krijuar në buxhet i ngarkohet konsumatorit. Pra, konsumatori që është krejt populli i Kosovës, krejt qytetarët e Kosovës do ta paguajnë, më shtrenjtë do të paguajnë çdo artikull, çdo të mirë materiale, për ta mbushur buxhetin e Kosovës.

Kjo politikë e tillë fiskale besoj e rrezikon paqen sociale në Kosovë dhe do t'i sjellë problem edhe Qeverisë edhe të gjithë neve këtu, prandaj është mirë që Qeveria gjatë ditëve të ardhshme ta rishikojë këtë ndryshim fiskal.

Unë jam dakord që të ulen tatimet edhe të korporatave edhe të pagave, në mënyrë që të nxiten investimet e huaja, por të mos preket TVSH-ja, të mos ngarkohet buxheti familjar i çdo qytetari të Kosovës, sepse edhe ashtu ne kemi një gjendje të brishtë sociale dhe nuk është zgjidhje kjo që ta rëndojmë edhe më tutje buxhetin familjar dhe të çdo qytetari të Kosovës.

Çështja e dytë që dua të flas sot, është rezerva prej 200 milionëve e paraparë për vitin 2009. Çdo shtet ka rezervën e vet edhe Kosova ka pasur rezervën e vet shtetërore sido që të quhet, por është rezervë shtetërore që ruhet për rastet e rrezikshme, emergjente e tjera, dhe Kosova ka pasur përafërsisht rreth 50 milionë këtë rezervë, herë ka qenë pak më e ulët e herë pak më e lartë, por ka qenë rreth 50 milionë euro.

Në vitin 2008, ka qenë 80 milionë, në vitin 2009 propozohet të jetë 200 milionë. 200 milionë, nëse i krahasojmë me të hyrat buxhetore në Kosovë, që janë 956 milionë i bie 22%. Qeveria propozon që në vitin 2009 22% të hyrave të përgjithshme në buxhetin e Kosovës të ngrihen në rezervë. Është shumë e madhe. Nuk besoj se i duhen Kosovës 200 milionë në rezervë. Duhet të ketë një rezervë pak më të madhe në këtë vit për shkak të parashikimeve të mundshme për krizën financiare që po e godet botën, por mund të jetë, ndoshta, diku pak më e madhe se 80 milionë, hajde lë të jetë 100 milionë, por jo 200 milionë, sepse është humbje e madhe 200 milionë të fusësh në rezervë, t'i mbash gjatë tërë vitit në rezervë 200 milionë, do të thotë kjo është ta ngrish paranë, e dini të gjithë se çka do të thotë. Do të thotë të ketë një ulje të kësaj rezerve, të jetë 100 milionë dhe 100 milionë tjera të lëshohen në qarkullim. Dhe çështja e dytë rreth këtij 200 milionëshi, është mënyra e përdorimit të tij.

Në Ligjin që është ofruar këtu për diskutim, nuk ka asnjë paragraf qysh do të përdoret kjo në rast të përdorimit, do të thotë nuk janë pak para 200 milionë të rezervës për të cilin nuk ka rregull, nuk ka nen qysh do të përdoret. Nuk mund të vlejë i njëjti nen që vlen për rezervën e ministrit, sepse për rezervën e ministrit të Financave është ligji qysh përdoret, është neni, por për këtë rezervë nuk ka, prandaj i propozoj Qeverisë që ta fusë një nen, një amendament të ri në ligj qysh do të përdoren këto 200 milionë ose, nëse reduktohen në 100 milionë, qysh do të përdoren 100 milionë gjatë vitit nëse duhet të përdorët.

Çështja e tretë për të cilën dua të flas janë prioritetet e Qeverisë dhe përputhshmëria e këtij buxheti me prioritetet e Qeverisë.

Nuk dua të ndalem shumë, sepse edhe disa kolegë folën rreth kësaj çështjeje, por unë do të marr vetëm dy shembuj. Shembulli i parë ka të bëjë me atë që fola më herët me paqen sociale. Njëri prej katër prioritetëve të Qeverisë është zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social, ndërsa në anën tjetër, me propozimin për ndryshimet fiskale tensionohet siguria sociale në Kosovë. Do të thotë i propozoj Qeverisë që ta rishikojë edhe një herë, se nëse është prioritet paqja sociale, nuk mund të merren veprime që e acarojnë, që janë në kundërshtim me atë prioritet, ndërsa rritja e TVSH-së dhe parimi i katërt që e kanë paraparë kolegët e Qeverisë, janë në kundërshtim flagrant midis tyre.

Kundërshtimin e dytë, do ta quaja kundërshtim politik brenda prioritetëve të Qeverisë. Qeveria ka ndarë edhe tri prioritete tjera midis të cilëve është transporti kryesisht, rrugët, investimet në rrugë që janë duke u bërë do të thotë, arsimi dhe shëndetësia. Merreni shndërroni në shifra në shifra këto, për transport për rrugë në komunikacion janë ndarë 103 milionë, që është diku përafërsisht më shumë se 10% e shpenzimeve buxhetore, që do të thotë është një shumë e mirë. Por, për prioritetin tjetër që është, po ashtu, prioritet për Qeverinë, për shëndetësinë janë ndarë 12 milionë që është 1% nuk mund tash të jetë prioritet për Qeverinë 1 përqindëshi i investimeve. Nëse është shëndetësia prioritet, atëherë duhet të ndahen para më shumë, duhet të ketë pra 10% qysh ka në infrastrukturën rrugore ose qysh ka në arsim. Pra, i propozoj Qeverisë, do të thotë, nëse është fokusuar në këto prioritete, është çështje e Qeverisë, fokusimi në prioritetet e saja, por atëherë lë ta rregullojë ndarjen e buxhetit sipas këtyre prioritetëve, në mënyrë që mos të mbetet ky prioritet vetëm retorikë, vetëm fjalë në letër, sepse ndarjet buxhetore nuk janë në përputhshmëri me prioritetet e Qeverisë. Dhe çështja e fundit që do të flas, u fol disa herë përpara, prandaj edhe këtu do ta reduktoj fjalën time, është shpërndarja e financave nëpër projekte të ndryshme kapitale dhe nëpër komuna.

Ndoshta, që të mos duket krejt zi, ky buxhet e ka një përparësi, një anë pozitive, është rritja e investimeve kapitale, kjo është ana e mirë e këtij buxheti. Por nëse hyjmë më thellë, do të thotë e kanë vërejtur edhe shumë kolegë, më herët ka një shpërndarje jo të drejtë në projektet e ndryshme për investime kapitale edhe nëpër komuna të ndryshme.

Hidhjani një sy projekteve dhe...

KRYESUESI IBRAHIM GASHI: 10 minuta janë bërë. Ju faleminderit, deputet!
Fjalën e ka deputeti Riza Smaka, pastaj propozojmë një pauzë prej 15 minutash për kafe dhe vazhdojmë.

RIZA SMAKA: I nderuari, zoti Kryesues!

Zoti Kryeministër

Zoti zëvendëskryeministër,

Ministra të nderuar,

Deputetë të respektuar,

Të them të drejtën sipas radhës është dashur kaherë ta kryejmë këtë edhe është mirë, korrekte dhe fisnike që deputetëve në foltore t'u jepet fjala sipas radhës, nuk ka nevojë që të bëhen aty kalkulime që dikujt t'i jepet përparësi e dikujt, e tjera, tjera. Mendoj se kjo është e nevojshme, është njerëzore, elementare, tek e fundit nuk jam kundër që ju ka dhënë dikujt fjala, por parimisht po flas.

Shumë veta folën edhe parimisht të gjitha diskutimet ishin me vend, kështu natyrisht, minus asaj që ka pasur edhe potencime, apostrofime të karakterit tendencioz, veçanërisht jo një libër... Për buxhetin ka mijëra libra, nuk është fjala për një libër, se nuk e paska lexuar, nëse nuk e ka lexuar, që unë e di që e ka lexuar, se flas kësisoj, po e zëmë ministri Shala është një njeri kompetent, ministër kompetent, profesor universitar. Do të thotë, mendoj që nuk është mirë të flasim me tendencë. Unë gjithmonë jam përpjekur edhe tash edhe në të ardhmen do të përpiqem që pikënisja të jetë, po e zëmë po të kisha qenë aty, si do të kisha vepruar, dhe për atë që merren këto bona fide, edhe nëse tingëllojnë ndryshe, nuk mund të quhen tendencioze.

Konsideroj se në dokumentin për buxhetin do të duhet t'i jepej një fokus me i theksuar ambientit. Ambienti është parakusht për jetë shoqërore, ekonomike, politike, arsimore, parakusht dhe stimulans për punë kreative.

Ambienti në Kosovë është në degradim e sipër, kështu që e edhe nëpërmjet instrumenteve buxhetore ai do të duhej të favorizohej.

Pastaj, subvencionet në KEK, po e zëmë, ndoshta janë të domosdoshme, mirëpo megjithatë do duhej të rishikohej edhe në vend që te orientohen, po e zëmë, në bujqësi, në blegtori, në pylltari, në pemëtar, në bletari, ku do të kishin pasur efekte direkte në punësim, direkte në punësim, direkte në prodhime atë që të nevojshme, që na importojmë, ato do të kishim mundur t'i eksportojmë.

Në tekst shkruhet, ndër të tjera, rritje pagash. Mendoj që kjo shprehje as që është adapte. Duhet të quhet harmonizimi i pagave. Madje- madje, sa unë e di, ministri Bajrami është duke bërë përgatitjet e fundit në Ligjin për sistemin e pagave edhe në atë do të bëhej rregullimi i përgjithshëm i pagave, që e kanë burimin nga buxheti edhe në të ardhmen, e pastaj me koeficient, sipas mundësisë që të shkohet në harmonizim, se

ndryshe nëse do të shkohej segment- segment, do të mund të pritshim kundërshtime, protesta, greva të grupacioneve, non-stop do të përcillej viti me këto.

Te ndarjet buxhetore, e kam një vërejtje, marr vetëm, ju lutem, si shembull, Pejën, e cila në njëfarë mënyre virtuale është njëfarë mini-kryeqyteti që e mbulon edhe Gjakovën, edhe Klinën, edhe Burimin, e tjera, tjera.

Krahasuar me Prizrenin, po e zëmë, Prizreni dy herë më tepër merr kuotë se sa Peja, domethënë është fjala te kriteret. Jam për kriteret objektive dhe për njëfarë shpërndarje të balancuar, për aq sa është e mundur.

Për ekstra profitin në buxhet nuk ka pozicion që do të duhej të kishte. Ne i kemi disa organizata biznesore të sektorit publik, që realizojnë ekstra profit, jo në saje të djersës, jo të dijes, jo të punës, jo të disiplinës, jo të organizimit, por në saje të pozitës monopoliste në treg. Kudo shtetet moderne e kapin ekstra profitin në buxhet, e na kemi me mijëra vende ku do të mund ta orientonim dhe do të bëhej një ndarje korrekte. Pra, vetëm ta marrim Trustin e Pensioneve, ku nga paraja e pensionistit, po e quajmë kushtimisht pensionist, sepse merr mesatarisht 50 euro në muaj, marrin do farë që vetë quhen ekspertë, edhe ne gabojmë shpeshherë, i quajmë ekspertë, marrin paga 10 mijë, 12 mijë euro muaj për muaj, kurse paguajnë me qindra, mijëra euro për këshilltarë. Domethënë, e kundërshtojnë vetveten se qenkan edhe profesionistë, se po të ishin ekspertë, nuk do të kishin prodhuar humbje qindra milionëshe, nuk do t'i kishin dhënë qindra milionë tjera për disa ekspertë që i angazhojnë me kontrata.

Ju lutem, segmenti i Sigurimit Shëndetësor, Invalidor e PENSIONAL është shumë delikat, tepër i nevojshëm për të pasur vendin në buxhet në kuptimin të financimit, se kjo është një çështje jetësore, shumë e rëndësishme, emergjente dhe imediate.

Do t'i kisha sugjeruar Qeverisë që 6 pikat famoze, provokative, irrituese, hipokrite, inkonsistente të zotëri Banit, deshëm s'deshëm do të reflektohen në burimet e buxhetit, një. E dyta, kriza financiare globale, këto janë rrethana që tek e fundit po i dimë, prandaj do të duhej të inkorporoheshin, të involvoheshin dhe të evaluoheshin dhe për aq të bëhej, si të themi, një korreksion.

Në përgjithësi, unë e konsideroj këtë dokument të mirë, një punë serioze dhe uroj që të sendërtohet. Ju faleminderit !

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, caktoj 15 minuta pauzë për kafe dhe prapë kthehemi dhe e vazhdojmë.

Vazhdimi i seancës pas pauze

KRYESUESI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë me diskutimet. Fjalën e ka deputeti Enis Kervan, le të përgatitet deputeti Xhezair Murati. Sekretaria, fjalën deputetit Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Sayan bakanlar, değerli milletvekiller,

2009 yılı Bütçe önerisiyle ilgili bazı noktalara müsadenezle değinmek istiyorum. Kosova toplulukları ve özellikle çoğunluk olmayan topluluklar söz konusu olunca, maalesef

temel ihtiyaçları halen çözüme ulaşmamıştır. Gençlik tesisleri, emeklilere yönelik sosyal tesisler için bu yılki taslakta da maalesef gerekene yer verilmemiştir. Ancak söz konusu kültürel miras olunca, kayda değer ilerlemeler görülmektedir. Örneğin Prizrendeki kalle ile ilgili proje için bütçe gerektiği kadar tatmin edici olmasa bile, bazı ilerleme adımları gerçekleşmiştir. Bunun için de Hükümeti ve donatörleri tebrik etmek gerekmektedir. Bu yılki Taslakta diğerleri arasında bazı boşluklar mevcuttur. Kosova vatandaşları bağımsızlık sonrası özellikle son günlerde büyük bir sevinçle yeni kimlik ve pasaport belgelerini almaktadırlar. Ve bunları yenilemek için sivil kayıt merkezlerine akın etmektedirler. Ancak bütçe yetersizliği yüzünden yaratılmayan şartlar vatandaşların bu merkezlerde izdiham yaşamasına sebep olmaktadır. Örnek vermek gerekirse 2000 yılında Prizren belediyesinde kırsal kesimleri de dahil ederek 30 sivil kayıt merkezi bulunurken ve bu merkezlerde 300'e yakın kişi çalışırken bugün Prizren bölgesinde zor şartlarda sadece tek bir merkez ve ortalama on işçi çalışmaktadır. Tek gün içerisinde ise 300 civarında vatandaş belediye içi ve civar köylerden gelerek yeni kimliklerini elde edebilmek için çok büyük zorluklarla ve izdihamla karşı karşıya kalmaktadırlar. Bunun sebebi elbetteki bütçe eksikliğidir ve ek merkezlerin açılmayıp. Yerel yönetimler yasına göre belediye olan Mamuşanın da kayıt sivil merkezinin oluşması gerekmektedir. Ancak Mamuşa belediye yetkililerin tüm girişimlerine rağmen, konuyla ilgili yeterli derecede Taslakta bütçenin ayrılmadığı gözetilmektedir. Söz konusu eğitim olunca örnek vermek gerekirse Ortakol Prizren belediyesinde bir sürü okullar için ek bütçeler ayrılmıştır ancak şehir ve okul ismi verilmeden azınlık ilkokulu olarak 200 bin eroluk bir bütçeden söz edilmektedir. Oysa 2008 yılı bütçesinde de ileri sürdüğümüz gibi bu yıl da Prizren belediyesinde eğitim bakanlığı ile ilgili görüşmelerimiz neticesinde ve bakanın vaadleri doğrultusunda "Motra Çirijazi" ilkokulunda sekiz ek sınıfın gerçekleşmesi için bütçede gereken taleble ilgili bir açıklama göremedik. Sadece 200 bin euro civarında bir rakam verilmiştir. 2009 -11 yılı Prizren eğitim müdürlüğünün eğitim programının uygulanması için ek bütçe gerekmektedir. Çünkü bu Taslak Bütçe Önerisinde plan program uygulamaları için Kosova geneline 400 bin euroluk bir bütçe öngörülmüştür, ki bu da çok yeterli değildir. Böylece bütçenin sağlanmasıyla özel ilgiye muhtaç öğrenci ve bireylerin de ihtiyaçlarını karşılamış olur. Bütün vatandaşlarımıza hizmet etmiş oluruz. Son olarak çevre temizliği ile ilgili bütçenin eksik olduğunu da vurgulamak istiyorum. Bir tarihi kültür merkezi olan Prizren şehrinde yangın neticesinde hasara uğrayan belediye binasının hala Prizren şehrinin güzelliğini bozmaya devam ettiğini hatırlatarak sözlerime son veriyorum.

Teşekkür ederim.

KRYESUESI: Ju faleminderit, zotëri deputet! Fjalën e ka deputeti Xhezair Murati, le të përgatitet deputeti Adem Salihaj. Regjia, fjalën deputetit Murati.

DŽEZAIR MURATI: Hvala gospodine predsjedavajući!

Dozvolite da i ja pozdravim Vladin kabinet, ne vidim prejimera i zamenike. Mislim da je danas izuzetno značajan dan kada smo napokon dobili predlog Nacrta budžeta za 2009. godinu, što predstavlja jedan od vrlo značajnih skupštinskih dana kada poslanici, bilo oni u poziciji ili opoziciji mnogo pažnje i truda ulažu kako bismo došli do najboljih rešenja.

Mislimo da u prvoj godini postojanja mlade kosovske države, doći do najboljih rešenja u predlogu budžeta, svakako je iluzija. Sigurno da je tu uloženo i mnogo truda, da ima

možda i odredjenih promašaja u predlozima, u rasporedu ministarstava ko je koliko sredstava dobio i tako dalje.

Ja ću prvo krenuti od budžeta, kako je raspoređen na opštinskom nivou. Iako su odluke na tom nivou donešene, mislim da u Prizrenu imamo odredjenih primedaba, dok u drugim sredinama gde žive predstavnici moje zajednice, kako tako je uspešno urađen predlog budžeta.

Naime, u Prizrenu gde se budžet planira sa 22,8% za zajednice, mislim da u predloženom nacrtu ova raspodela nije dovoljno predložena ili obuhvaćena. No, s obzirom na to da ima vremena do konačnog usvajanja, ja se nadam da će odredjeni propusti biti nadoknadjeni.

Da krenemo po ministarstvima. Recimo, predlog budžeta u Ministarstvu zdravstva za manjinske zajednice, ne primećujemo da je dovoljno infrastruktura, pogotovu na terenu, predložena. Znamo poteškoće sa kojima se suočava Ministarstvo zdravstva, ali nadamo se da će i ta negativna infrastruktura na terenu koliko toliko biti ublažena u narednoj godini.

Medjitim, kada je u pitanju obrazovanje, ja mislim da je nesumnjiv napredak u ovoj oblasti postignut. Postoje rezultati, postoje i ulaganja u poboljšanju kvaliteta nastave, ali se nadamo da će trud u podizanju kadrova i poboljšanju snabdevanja udžbenicima i kvalitetnim prevodima biti najbolja investicija u daljoj pomoći uspešnih integracija manjinskih zajednica.

Mislim da smo u više kontakata sa ministrom obrazovanja, koji je imao i volju i želju da se sa nama mnogo puta sretne i da o ovim problemima razgovaramo, mislim da ćemo biti još jednom u nekoj situaciji da zamolimo i da budemo zahvalni. Zaista, nedostaje nam još uvek dovoljan broj udžbenika, prevodi su dosta..., ima propusta kod prevoda. Ja bih se ovde zadržao i na još jedan dodatni problem. Naime, u nastavi na bosanskom jeziku, kada je u pitanju nastava jezika sredine, dakle albanskog jezika, primećujemo da imamo dosta propusta, kadar je nedovoljno stimulisan da radi, nemamo adekvatne udžbenike, nemamo potrebne rečnike iako imamo i želju učenika i volju roditelja da se brižljivo ka ovom predmetu odnosimo ali... Mislim da je integracija manjinskih zajednica preko učenja jezika izuzetno značajna pa se nadamo da će uzeti u obzir ministar za iduću godinu kako bi smo otkonili neke od propusta.

Kada je u pitanju infrastruktura, odnosno Ministarstvo saobraćaja, takodje smo zadovoljni do sada urađenim projektima i onima koji su planirani, ali iako smo razgovarali sa ministrom za komunikacije, prema njegovim rečima, nije njegov propust, niti njegovog odnosno našeg Ministarstva saobraćaja i komunikacija kada je u pitanju signal RTK. Naime, skoro 10 godina iza rata, sredine u kojima žive bošnjaci, kada su u pitanju, ja bih rekao i druge manjinske zajednice u prizrenskom regionu, kada su u pitanju regije Župa, Gora, Podgora i tako dalje, još uvek nemamo signal RTK, a znate koliko je značajna prava informacija kada ona dolazi iz zemlje u kojoj žive predstavnici manjinskih zajednica, a ovde ću samo pomenuti da se još uvek ubiru 3,5 eura pretplate, da smo doneli jedan amandman u Zakonu o RTK, da je Ryker kasnije jednom uredbom to poništio, makar od tih sredstava od 3,5 eura koja plaćaju građani da se ona koristi u izgradnji manjih repetitora na tom terenu kako bi smo došli do prave i autentične

informacije građanima, a ne da se koriste građani tih sredina informacijama iz okolnih zemalja i tako dalje, i tako dalje.

Dalje, gospodo, koncept multietničnosti na koji toliko pažnje posvećujemo, ja bih ovom prilikom rekao posebno se odražava kada je u pitanju Ministarstvo za povratak, odnosno ono se zove Ministarstvo za zajednice i povratak. Tu još uvek imamo dosta nepoznanica, dosta nesporazuma, dosta neprofesionalnosti, jedan je ministar zamenjen, nema dovoljno transparentnosti kada su u pitanju projekti za manjinske zajednice van srpske zajednice. Mi ne želimo ostale zajednice, govorimo o bošnjačkoj, turskoj i romskoj, da budemo manjinske zajednice unutar jedne druge manjinske zajednice.

Mi smo čuli danas od premijera, 8,5 miliona sredstava, od 7,5 miliona sredstva projekata. Govori se o nekim kućama za povratnike i tako dalje. Medjutim, naše zajednice nisu obuhvaćene tim projektima. Mislim da je to jedna nepravednost koju treba otkloniti. Ja se nadam, tu je zamenik premijera, tu su resorni ministri, da ćemo voditi računa o tome da uključimo i ostale zajednice, i to da vodimo računa kako da zadržimo, da ne dodje do daljnjih odlazaka, jer izvozimo besplatno najkvalitetniju robu, to su mladi kvalitetni i školovani kadrovi. U to ime, ja apelujem još jednom na Vladu da malo više povredemo računa.

Kada su u pitanju kancelarije lokalnih zajednica, nema logičnog sleda njihovog finansiranja. U manjim gradovima veća su sredstva, u većim gradovima gde ima više manjinskih zajednica, manja sredstva. Ja bih voleo da se malo povede računa o tom skladu. I, u svakom slučaju, ja završavam želeći da ukažem na još jednu kategoriju iz ugla poslanika ovog Parlamenta, kategoriju ugroženih građana, dakle penzionera i invalida. Sigurno je da postoje načini kako da se zahvate sredstva iz nekih akciznih roba, to smo predlagali ovde i pre dve, i pre tri godine, medjutim nije bilo nekih rezultata u tom pogledu. Mi se nadamo da će doći do nekog rešenja ovih ugroženih kategorija, dakle govorim o penzionerima i invalidima rada.

Moji predlozi, odnosno naši predlozi su usmereni samo na poboljšanje onoga što je radila i Vlada, a to je da svim građanima predloženi budžet bude što dostupniji, kako bi smo svi zadovoljniji bili u vremenu velike ekonomske krize koja će nadam se, nas zaobići. Hvala vam!

KRYESUESI: Faleminderit, deputetit dhe anëtarit të Kryesisë, Xhezair Murati.

Fjalën e ka deputeti Adem Salihaj, le të përgatitet deputetja Gjylnaze Syla, e cila si duket nuk është këtu. Pas saj vjen Zylfije Hundozi, që po ashtu nuk është këtu. Nuk është këtu as Ethem Çeku. Le të përgatitet deputeti Zylfi Merxha.

ADEM SALIHAI: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Anëtarë të Qeverisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ne me të drejtë kemi pritur një projektbuxhet, i cili, për aq sa lejojnë mundësitë ekonomike të Kosovës, do të bëjë një hap përpara në zhvillimin ekonomik të saj.

Partitë që sot kanë pushtet, kanë pasur oferta shumë joshëse në programet e tyre politike si, po e zëmë, dritë 24 orë, hapje të vendeve të reja të punës, programe të

shumta të zhvillimit të bujqësisë, kabinete kompjuterike nëpër të gjitha shkollat e tjera. Me fjalë të tjera, një program shumë joshës.

Në vitin e parë kjo Qeveri që është me fat, sepse që vit i proceseve të mëdha dhe kur dikush feston, ai është i kënaqur dhe për disa kohë i harron problemet që ka.

Fatin se saj e bëri edhe më të madh fakti se Qeveria paraprake që mjaft e dobët dhe nuk arriti t'i shpenzonte edhe ato pak para që kishte buxheti i Kosovës, e i cili nuk i plotëson as nevojat më minimale të saja. Ishte e pabesueshme dhe e paimagjinueshme që një vendi me aq pak buxhet e me aq shumë nevoja, në fund të vitit t'i tepronin mbi 30 milionë euro.

Kjo teprice i krijoi një komoditet tepër të madh kësaj Qeverie dhe ia mundësoi që pa ndonjë problem ta fsheh mungesën e angazhimit të saj.

Është e mundur që ky inercion dhe ky komoditet ta përcjellë këtë Qeveri edhe në një pjesë të vitit që po vjen, sepse janë edhe fondet e donatorëve ato të cilat do ta mundësojnë krijimin e një përshtypjeje se kjo Qeveri po realizon investime të mëdha. Megjithatë, t'i shohim gjërat pak më konkretisht.

Kosova nuk ka shanse shumë të mëdha për zhvillim ekonomik në shumicën e fushave, por janë disa fusha siç është, për shembull, bujqësia që me disa investime do të krijojnë efekte të mëdha ekonomike. Nuk ka fushë më të përshtatshme në Kosovë që do të jepte rezultate më të shpejta se sa bujqësia. Me disa investime dhe programe zhvillimore jo edhe aq të mëdha, në bujqësi do të punësoheshin qindra mijëra njerëz, sepse Kosova i ka pothuaj se të gjitha kushtet e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë. Ka resurset natyrore, ka resurset njerëzore, ka mekanizmin bujqësor.

Nevojitet vetëm një shtytje e vogël dhe do të kishim arritur shumë efekte pozitive ekonomike. Së pari, do të zvogëlohej dukshëm numri enorm i të papunëve, së dyti, Kosova nuk do të detyrohej të importonte kaq shumë artikuj ushqimor, në këtë mënyrë do të ruheshin fondet tona të pakta të buxhetit dhe nuk do të eksportohej jashtë.

Të mos harrojmë se kishte shumë premtime për investime në bujqësi, por në këtë projektbuxhet nuk ka asgjë prej këtyre premtimeve të mëdha, nuk ka subvencionim të bujqësisë, nuk ka programe zhvillimore të bujqësisë, nuk ka as bankë agrare, pra, për bujqësi.

Prej tri premtimeve të mëdha, nuk ka asgjë prej gjëje, por fakti se nuk janë paraparë fonde për zhvillimin e bujqësisë, nuk do të thotë se paratë e buxhetit nuk shkojnë në sfera të tjera. Po e zëmë, për KEK-un janë destinuar shuma të mëdha, siç del këtu, janë paraparë mbi 120 milion ose 130. KEK-u është ai kazani i madh pa fund, i cili gëlltitë fondet tona dhe askush nuk e di se çka po ndodhë realisht atje.

Investimet në KEK ndoshta janë mënyra më e përshtatshme për shpërdorimin e parave të buxhetit të Kosovës. Edhe përkundër të gjitha këtyre parave që shkojnë në KEK, gjendja e furnizimit me energji elektrike është gjithnjë e më e keqe, mund të themi më e keqe se sa në periudhën e Qeverisë së kaluar. Në fund do të shihet se të gjitha këto fonde që shkojnë në KEK do të japin vetëm kundër efekte.

Vetëm analizojeni një çështje. Në energji dhe miniera shkojnë rreth 300 milionë euro dhe llogaritni, me 300 milionë euro mund të ndërtohet një termoelektranë në Kosovë që do të prodhonte 250 deri 300 megavat dhe ne do të zgjidhnim një problem shumë të madh që është para nesh.

Në këtë Projektbuxhet janë paraparë edhe mjaft investime në minierat e Kosovës. Dikujt ndoshta mund t'i kalojë kjo pa u vërejtur, dikujt tjetër kjo do t'i dukej e çuditshme. Disa miliona euro janë paraparë të investohen në miniera, ndërkohë që nuk pritet që ato miniera të japin efekte serioze ekonomike dhe financiare, nuk pritet të realizohen fitime as aq sa investohet atje. Po, siç e thashë, kazani i madh i KEK-ut dhe horizontet e errëta të minierave janë mënyra më e përshtatshme që larg syve të opinionit të shpërdorohen fondet e buxhetit të Kosovës.

Në fund të vitit të ardhshëm, ne do të jemi dëshmitarë të efekteve zero të investimeve në KEK dhe në minierat e Kosovës, pastaj do të vijë privatizimi dhe të gjitha investimet do të shiten nja 100 herë më lirë dhe dikush do të përfitojë shumë nga e gjithë kjo.

Në fund, të ndalem te investimet kryesore, me të cilat krenohet kjo Qeveri. Është e qartë se kjo Qeveri nuk ka programe të mirëfillta të zhvillimit, por ka programe për krijimin e efekteve në opinion, të cilat qëllim kryesor kanë përfitimin e elektoratit.

Asfalti është karakteristika kryesore e investimeve të kësaj Qeverie. Ka qenë e pritshme kjo, duke marrë parasysh edhe suficitin e trashëguar. Pastaj, asfalti ia ka krijuar mundësinë kësaj Qeverie që t'i fshehë dështimet dhe mungesën investimeve në fushat e tjera, por edhe aty duhet pritur skandale. Po e zëmë, aksi i autostradës Fushë Kosovë – Sllatinë, i përfolur aq shumë deri tash, është kontraktuar për një çmim marramendës e të pabesueshëm. Në një rajon plotësisht të rrafshët, nëpër ara të lëvruara, pa asnjë pengesë ku nuk gjen asnjë shkëmb apo gurë të vetëm, ku e gjithë puna mund të kryhet me një eskavator të thjeshtë, ku janë dy – tri ura aq të thjeshta, është e pabesueshme të paguhet një çmim aq i lart, i cili nuk paguhet as në vendet e zhvilluara.

Në një seancë u dha një sqarim se kishte edhe raste në rajon, si për shembull, në Mal të Zi, ku një kilometër rrugë kushtonte edhe më shtrenjtë, por është absurde të krahasohet terreni i pakalueshëm me shkëmbinjtë e thepisur në Mal të Zi, ku terreni mund të hapet vetëm me eksploziv, me tokën e rrafshët si tepsi të rrafshit të Kosovës.

Kjo qeveri ndoshta do të jetojë me iluzione se ky skandal do të kalojë me pakë zhurmë, por unë shpresoj se do të gjendet mënyra që një ditë të dalë në shesh se ku realisht po shkojnë mbi 15 milionë nën maskën e investimeve në këtë rrugë.

Dëshiroj të ndalem edhe te një investim, i cili do të vazhdojë edhe gjatë vitit të ardhshëm. E kam fjalën për pjesën e autostradës prej Çagllvicës deri te QMI-ja. Kjo rrugë, të cilën ne e kemi pritur me padurim, është punuar aq keq dhe në mënyrë aq jocilësore sa që kur kalonin nëpër të me veturë, në çdo 10 apo 15 metra ka gunga dhe rrapëllima ritmike. Unë kaloj pothuajse çdo ditë nëpër këtë rrugë dhe nga rrapëllima ritmike e gungave keni përshtypjen se jeni në tren e jo në autostradë.

Nuk u duhen kurrfarë ekspertësh që ta shihni se sa keq është punuar këtu, të mos flasim se në disa pjesë të saj u prish asfalti ende pa u bërë një muaj.

Dëshiroj ta theksoj edhe një problem që lidhet me çështjen e shëndetësisë. Spitali i Ferizajt, i cili sipas vendimeve të Ministrisë të Shëndetësisë ka statusin e spitalit të qytetit e jo të spitalit regjional, ka marrë diku tri herë ose katër herë më pak mjete financiare sesa spitalet e ngjashme që janë në qytetet e tjera të Kosovës dhe, vetëm krahasoni, rajoni i Ferizajt ka rreth 300.000 banorë, që është pothuaj i barabartë me të gjitha rajonet e tjera dhe për një kokë banori investohet tri herë ose katër herë më pak në Ferizaj se gjetiu.

Në fund, përfundoj se ky buxhet është konsumues, ndërsa në pjesën dërmuese, siç u tha shumë herë, krijohet nga të hyrat doganore. Me këtë politikë të Qeverisë, ne importojmë pothuaj se çdo gjë dhe eksportojmë mbeturinat e hekurit dhe paratë tona kesh të buxhetit. Në këtë mënyrë, ne varfërojmë vetveten në vend që të kemi zhvillim ekonomik.

Duhet theksuar edhe faktin që u tha këtu disa herë, se Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vërejtje të mëdha në këtë Projektbuxhet dhe në mënyrën e shpenzimit të parasë publike të Kosovës.

Kjo Qeveri nuk duhet të krijojë rreziqe apo mosbesim edhe në rrugën e anëtarësimit të Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar. Në fund, dëshiroj ta theksoj edhe një çështje.

Në veri të Mitrovicës po bëhet një përpjekje mbinjerëzore për të mbijetuar. Qeveria e Kosovës, e cila nuk po u ofron siguri atyre njerëzve, sot nuk po u ofron asnjë ndihmë të vogël financiare, të mos flasin për atë 10 mijë eurshin famoz që ishte vetëm sa për ta larë fajin dhe ka lënë një shije shumë të keqe.

Qeveria e Kosovës e ka lënë atë pjesë të Kosovës të braktisur në të gjitha aspektet, sot edhe në aspektin e ndihmës financiare, por kur nuk investojmë ne asgjë aty, investon dikush tjetër në të gjitha aspektet dhe efektet tashmë i kemi parë, por nesër do t'i shohim edhe më të këqija. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Ju faleminderit, deputet Salihaj!

Fjalën e ka deputeti Zylfi Merxha, le të përgatitet deputeti Zef Morina.

ZYLFI MERXHA: I nderuar zotëri kryesues,

Ju përshëndes juve edhe kolegët e tu aty ngatë teje,

E përshëndes Kryeministrin, zëvendëskryeministrin dhe të gjithë ministrat,

Sot Mark Krasniqin nuk e kemi këtu, akademikun, kështu që vendin e plakut e zura unë, se më plak se unë nuk ka këtu. Kjo është e vërtetë. Po, do të them diçka, për 10 vjetët e mia që isha në këtë Parlament, tri herë, edhe një herë isha me Kushnerin, 4 herë, do me thënë 10 vjet, kurrë nuk pata rast ta shoh sikur sot që e ndjeva prej ministrit, zotëriut, për 2009-shin çfarë raporti financiar kanë përgatitur dhe, çka është më interesant, asnjë i huaj nuk ka qenë aty, vetëm kuadrot e tona të Kosovës së re.

Mos të harrojmë se për çdo send të mirë, gjithkush nganë. Edhe sot nuk dinin qysh ta merrnin fjalën më shpejt, prej çudisë çka të flasin, qysh të flasin, qysh të kritikojnë, qysh të lavdërojnë. Disa, shumica dolën prej rendit të ditës, nuk dinin çka të flasin. Shembull, do ta marrë shafen time, zonjën që as nuk na përmendi, tha po flas në emër të “7+”,

ajo foli krejt për do podrume, do fjalë, ku ta di unë, krejt jashtë këtij, sikur që edhe kolegu tjetër beri ashtu.

Unë po ju them një send. Ne e harruam që kemi gajlet e dertet e Kosovës, 6 pikat, Bani që na ka lënë të padrejtat, e dini, të mos e zgjasim. Mirëpo, e dini që edhe Qeveria jonë, në krye me Presidentin e Kosovës, i ka dhënë katër pika, që do t'i pranojnë gjithqysh, dhe ne jemi faqebardhë para gjithkujt. Çdo punë që bëhet, ka edhe gabime. Ndoshta edhe referati i zotit ministër ka gabime, mirëpo me diskutimin e juaj shumë e keni plotësuar dhe do t'ju pranojë çdo vërejtje.. Mos t'ju flas për Kryeministrin, për fjalimin që na e mbajti, e dëgjuat me vëmendje. Po edhe Xhavit Haliti krejt me rend shkoi. Do me thënë, ky Parlament që jemi këtu, e dimë çka po lypim, e dimë çka po flasim, po ta lëmë xhelozinë anash. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, Haxhi!

Fjalën e ka deputeti Zef Morina, le të përgatitet Myzejene Selmani.

ZEF MORINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zotëri Kryeministër, zëvendëskryeministër,

Të nderuar ministra,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Projektbuxhetin që sot po e diskutojmë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, ka një rëndësi të veçantë sepse është buxheti i parë i Qeverisë së Republikës së Kosovës, gjegjësisht buxheti i shtetit të Kosovës që është punuar krejtësisht apo tërësisht nga ekspertë dhe nga Qeveria e jonë, pa ndërhyrjen e faktorit ndërkombëtar.

Me vëmendje kam analizuar dhe mund të them se ky Projektbuxhet dukshëm është më i avancuar nga buxhetet e kaluara

Funksionalizimi i shtetit apo i një vendi është i varur nga kapacitetet buxhetore dhe menaxhimi i drejtë i buxhetit nga ana e institucioneve, gjegjësisht nga ana e qeverisë. Nga prioritet e përcaktuara në projektbuxhet dukshëm shihet qëllimi i Qeverisë, i cili është i orientuar në rritjen ekonomike, krijimin e kushteve më të mira për qytetarët e Kosovës, sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë, stabilitetin social e tjera.

Është e kuptueshme se Buxheti prej 1.94 miliardë euro nuk mund të plotësojë të gjitha kërkesat që i kanë qytetarët e Kosovës, por me rëndësi është se duhet orientuar në fushat më të rëndësishme të funksionalizimit të shtetit të Republikës së Kosovës. Politikat fiskale që ka përcaktuar Qeveria, mendoj se janë të arsyeshme duke pasur parasysh situatën në të cilën jemi edhe pse ka pasur vërejtje nga Fondi Monetar Ndërkombëtar.

Anët pozitive të buxhetit i kam klasifikuar, me sa vijon:

1. Është me rëndësi dhe gëzon fakti se ky buxhet ka rritje rreth 15% në krahasim me buxhetin e vitit të kaluar.
2. Në këtë projektbuxhet parashihet shkalla e ngritjes ekonomike rreth 6% që shumë vende të rajonit nuk e kanë.
3. Mbështetje në vlerën prej rreth 413 milion eurove për projektet kapitale, duke përfshirë infrastrukturën, arsimin, shëndetësinë, si dhe një vlerë prej rreth 12

milione euro investime kapitale jashtë vendit, gjegjësisht në ndërtimin apo blerjen e ambasadave të Republikës së Kosovës në vendet e jashtme.

4. Ngritja e të ardhurave për shërbyesit civilë që do të fillojë nga 1 janar në vlerë prej 10%, dhe
5. Zvogëlimi i shpenzimeve të mallrave dhe të shërbimeve, si të karburanteve dhe të shpenzimeve të tjera, të cilat në të kaluarën e kanë rënduar shumë buxhetin e Kosovës.

Çështjet, të cilat mendoj se duhet shqyrtuar gjatë amendamentimit, janë:

- Mundësia e ngritjes së buxhetit në sektorin e shëndetësisë, gjegjësisht në ilaçet esenciale, si dhe mjetet të cilat nevojiten për mjekim jashtë vendit;
- Ngritja e të ardhurave në sektorin gjyqësor, të cilët nuk është e drejtë të krahasohen apo të trajtohen si shërbyes civilë;
- Në sektorin social ka ngritje prej 12.5%, gjegjësisht pensionet, mundësisht që të shikohet mundësia që kjo vlerë të rritet, sepse është vërtet ngritje mjaft e madhe, por në krahasim me bazën nuk është ndonjë ndikim i madh;
- Në sektorin e infrastrukturës rrugore mendoj se Qeveria ka bërë një ndarje shumë të drejtë nga ana e saj, por kërkoj nga Ministria, gjegjësisht nga ministri që të shikojë mundësinë e shpërndarjes së drejtë të investimeve të mjeteve, të cilat i ka në bashkëfinancim me komunat, gjithnjë duke u mbështetur në gatishmërinë e komunave dhe prezantimin apo përgatitjen e projekteve nga ana e komuniteteve dhe komunave, sepse kjo do të kishte një ndikim shumë të madh në zhvillimin apo ngritjen e rrugëve të zonave rurale, të cilat kanë një ndikim shumë të madh në zhvillimin e vendit të atyre zonave;

Mendoj se kishte me qenë mirë që në hekurudha të kihet parasysh një ngritje, e kjo mund të shikohet edhe me rishikim, sepse mendoj që një vlerë prej 3.5 milionë eurove nuk është e mjaftueshme.

Nuk e di përse Ministria nuk e ka marrë parasysh të shikojë mundësinë e ngritjes së aeroportit të Gjakovës në aeroport të nivelit alternativ. Ai, tani për tani, është ushtarak, kur dihet se projekti është i gatshëm dhe ekziston gatishmëria dhe mundësia e ndihmesës nga ana e qeverisë italiane që ky aeroport mund të shfrytëzohet edhe për interesa komerciale, si aeroport alternativ në momentin kur Aeroporti i Prishtinës do të ketë pengesa në funksionim. Kjo ndoshta kishte për të qenë edhe një hap i mirë, sepse para se të jepet në koncesion Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës, mund të bëhet, pastaj do të kishte probleme dhe vështirësi që të mund të kemi investime tjera. Mendoj se është e nevojshme që Kosova ta ketë edhe një aeroport alternativ, siç është aeroporti i Gjakovës.

Unë, si anëtar i Komisionit për Ekonomi, Transport dhe Infrastrukturë, si dhe kryetar i Grupit punues për respektimin ose monitorimin e Ligjit mbi rrugët, kemi hasur që vërtet tani këto punë të cilat është duke i kryer Ministria, janë vërtet të kualitetit mjaft të lartë dhe nuk pajtohem me atë që tha kolegu më herët, sepse rruga Prishtinë-Fushë Kosovë është rrugë e cila i ka parametrat më të avancuara nga të gjitha rrugët që janë ndërtuar

deri më sot në Kosovë. Është e nivelit të autostradës dhe njoftoj se vetëm ura janë mbi 700 metra, që do të thotë se çmimi i kushtimit të kësaj rruge është nën nivelin e çmimit të gjitha rrugëve në rajon. Këtë po e them nga aspekti profesional, e jo politik.

Unë, personalisht e mbështes këtë projektbuxhet dhe kërkoj këto vërejtje të kihen parasysh gjatë amendamentimit që do të bëhet në leximin e dytë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Radhën e ka deputetja Myzejene Selmani, le të përgatitet Naser Osmani.

Prit pak, deputete Selmani! Donika Kadaj, s'është! Rasim Selmani, nuk është. Atëherë, le të përgatitet Esat Brajshori. Vazhdo, deputete!

MYZEJENE SELMANI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje për Kabinetin qeveritar dhe për të gjithë deputetët këtu, Njëkohësisht, përshëndetje edhe për Kryeministrin, që po e përcjell seancën për projektbuxhetin sot këtu.

Në bazë të analizave të cilat i kam bërë në këtë projektbuxhet të Kosovës, pikësëpari mund të them se është një buxhet politik, i varfër dhe njëkohësisht shpenzues. A është ky projektbuxhet për një stimulim fiskal, për zhvillimin e Kosovës në shkallën e projektuar rreth 6% për vitin 2009, absolutisht aspak real me shifra të brishta dhe jo të sakta. Këtë mund ta them, zotëri ministër.

Ndryshimi i politikave tatimore prej 15% në 16% me vërejtjet e Fondit Ndërkombëtar, mund të them se edhe këtu absolutisht në kurriz të njerëzve të varfër nuk mund të përfitosh. Një rritje apo një subvencion i buxhetit, i cili përsëritet në çdo vit buxhetor, do të thotë se prapëseprapë edhe kjo qeveri nuk ka arritur ta shpenzojë buxhetin 2008 me projektet e tyre deri në fund.

Kjo tregon më së miri sa di qeveria të menaxhojë me paranë publike. Prioritetet e kësaj qeverie, nën një kishte për të qenë rritja ekonomike edhe në bazë të programit të tyre. Se a është bërë rritje ekonomike në bazë të këtij projektbuxheti, mund të them se jo aspak. Sundimi i ligjit, ku edhe Qeveria në Konferencën e Donatorëve ka marrë një donacion mjaft të mirë, edhe këtu mund të them se sundimi i ligjit askund nuk është në bazë të këtij projektbuxheti dhe aspak nuk shihet në terren.

Energjetika, një ndër dikasteret të cilat në Konferencën e Donatorëve njëkohësisht me kornizën afatmesme është premtuar se do të marrë kjo Qeveri donacione, prapëseprapë Qeveria kësaj radhe ndanë mbi 100 milionë për kredi të KEK-ut, e njëkohësisht edhe për blerje të energjisë elektrike, që do të thotë se 24-orëshi ynë mbulohet me para të buxhetit të Kosovës.

Do të kaloj edhe te projektbuxheti i ndarë Kuvendit të Kosovës, ku mjaft mirë shihet se Kuvendi i Kosovës, si organ më i lartë, në të cilin punohen dhe miratohen të gjitha ligjet, ka një buxhet më të vogël kësaj radhe dhe unë këtu nuk kisha mund të paramendoj se si ministri ka llogaritur që Kuvendi prej të cilit kërkohet të miratohet buxheti, të ketë një zbritje buxhetore.

Vërejtjet, të cilat pak më parë zotëri Luli i potencoi, se ka një letër nga Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe ministri ynë në hyrje të buxhetit e ceku: Në aspekt të dytë, Qeveria ka pranuar rekomandimet e Fondit Monetar Ndërkombëtar që, për një vend si Kosova, është i përshtatshëm përvetësimi i rregullës fiskale që e bën vënien e kufijve në shpenzimet publike rrjedhëse. Këtu kisha për ta lutur ministrin Shala, se nuk janë marrë vërejtjet, ku Fondi Monetar Ndërkombëtar thotë te investimet kapitale dhe mjaft mirë e cek që të jenë më të vogla se 400 milionë euro, ndërsa ju i keni më të mëdha se 400 milion euro. Ai këtë e cek për arsye se nuk kanë kapacitete ministrat për implementimin e investimeve aq të larta kapitale.

Me këto vërejtje, besoj se ministri do ta përmirësojë projektbuxhetin, sepse nuk mund t'i them "po" këtij projektbuxheti, zoti ministër. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Esat Brajshori, le të përgatitet Sllavisha Petkoviq. Nuk qenka këtu. Melihate Tërmmkolli? Edhe kjo, nuk është! Le të përgatitet atëherë Sanije Alijaj.

ESAT BRAJSHORI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Nëse më lejohet, në fillim, një vërejtje, miqësisht. Unë propozoj që lista e të lajmëruarve të publikohet në monitor për faktin se po bëhen kapërcime në radhitje.

(Ndërhyrje)

Veç një sekondë, nëse ka mundësi. E di që kam qenë i shtati, pas pauzës së parë dhe tani po dihet ku është radha. Shumë kolegjisht, është shumë korrekte dhe më mirë do të ishte. Faleminderit!

Zoti Kryetar i Kuvendit,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të gjithë elaboruan në mënyrën e tyre Projektbuxhetin e ofruar nga Qeveria në sferat përkatëse dhe unë nuk e heq veten si njëri të gjithanshëm që të bëj një rikapitulum të gjithë këtij projektbuxheti, por pata dëshirë të ndalem në një fushë, e cila u prek nga një koleg imi deputet në një masë të theksuar, shumë kalimthi nga ministri i Financave dhe fare hiq nga Kryeministri. Është fjala për buxhetin për kulturë, rini dhe sport.

Unë dua të besoj se debati për këtë projektbuxhet për vitin 2009, me theks të veçantë – projektbuxheti për kulturë, rini dhe sport, nuk do të bie në vesh të shurdhër, por do të mirëkuptohet nga Qeveria që për këto fusha të rrisë buxhetin për vitin 2009, sepse ka argumente dhe arsye të forta për këtë gjë.

T'i shkoj me radhë njëherë asaj se çfarë ofron ky projektbuxhet për artin dhe kulturën? Jam përpjekur që t'i shikoj tabelat e çdo komune për të parë se çfarë grandesh ofron Qeveria për artin dhe kulturën në nivelin lokal. Unë e kuptoj se për të ardhur deri te ndarja e një linje buxhetore, në këtë rast për artin dhe kulturën, duhet të ketë komunikim të ndërsjellë në mes qeverisë lokale dhe qeverisë qendrore dhe anasjelltas. Por, në rastin konkret është për t'u habitur se si disa komunave, për shembull, të Dragashit, Malishevës, Lipjanit e tjera, nuk u është ndarë asnjë cent për zhvillimin e kulturës dhe të artit. Në këtë projektbuxhet mund të gjesh ndihmën e ofruar nga Qeveria për shumëçka tjetër – për rrethoja, për renovime, për asfalt dhe unë e kuptoj se edhe mbjellja e një fidani në vendin

tonë do të thotë jetë, por që kultura dhe arti të anashkalohen kaq ashpër, për mua është një çështje e pakapërcyeshme.

Në anën tjetër, nga projektbuxheti qeveritar për vitin 2009, në shumë prej 1.094.300.000 euro, Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit i janë ndarë 11.058.433 euro dhe vetëm kjo do të thotë se, nëse e kthejmë në përqindje, i bie 0.8% e buxhetit. Mendoj se vetë kjo përqindje tregon joseriozitetin e qasjes së Qeverisë ndaj kulturës dhe artit.

Megjithëkëtë, ta shtjelloj më tutje këtë projektbuxhet për rini dhe sport. Ajo që është esenciale për mua, dhe irituese në të njëjtën kohë, është qasja e politikës ndaj artit dhe kulturës. Absolutisht, mungon vetëdijesimi i politikës për të kuptuar rëndësinë dhe vlerën që bartë një popull e që definojnë si kulturë.

Ministria e Kulturës, e cila ka nën vete ose menaxhon 32 institucione kulturore, do të jetë e hendikepuar në kuptimin e zhvillimit të politikave kulturore me buxhetin e dhënë. Trajtimi i këtyre institucioneve të kulturës bart rreziqet e akulturimit dhe të komercializimit vulgar.

Dua të përmend vetëm dy institucione shumë të rëndësishme të kulturës dhe të artit për vendin – Teatrin Kombëtar dhe Qendrën Kinematografike. Për vitin 2009, Teatri Kombëtar ka kërkuar 500.000 euro, ndërsa Qendra Kinematografike ka kërkuar rreth 1,5 milion euro. Edhe sikur të miratoheshin këto kërkesa, misioni i këtyre dy institucioneve do të ishte i mangët në krahasim me potencialet krijuese dhe projektet artistike që presin për t'u realizuar.

Ju përkujtoj se për vitin 2008 Teatrit Kombëtar i ishin ndarë diçka më shumë se 120.000 euro, andaj mezi i realizoi dy shfaqje dhe tani edhe dy tjera janë në proces, përkundër ligjit i cili parasheh që brenda vitit duhet të realizohen së paku 5 premiera. Ndërsa, Qendra Kinematografike për vitin 2008 kishte një buxhet prej rreth 300.000 eurosh, ndërsa kërkesa e tyre ishte 1.300.000 euro. Këtij institucioni kulturor i ishin premtuar se me rishikimin e buxhetit do t'i ketë edhe 700.000 euro plus, të cilat nuk i morën asnjëherë, derisa suficiti për këtë vit mendohet të jetë mbi 200.000.000 euro.

Një segment tjetër, të cilin ia vlen ta theksojmë, është trajtimi në paga i krijuesve, i artistëve.

Zoti Kryeministër, me shpresë se do ta keni në vëmendje këtë çështje, ju përkujtoj se paga mujore e aktorit të klasit të parë arrin deri në 152 euro në muaj. Me të vërtetë, pagë denigruese dhe trajtim jo dinjitoz.

Hiq më pak premtuese nuk është as e ardhmja e rinisë sonë, e vendit tonë, ku më shumë se 50% e popullsisë janë nën moshën 25 vjeçe. Krejt çka garanton Qeveria e Kosovës për rininë, janë 441.473 euro buxhet, të cilat, nëse ua zbresim shpenzimet bazë, atëherë mbesin afër 350.000 euro dhe përkthyer në përqindje, kjo do të thotë se garantojnë plotë 50 centë për kokë të një të riu për vitin 2009. Mendoj se janë shumë pak.

Sa i përket sportit, nga tabela e ofruar në këtë projektbuxhet, janë ndarë 2.686.000 euro. Nga kjo shumë, si shpenzime kapitale për sport i keni paraparë 1.586.000 euro, ndërsa për subvencionimin e sportit kosovar keni paraparë shumën prej 950.000 euro. Këto shifra, për mendimin tim, nuk garantojnë kualitete sportive të nivelit ndërkombëtar.

Një aspekt tjetër është kontraktimi që ka bërë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për renovimin e 3 palestrave sportive, atë në Klinë, në Malishevë dhe Obiliq dhe që është në procedurë për të kontraktuar renovimin ose ndërtimin e palestrave sportive në Skenderaj dhe Deçan, por që në projektbuxhetin për vitin 2009 nuk është ndarë asnjë cent për këtë destinacion.

Zoti Kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Kultura dhe arti përbëjnë etninë. Investimi në kulturë është art dhe në art është investim në identitetet nacional, është investim në qytetërimin e kombit, është investim në përjetësinë e vlerave që ka një popull. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! E ka fjalën Shkumbin Demalijaj, le të përgatitet Njomza Emini.

(Ndërprerje e shkurtër)

Atëherë, regjia, ju lutem, t'ia mundësoni të marrë fjalën Sanije Alijaj!

SANIJE ALIJAJ: I nderuar Kryetar!
Kryeministër, zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë,
Projektbuxheti është dokument më i rëndësishëm vjetor që propozohet për miratim në Kuvend, me të cilin zhvillohet dhe funksionon Kosova në vitin 2009, është projekt që nuk mbulon vetëm një vit zhvillimor.

Nga projektbuxheti i Kosovës për vitin 2009 është e qartë se buxheti i paraparë nuk ka mundësi të mbulojë të gjitha nevojat që ne i kemi për infrastrukturë më të mirë, furnizim të rregullt me rrymë, pensione dinjitoze, shërbim cilësor mjekësor, shkollim kualitativ, ambient të pastër, drejtësi më të avancuar dhe paga më të larta, por me një ndarje dhe menaxhim më të mirë, mundëson përmbushjen e nevojave më të rëndësishme.

Dihet se brenda Qeverisë gjithnjë ekziston një konflikt në mes qëllimit për të promovuar rritjen ekonomike, në njërën anë, dhe dëshirën për të siguruar se burimet e të hyrave buxhetore janë shpërndarë në mënyrë të drejtë, në anën tjetër.

Anë e mirë e këtij projektbuxheti është se është hartuar për herë të parë nga ekspertët vendorë dhe ka një rritje ekonomike për 6%, por dhe ka rritje të pagave në janar dhe qershor në një vlerë prej 10%, edhe pse simbolike, por vlen për ta vlerësuar për rrethanat në të cilat po kalon dhe zhvillohet Kosova.

Duke u nisur nga prioritetet e Qeverisë së Kosovës për një Kosovë ekonomikisht të qëndrueshme në rrugën e saj drejt integriteteve evropiane dhe të përmbushjes së standardeve më të larta të përgjegjësisë dhe të transparencës, prioritet, ndër të tjera, i është dhënë sundimit të ligjit, arsimit, bujqësisë, shëndetësisë, luftës kundër korrupsionit, por balancet e mjeteve buxhetore nëpër ministri nuk e dëshmojnë këtë. Ky disproporcion, ka disproporcion të madh në mes mjeteve të ndara në ministri. Më herët është thënë se ai vend që investon në të rinjtë, të ardhmen e ka të ndritur. Të rinjve iu sigurohet e ardhmja

vetëm nëse ata kanë arsimim bashkëkohor që të jenë konkurrues në rajon, në Evropë dhe në botë.

Propozoj që gjatë procedimit të mëtejshëm të këtij projektbuxheti, të alokohen mjete për investime si dhe grande konkurruese në fushën e arsimit, të shkencës dhe të kulturës sepse, përndryshe, vështirë e ka Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të shtrijë funksionalitetin e saj dhe të realizojë projekte të nevojshme me një buxhet mbi 11.000.000.

Të gjithë angazhohemi për sundim të ligjit, luftim të korrupsionit në gjykata. Konsideroj se kjo do të mbetet vetëm një dëshirë, sepse vështirë do të realizohen këto synime me 18.000.000 të ndara për Ministrinë e Drejtësisë.

Si do të kërkohet efikasitet dhe përgjegjësi në gjykata, kur gjykatësi dhe prokurori me të ardhurat mujore mund të realizojë vetëm një javë jetë të dinjitetshme.

Sugjerimi im tjetër është që, në procedim të mëtejshëm të këtij projektbuxheti, të shtohen investimet në projektet zhvillimore në bujqësi, që të mbështetet ekonomia rurale, që të lëvizet nga produktiviteti joefikas nga sektori më produktiv i orientuar drejt ekonomisë së tregut.

Pasqyrat tabelare të projektbuxhetit tregojnë për selektime ekstreme në mes të komunave. Kërkojmë shpërndarje më proporcionale të realizimit të projekteve nëpër komuna.

Me këtë rast, po e potencoj Prishtinën, si kryeqendër, ku Ministria për Ekonomi dhe Financa e ka zvogëluar fondin për mallra e shërbime për 10%. Me të cilat mjete do të mirëmbahen rrugët në kryeqendër dhe mirëmbajtja teknike e institucioneve arsimore. Prandaj, kërkoj që të hartohet dhe të procedohet ligji për Prishtinën, të rregullohet statusi i tij dhe të mundësohet një grand buxhetor në mënyrë që të zhvillohet Prishtina dhe të bëhet krenari e të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Në fund, kërkoj që gjatë procedimit të mëtejshëm të projektbuxhetit në komisione, të synohet një ndarje më e drejtë dhe nga ministrinë një jetësim më i drejtë i mjeteve dhe i të hyrave buxhetore.

Projektbuxhetin e përkrah me ndryshimet e mundshme dhe reale në mënyrë që Qeveria e Kosovës të realizojë projekte për një jetë më të mirë, për një të ardhme më të mirë për qytetarët e Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Shkumbin Demalijaj, le të përgatitet Njomëza Emini.

SHKUMBIN DEMALIJAJ: I nderuari zoti Kryetar!

Zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,

Kolegë të nderuar deputetë,

Po mundohem që të jem sa më i shkurtër dhe të mos i përsëris ato që u thanë deri më tash për mundësinë e kapërcimit sa më të shpejtë për t'ua mundësuar të marrin fjalën edhe tjerët, meqenëse Kryetari është i disponuar ta kryejmë sonte debatin.

Edhe pse me vonesë të afatit ligjor kohor, neve kemi marrë projektligjin për buxhetin 2009, dihet, fundi i tetorit është ai që duhet të përcaktohet dhe për vonesa nuk parashihet gjë e madhe te ne. Një projektbuxhet i improvizuar, që nuk i përgjigjet aspak hartimit të një projekti profesional, por shkronja dhe numra, sa për të përmbyllur një kaptinë brenda një kornize të lejuar. Flasim për një diçka që Kryeministri e tha në fillim se është buxheti i parë i Qeverisë së pavarësisë. Pavarësia e Kosovës nuk është e Qeverisë, por ky Kuvend e ka shpallur pavarësinë e Kosovës dhe shumë prej ministrave që nuk kanë qenë deputetë, nuk janë të nënshkruar në atë listë, duhet të dinë dhe t'i respektojnë vendimet e Kuvendit që i ka ndërmarrë.

KRYETARI: Përmbaju rendit të ditës!

SHKUMBIN DEMALIJA: Po fillojmë me buxhetin dhe po mundohem të shkoqis diçka prej atyre çka na kanë ofruar, sepse kishim dy herë raport dhe komente rreth këtij projektbuxheti, edhe nga Kryeministri, edhe nga ministri i Financave. Nuk është buxhet i parë ky. Ne brenda kësaj legjislature që dy herë shqyrtojmë buxhet dhe kemi aprovuar projektligj për buxhet, e në qoftë se nuk e kam mirë, le t'më tregojë ministri, sepse ne kemi pasur Projektligjin për buxhet, në emër të transparencës e ka ofruar për ndryshime dhe plotësime ministri herën e kaluar, gjatë këtij viti buxhetor.

Po ndalem te Kuvendi. Pas shpalljes së pavarësisë dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, shumë agjenci, komisione, zyra rregullatore, borde të ndryshme që kanë qenë në kompetencë të UNMIK-ut, kaluan dhe janë kompetenca të Kuvendit. Komisioni për Buxhet e Financa – komisioni parlamentar, është gjendur shumë duarkryq përballë kërkesave buxhetore të këtyre agjencive për shkak se Kosovës, në kuadër të legjislacionit të saj i mungojnë ligjet bazë dhe ligji më bazik, kur flasim për paga dhe mëditje, Kosova nuk ka ligji mbi pagat dhe ne nuk dimë si të përcaktojmë pagën e shërbyesve civilë. Në këtë rast edhe nuk dimë cilët janë shërbyes civilë, sepse Kosova nuk e ka edhe Ligjin për shërbimin civil, as Ligjin për krijimin e marrëdhënies së punës apo themelimin e marrëdhënies së punës. Funksionon me disa rregullore të ndrydhura nga sirtarët e UNMIK-ut dhe krijojmë buxhet pa ditur t'i menaxhojmë ato. Dhe krejt, thënë kushtimisht, kjo Qeveri s'ka ligj mbi funksionimin e vet. Qeveria e Kosovës nuk e ka Ligjin mbi funksionimin e qeverisë dhe funksionon me një rregullore të UNMIK-ut 2001/19, a cila është ajo.

Ju kisha lutur, të nderuar deputetë, t'i shikoni prioritetet e Qeverisë brenda kësaj kornize buxhetore. E privilegjuar edhe këtë vit do të jetë Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, me afër 116 milion euro buxhet. I kisha dëshiruar Qeverisë që brenda kësaj të llogaritë sa kushtojnë 110.000 kilometra katror asfalt dhe le ta shtrojë Kosovën në asfalt përnjëherë, sepse ka mbetur me gërshërë në dorë.

E fundit si prioritet për këtë Qeveri, është shëndetësia. Në qoftë se nuk besoni, shikojeni faqen 7, sa është e mundshme për këtë Qeveri t'i hartojë në këtë formë këto prioritetet.

Siguria. Dy ministrinë, ajo e FSK-së dhe ajo e Rendit, ku Ministria e FSK-së ka 20 milionë euro për këtë vit buxhetor dhe ajo e Rendit 19 milionë për shpenzime kapitale, 950.000 euro kanë blerë qenë për këtë vit buxhetor dhe buxheti i këtyre dy ministrive është 1 eventualisht 2% më i madh se i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, e cila ka për ta shitur edhe një pjesë të pasurisë së Kosovës dhe mund të flasim para qytetarëve të Kosovës se me këtë buxhet ne do të prodhojmë siguri për qytetarët e vendit dhe për këto

pajisje që ka sot policia. Vetëm duke iu falënderuar vullnetit që po bën maksimum policia e Kosovës në këtë rast, është marramendëse t'iu dalësh vandalizmave, sidomos në veri të Kosovës, ku ka kriminelë të armatosur deri në dhëmb dhe, dihet, ditëve të fundit pati edhe breshëri automatike mbi qytetarët e Kosovës që punonin në shpi të tyre. Askush dhe askund nuk ka ndonjë pozicion buxhetor ku shkruan për mundësinë e blerjes së paku të 50 autoblanda dhe të pajiset policia e Kosovës, sepse ne ende presim prej KFOR-it dhe bashkësisë ndërkombëtare që të na krijojë sigurinë dhe nuk do të mësohemi asnjëherë të sillemi si shtet.

Si qytetar i Kosovës, përkundër dëshirës së madhe për krijimin e Forcës së Sigurisë, kemi menduar se në këtë vit, bile në vitin 2009, ne do ta përmbyllim këtë me këtë sukses dhe shihet se numerikisht, me gjithë punëtorët e Ministrisë, nuk arrihet numri i përgjithshëm as i Forcës së Sigurisë, që bashkë me ministrinë edhe administratën e kësaj ministrie, i kemi 1.900 të punësuar në këtë ministri.

Mundësia e dobët e kësaj Qeverie për t'u përballur me probleme, që vetes ia ka krijuar me premtime të mëdha dhe mundësitë aq të vogla menaxheriale që ka. Kjo është ajo mundësi. Meqenëse morëm shembull resorët e sigurisë, të nderuar deputetë dhe qytetarë, që tani nuk po na ndiqni, sepse ka përfunduar koha, Korporata Energjetike e Kosovës edhe këtë vit do t'ia marrë këtij buxheti 85 milionë euro që do t'i gëlltisë dinozauri që askush nuk e di çka bëhet në këtë kompani publike, ndoshta Qeveria po, sepse ka parë të arsyeshme t'i privatizojë disa komplekse të saj menaxhuese e qytetarëve iu mbetet të ndiejnë kënaqësinë me cilësinë e shërbimeve dhe të furnizimit që ofron KEK-u ynë i famshëm.

Është tmerr të shikohet resori i bujqësisë. Në këtë vit buxhetor lidhur me stimulimet që ka paraparë Qeveria për bujqit tanë, në resorin më të rëndësishëm që ka Kosova dhe mbulon pothuaj se të gjitha nevojat qytetare të Kosovës lidhur me ushqimin dhe produktivitetin tjetër që lidhet me Departamentin e Bimëve dhe atë të Blegtorisë, për bujqësinë vetëm 3.800.000 euro, nuk janë 7 milion shpenzime kapitale, sepse aty përfshihen edhe resorët e tjerë, për bujqësinë janë këto, duke përfshirë edhe Institutin e Bujqësisë.

Ndërkaq, për nevoja të tjera, ka vetëm një emër e një përgjigje, e ai është – importi.

Po mundohem ta rrumbullakoj fjalën time, të nderuar deputetë, duke ju drejtuar që të mos e votoni këtë buxhet, por të kthehet mbrapa, sepse këtu nuk e gjeni vetën as ju, as familjarët tuaj dhe asnjë nga qytetarët e Kosovës, por kjo është vetëm një dëshirë e Qeverisë të kryejë këtë obligim vjetor, sepse ky buxhet është shumë politik. Duke iu referuar të dhënave në këtë projektbuxhet, si përfitues më të mëdhenj nëpër lokalitetet tona do të përfitojnë nga grandet qendrore më së shumti vetëm komunat që udhëhiqen nga PDK-ja.

Paga të rritura dhe nivelizim të tyre nuk ka. Ka qenë vetëm një retorikë e bukur e përfaqësuesve të Qeverisë për rritje pagash, por në këtë vit buxhetor nuk ka. Pensionet nuk do të rriten. Qasje në Trustin Pensional nuk do kemi, as nuk parashihet brenda kësaj kornize buxhetore, edhe pse ka qenë premtim i qeverisë se këto mjete do t'ia kthejë buxhetit të Kosovës, por do të ketë përveç shpenzime të atij trusti për menaxhimin e humbjeve të tij. Mjetet e privatizimit nuk do të jenë pjesë e këtij buxheti, as nuk figurojnë se ekzistojnë diku brenda kësaj kornize të këtij projektbuxheti. S'do të ketë as në këtë vit buxhetor asnjë institut apo agjenci shtetërore që do të përcjellë në mënyrë permanente

gjendjen ekonomike në vend dhe të tregojë se në çfarë stadi zhvillimor ka arritur Kosova, por do t'i shiten këto shërbime edhe këtë vit ndonjë instituti privat dhe ai do t'i tregojë rritjet ekonomike vjetore dhe tjetri institut, që nuk ka përfituar, do të tregojë ndryshe këto të dhëna dhe prapë, në vitin e ardhshëm do të mbesim pa të dhëna zyrtare dhe reale për rritjen ekonomike që ka pasur Kosova. Ne patëm këtu edhe një diskrepancë shumë të lartë në mes asaj çka tha Kryeministri për një rritje për 15% dhe asaj çka tha ministri i Financave 6%.

Gjykatën Kushtetuese, shpresojmë se do ta kemi nga mesi i vitit të ardhshëm, sepse e kemi përcaktuar stafin 55 punëtorësh, të përcaktuar me këtë projektbuxhet, sepse kjo Qeveri ka të drejtë ta përcaktojë edhe numrin e stafit dhe sasinë buxhetore, edhe organogramin e një segmenti të pavarur ende të pa themeluar, sepse më herët nuk mundemi, meqë nuk kemi mundësi tjera, sepse nuk duhet askush t'i pengojë shkeljet kushtetuese që bëhen në Kosovë.

Shpenzime kapitale janë 13.040.300 euro për tërë Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Shërbimin diplomatik. Do të thotë, diplomatët tanë do të rrinë te të afërmit e tyre, atje ku janë vendosur zyrat diplomatike, edhe këtë vit.

Ndërkaq, për një çështje, që sot opozitën nuk e dëgjova duke folur, është për Komisionin Qendror Zgjedhor. Janë ndarë vetëm ...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit! E harxhove kohën. Fjalën e ka deputetja Njomëza Emini, le të përgatitet Drita Maliqi.

NJOMZA EMINI: I nderuari Kryetar,

I nderuari zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar dhe ju kolegë deputetë,

Më në fund, po më vjen mirë që po diskutohet për çështjen e rinisë edhe prej disa deputetëve të tjerë, që deri më tani në legjislaturat e kaluara nuk janë marrë edhe aq sa duhet. Për fat të mirë, në këtë projektbuxhet, edhe pse është një shumë jo e madhe, po të paktën është bërë një lëvizje, edhe pse nuk është e kënaqshme, nuk është e lakmueshme, duke ditur se një pjesë e madhe është popullsia e re, që janë të gjeneratës së re, por lëvizje ka, duke pasur parasysh se qeveritë paraprake nuk kanë bërë asgjë dhe janë thirrur në emër të rinisë, rinia e tashmja, rinia e ardhmja, por asgjë konkrete, jo. Domethënë, në këtë aspekt, unë e shoh një lëvizje pozitive, por normalisht që nevojitet edhe buxhet tjetër apo rezerva të tjera.

Në buxhetin e vitit 2009 është përfshirë edhe rezerva financiare, që në raste të jashtëzakonshme kjo e frynë buxhetin për 200 milionë euro dhe, po të mos ishte kjo, buxheti real për 2009 do të duhej të ishte 1.2 miliard e jo ashtu siç është paraqitur 1.4 miliard.

Nëse shikohet raporti për shpenzimin e buxhetit për 9 muajt e vitit 2008, shihet se të gjitha organizatat buxhetore në Kosovë do të kenë suficit. Sidomos brengosëse është edhe fakti se buxheti për investime kapitale nuk e kalon 50%-shin e shpenzimeve në asnjë ministri dhe njësoj edhe komunat tjera.

Tjetër çka është brengosëse për komunat, është edhe ajo që nuk janë ndarë grande të mjaftueshme, do të thotë ka pasur dallime, duke pasur parasysh edhe komunën e Prishtinës, që ka një popullatë më të madhe dhe mendoj që është dashur të bëhet një grand, një shumë më e madhe sesa komunat e tjera.

Tek sporti, janë ndarë mjete, por jo edhe aq sa ka pasur nevojë të bëhet.

Vlen të theksohet se me Draftbuxhetin për vitin 2009 janë ndarë mjetet edhe për komunat e reja, që janë të parapara me pakon e Ahtisarit, edhe pse nuk dihet se kur do të funksionojnë ato dhe ato mjete ku do të destinohen, që është një pikëpyetje e madhe.

Në fund, u shterën të gjitha këto prej diskutuesve që folën edhe më herët, por mendoj që Qeveria duhet të dijë mirë t'i implementojë këto dhe të bëjë një planifikim për monitorimin e buxhetit dhe të projekteve që vijnë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete për fjalën e shkurtër dhe konkrete! Fjalën e ka deputetja Drita Maliqi, le të përgatitet Fatmire Berisha.

DRITA MALIQI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëndetje për të gjithë!

Edhe unë do të jam sa më e shkurtër. Nga i gjithë materiali që na ka ardhur për Projektbuxhetin për vitin 2009, për analizë kam marrë komunën e Gjilanit. Ndoshta do të pyetni pse, por po e shoh se po menaxhohet në mënyrë lokaliste, andaj edhe unë thashë kësaj radhe, meqë është herë e parë, të flas për lokalitetin tim pak se si është bërë ndarja e buxhetit për këtë komunë.

Kam marrë dy elemente krahasuese të grandit nga Qeveria. Si element i parë kam bërë krahasimin sa është ndarja e grandit komunal për një punëtor në shërbimin civil dhe kam parë se komunës së Gjilanit i janë ndarë për një punëtor 4.259 euro, krahasuar me Prizrenin në total që janë ndarë 4.138.000 euro, në krahasim me Gllgovcin prapë Gjilani ka më pak mjete për 1.277.000 euro, në krahasim me Malishevën 1.040.000 euro më pak, me Ferizajn 1.643.000 euro dhe me Pejën 1.168.000 euro.

Element tjetër i krahasuar, janë të hyrat vetjake të komunave, të paraqitura në projektbuxhet. Për komunën e Gjilanit, për investime ndahen 46% grand plotësues; për investime në të hyrat vetanake Prizrenit i ndahet grandit 149% më tepër se të hyrat vetanake; Gllgovcit 244%; Malishevës 162%, Ferizajt 105% dhe Pejës 107%. Ndarja e këtij grandit në këtë mënyrë ka ndikuar që investimet kapitale në komunën e Gjilanit të jenë 24% në strukturën e buxhetit komunal, ndërsa në Prizreni investimet kapitale në strukturë marrin pjesë 44%, në Ferizaj 30%, në Pejë 31%.

Kërkoj të rishikohet edhe njëherë Projektbuxheti me kusht që të përfitojë komuna e Gjilanit si dhe komunat e tjera të cilat i ceka më lartë, sepse nga kjo ndarje komuna e Gjilanit është dëmtuar në buxhetin e vitit 2009. Faleminderit shumë, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit deputete për fjalën e shkurtër dhe konkrete. Fjalën e ka Fatmire Berisha, le të përgatitet Suzan Novobrdaliu.

FATMIRE BERISHA: Faleminderit, i nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës!

I nderuari zëvendëskryeministër, ministra të Kabinetit qeverisës,
Deputetë të nderuar,

Në dokumentin për buxhetin e vitit 2009 janë radhitur 4 prioritete të Qeverisë: rritja ekonomike; implementimi i statusit; qeverisja e mirë, zbutja e varfërisë dhe stabiliteti social, të cilat në vete ngërthejnë fusha specifike të prioriteteve të domosdoshme për integrimin e shtetit tonë në Bashkësinë Evropiane, por edhe për një zhvillim ekonomik në pajtim me kërkesat për integrim.

Një fushë specifike është edhe ajo e arsimit, e cila radhitet në kreun III, në Strategjitë sektoriale.

Më tej, potencohet misioni i këtij sektori, përshkrimi i gjendjes, synimi dhe shpenzimet për vitin 2009, për të arritur në tabelën 3.15 – Financimi i projekteve brenda sektorit, ku figuron edhe ndërtimi i një objekti shkollor në lagjen Kodra e minatorëve, për të cilën janë ndarë 35.000 euro. Sa për informim, në këtë lagje që nga viti 1999-2000, punojnë si paralele e ndarë e shkollës fillore “Hivzi Sylejmani” nxënësit dhe mësimdhënësit në klasë të kombinuara nga klasa I deri në klasën IX me 30 nxënës dhe 12 mësimdhënëse, të cilët çdo ditë barten nga njëra pjesë në tjetrën të qytetit të Mitrovicës. Banorët e kësaj lagjeje, po edhe të lagjeve të cilat natyrshëm lidhen në pjesën e qytetit të Mitrovicës që shtrihet mbi urën e Ibrit, kanë shpresuar dhe shpresojnë në një investim më të qëndrueshëm dhe më serioz që lidhet me një objekt shkollor në këtë lagje, me të cilin do të përmbusheshin edhe nevojat e banorëve të lagjes Kroji i Vitakut dhe të lagjes “7 shtatori”, duke mos e përjashtuar edhe atë pjesën më urbane të qytetit të Mitrovicës, mbi urën e lumit Ibër. Mendoj se këtu është e mundshme një ndërhyrje, sepse është shumë e rëndësishme dhe shumë domethënëse, prapë po them, për banorët e qytetit të Mitrovicës.

Një interesim i imi tjetër lidhet, po ashtu, me prioritetin që ka të bëjë me zbutjen e varfërisë dhe stabilitetin social. Në komunën e Mitrovicës, e një gjë e tillë ndodhë edhe me Gjilanin dhe me Skenderajin, e ndoshta edhe me ndonjë komunë tjetër, që disa vite po ngrihen objekte të banimit social. Mendoj se objektet e tilla në një të ardhme jo të largët do të vlerësohen si të tejkaluara nga se ato ngulfasin dhe mbyllin brenda vetvetes probleme të cilat shumë më lehtë do të përballtoheshin me një integrim të natyrshëm të qytetarëve pa ua prishur shumë qetësinë të tjerëve që nuk i rëndojnë problemet e kësaj natyre. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Fjalën e ka deputetja Suzan Novobrdaliu dhe le të përgatitet Vezira Emrush.

SUZAN NOVOBRDALIU: Faleminderit, Kryetar!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar dhe shumë të respektuar kolegë deputetë,

Pa i përsëritur fjalët e parafolësve të mi, dëshiroj të ndalem vetëm në disa pika.

Raporti i Komisionit Evropian, fatkeqësisht, Kosovën e cilëson si vend të korrupsionit dhe të krimit të organizuar. Projektbuxheti nuk i përmban masat të cilat do t'i ndërmarrë për luftimin e këtyre dukurive negative.

Sistemit të drejtësisë, si instrument kryesor për luftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit, nuk i kushtohet rëndësia të cilën e meriton dhe i cili tani është para kolapsit. Sot, kur flasim për këtë projektbuxhet, punëtorët e Judikaturës janë në grevë për rritje

pagash dhe të pagesës së shujtës. Këto kërkesa, në këtë projektbuxhet nuk po gjejnë zgjidhje.

Qeveria e Kosovës, fatkeqësisht, për zgjidhjen e problemeve në sektorë të ndryshëm angazhohet vetëm pas presioneve të drejta sindikale. Numri i vogël i prokurorëve, gjyqtarëve dhe stafit mbështetës është vlerësuar si shkak për mosluftimin e krimit të organizuar dhe të korrupsionit. Kjo është vlerësuar nga të gjitha raportet ndërkombëtare. Ky projektbuxhet nuk bën zgjidhjen e këtij problemi që është bërë kancer për shoqërinë kosovare.

Konsideroj se mbështetja buxhetore për Agjencionin Kundër Korrupsionit është e vogël. Gjithashtu, mosrritja apo rritja minimale e pagave për policinë, gjyqësinë, prokurorinë duhet të jenë prioritet për Qeverinë e Kosovës.

Ky projektbuxhet, që u tha edhe më herët, ka një numër të madh të defekteve. Më lejoni të theksoj rastin e qytetit mesjetar të Novobërdës, ose të Artanës. Ky vend, edhe pse vizitohet nga shumë turistë vendorë dhe të huaj, ende nuk po hyn në prioritetet e Qeverisë së Kosovës. Parashihet renovimi i Kalasë së Novobërdës, gjersa që të shkohet te Kalaja e Novobërdës nuk ka rrugë, e cila rrugë është vetëm 2 kilometra. Ndriçimi dhe sinjalistika orientuese nuk kërkojnë shuma të mëdha buxhetore, por ka mungesë të ideve kreative dhe të planifikimit të mirë.

Këtë projektbuxhet, si të tillë, nuk do ta përkrah. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Heset Cakolli, le të përgatitet Rita Hajzeraj.

HESET CAKOLLI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të respektuar kolegë deputetë,

Me Projektligjin qeveritar, të hyrat totale buxhetore të projektuara për vitin fiskal 2009 janë paraparë të jenë rreth 956 milionë euro, ndërsa totali i shpenzimeve publike është paraparë të jetë 1.094.300.000 euro. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës ka planifikuar një diferencë në vlerë diku prej 138 milionë eurove në mes të të hyrave të përgjithshme dhe shpenzimeve publike, e unë mendoj se kjo diferencë është mjaft e madhe.

Diferenca prej 68 milionë euro paraqet të hyra më shumë për vitin 2009 krahasuar me vitin 2008, mirëpo kjo shumë nuk mjafton për t'i plotësuar nevojat e shumta që ka shteti i ri i Kosovës.

Me këtë buxhet Qeveria ka paraparë një rritje prej 12.5% në sektorin social dhe një rritje prej 10% për të gjithë shërbyesit civilë dhe unë mendoj se këto rritje nuk janë të mjaftueshme nëse kemi parasysh ngritjen e çmimeve vetëm në vitin e kaluar.

Edhe në vitin fiskal 2009 mjetet e ndara në sektorin e shëndetësisë, të arsimit dhe të bujqësisë nuk garantojnë se do të kenë përmirësime të cilat ne i dëshirojmë të gjithë.

Nëse i referohemi kodit organizativ 208 të Projektligjit të datës 02.02.2008 dhe kodit organizativ 242 të Projektligjit të vitit 2009, shihet se Universitetit të Prishtinës i janë

ndarë më pak mjete në shumën prej 636.722 euro. Shpesh kritikohet Universiteti publik se nuk po merret me punë hulumtuese e shkencore, por unë mendoj se duhet të krijohen fonde të veçanta të cilat kishin për ta mbështetur financiarisht këtë fushë shumë të rëndësishme për të ardhmen e vendit.

Punëtorët e Universitetit shpesh nuk mund të marrin pjesë edhe në konferenca me pjesëmarrje ndërkombëtare për mungesë të mjeteve financiare. Ekziston një fond i kufizuar i cili mbështet shpesh edhe participimet e punimeve në konferenca, por nuk mjafton për t'i përmbushur të gjitha kërkesat e punëtorëve të Universitetit.

Edhe në vitin fiskal 2009, KEK-u do të marrë një shumë të madhe të mjeteve, diku rreth 124.5 milionë euro nga buxheti i Kosovës, për tri qëllime kryesore:

1. 80 milionë euro në formë kredie për projektin e minierës së Sibovcit;
2. 40 milion euro për import të rrymës, dhe
3. 4.5 milion për t'i ndihmuar të varfrit, që paraqet diku një shumë rreth 13% nga të hyrat e përgjithshme dhe mendoj se kjo është shumë e madhe për buxhetin e vogël të Kosovës.

Mungesa e energjisë elektrike është pengesa kryesore e zhvillimit ekonomik të vendit dhe me këtë gjendje energjetike në të cilën ndodhet sot Kosova, nuk duhet të ushqehemi me iluzione se do të ketë investitorë të gatshëm që të investojnë në Kosovë.

Edhe sektori i bujqësisë është një sektor shumë i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendit dhe zvogëlimin e numrit të papunëve, ndërsa me këtë projektligj nuk janë paraparë ndarje të mjeteve për subvencione të bujqësisë dhe nëse iu referohemi të dhënave nga shtetet e regjionit se sa mjete ndajnë për sektorin e bujqësisë, atëherë është e qartë se bujqësia në Kosovë nuk mund të jetë konkurrencte në tregun e lirë edhe pse prodhimet vendore janë shumë cilësore.

Unë jam i vetëdijshëm për nevojat e shumta që ka shteti i ri i Kosovës dhe mundësitë që ofron ky buxhet i vogël i Kosovës për t'i përmbushur të gjitha kërkesat, por Qeveria e Kosovës duhet të marrë vendime të sigurt dhe të shpejta për ta përmirësuar gjendjen energjetike ekzistuese dhe ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të rrymës, si dhe të krijojë politika joshëse për investitorë të jashtëm dhe vendorë me qëllim që të fillohet një zhvillim ekonomik i mbarë i Kosovës dhe përmirësimi i gjendjes së qytetarëve në përgjithësi. Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Ritë Hajzeraj. Armend, a e deshe fjalën ti? Më duket, u tërhoqe një herë. Mirë!

RITA HAJZERAJ: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje për të gjithë!

Unë, si deputete e Parlamentit të Kosovës, me të vërtetë shqetësohem nga fakti pse shëndetësia kosovare prapëseprapë nuk është një ndër prioritetet e Qeverisë në hartimin e këtij projektbuxheti të vitit 2009. Në vend se në këtë projektbuxhet shëndetësia të jetë një ndër prioritetet, duke pasur parasysh gjendjen aktuale në të cilën gjendet, prapëseprapë neglizhohet në masë të madhe.

Unë nuk do të zgjas shumë, por e kam një pyetje konkrete për ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, pasi që kam vërejtur në Projektbuxhetin e vitit 2009 që versioni shqip i këtij projektbuxheti ndryshon nga versioni anglisht, e sidomos e kam fjalën te Ministria e Drejtësisë. Aty, jo vetëm se ndoshta është gabim teknik, por ka edhe gabime substanciale.

Kisha dashur ta pyes ministrin se për leximin e dytë cili version do të merret parasysh, versioni në gjuhën shqipe apo versioni në gjuhën angleze? Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend Zemaj, e ka fjalën, le të përgatitet Flora Brovina. Ju të pozitës do të ishte mirë të hiqni dorë nga diskutimi dhe atë ta dorëzoni me shkrim.

ARMEND ZEMAJ: Tash, na e imponove, zotëri Kryetar! Përshëndetje!

Edhe ashtu, e pata ndërmend, pasi u fol për shumëçka për politikën tatimore, për energji, buxhet të komunave, për fushën, male, për barela naftë, drithë, prandaj edhe ashtu s'më mbeti shumë për çka të bisedoj, pos për t'iu bashkëngjitur fjalëve, nëse s'ma merr për plagjiaturë, kolegu Esat Brajshori, për gjithë atë që e tha për buxhetin për rininë, sidomos për kulturën. Me të vërtetë është vërejtje, janë pesë palestra sportive, ndahen. Nuk e di ku është ministri dhe s'di a ka sot takim më të rëndësishëm se sa për buxhetin dhe pse nuk është i pranishëm. Por, të figurojnë 5 palestra sportive dhe të mos jetë këtu asnjë cent për vitin 2009, nuk e di si do ta arsyetojë ai dhe Qeveria.

Për mos t'iu mbetur peng fjalëve të mia, edhe ashtu Luta ka thënë ta votojmë..., kështu nuk po e zgjas më shumë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, prej të dyve! Fjalën e ka deputetja Florë Brovina, le të përgatitet Nurishahe Hulaj.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Sot po diskutojmë për buxhetin e parë gjithëpërfshirës të Qeverisë së Republikës së Kosovës, që është buxheti i përpjekjeve për t'ia dalë mbanë në një kohë shumë të vështirë pas një zhvillimi të pamjaftueshëm ekonomik dhe mungesës së investimeve, të papunësisë së madhe dhe të varfërisë më të lartë në Evropë, në një kohë të krizës globale, të paraparë që mund të ndikojë dhe reflektojë edhe në vendin tonë.

Është herë e parë që buxheti hartohet nga vetë ekspertët tanë dhe kjo hapë perspektivën e realizimit të programit qeveritar dhe të prioritetëve që ajo i parasheh dhe që janë premtuar: infrastrukturës, energjetikës, arsimit.

Buxheti shënon një rritje, por kjo rritje është brenda mundësive tona. Është një rritje e vogël karshi nevojave shumë të mëdha që ka shoqëria jonë e dalë nga lufta, në tranzicion dhe pa investime ekonomike.

Spektori më i ndjeshëm në çdo shoqëri, pra edhe në shoqërinë tonë, është padysim, dhe për një kohë të gjatë do të mbetet, mirëqenia sociale dhe punësimi. Ajo merr një pjesë të konsiderueshme të buxhetit, por ka shumë probleme të pazgjidhura. Shtimi i buxhetit në këtë lëmi 1.4% është shumë pak, aq më tepër kur përqindja e varfërisë së skajshme është në rritje 16%. Edhe numri i njerëzve të papunë është gjithashtu në rritje. Numri i vendeve të punës nuk është në proporcion me kërkesat e punës, në tregun e punës. Pensionet bazike do të rriten 5 euro dhe me këtë a do të zgjidhen problemet e pensionistëve dhe çka me ata që nuk i kanë vitet e pensioneve dhe kanë humbur vendet e punës. A është kjo

kategoria më e atakuar në numrin e të varfërve dhe hyn në përqindjen e varfërisë së skajshme.

Çka me Ligjin pensional? Nuk e kam të qartë se sa përqind do të zbatohet Ligji për veteranët e luftës, ligj që nuk zbatohet qind për qind. Çka nënkuptohet konkretisht kur flitet për programet për fëmijët jetimë. Ne nuk kemi mbrojtje adekuate të fëmijëve, sidomos kur flasim për fëmijët e varfër, sepse dihet që s'ka shtesa të fëmijëve, s'ka çerdhe sociale dhe kopshte. Megjithatë, shoqëria i kushtoi shumë rëndësi infrastrukturës shkollore dhe impresionon lista e shkollave në ndërtim dhe e atyre që do të ndërtohen. Kjo hapë perspektivë jo vetëm për fëmijët tanë, por edhe për tërë shoqërinë.

Ngritja e pagave në arsim brenda mundësive ekzistuese nuk është vetëm një gjest, por synim i ngritjes së moralit dhe të kualitetit të mësimi. Është investim në edukim e dije, jo vetëm për rininë, por për tërë shoqërinë.

Përkushtimi në infrastrukturë, gjithashtu hap perspektivë në investime dhe në zhvillimin ekonomik. Për një vit pamë ndryshime të mëdha që nuk i kishim parë për shumë vite.

Shëndetësia. Është pika neuralgjike e secilës qeveri në vazhdim që patëm, madje edhe e kësaj qeverie. Me gjithë shtimin e buxhetit 14.5, ajo mbetet si e tillë edhe gjatë vitit 2009. Mjetet e ndara në buxhet nuk mjaftojnë për të dalë nga situata dhe për sanimin e gjendjes dhe të problemeve të grumbulluara prej vitit në vit. Në këtë sektor të shtrenjtë për çdo shoqëri ka edhe pengesa të tjera, si menaxhimi i mangët, mungesa legjislative, etike, por edhe vizioni i politikës shëndetësore për një kohë më të gjatë. Çka me fondin shëndetësor. Formimi i fondit kërkon kohë. Ai duhet të themelohet që të jetë efikas pas sa viteve. Ai kërkon kuadro të specializuara dhe pyetja ime është: a kemi nisur t'i përgatisim këto kuadro.

Bujqësia. U tha se është sektor i perspektivës, që mund të hapë shumë vende të punës, por a ka program konkret, kur dihet se 60% e popullatës jeton në pjesët rurale.

Sa ka ndarë mjete Ministria e Bujqësisë për realizimin e Deklaratës së Mijëvjeçarit? A mund dhe kur do të fillojmë të sigurojmë bukën tonë? Cila është përkrahja dhe stimulimi i prodhuesve tanë? Sa do të ndahen subvencione dhe a do të mbrohen prodhimet vendore. Pasja e një programi nacional dhe nxitja e zhvillimit në bujqësi dhe mbrojtja e produkteve vendore nuk është nacionalizëm ekonomik, por kulturë nacionale, kulturë e zhvillimit, në rend të parë, dhe kontribut për zhvillim. Vërejtjet e mia në veçanti janë për Ministrinë e Kulturës, ku nuk shoh një planifikim logjik. Planifikohen ndërtime të objekteve që përfshijnë edhe gjysmën e buxhetit në kohën kur objektet e kulturës që ekzistojnë nuk mund të ekzistojnë me mjete të ndara. Domethënë, është në pyetje ekzistenca e tyre. Këto ishin vetëm disa vërejtje dhe kontributi im lidhur me buxhetin, duke theksuar se do ta votoj për buxhetin, natyrisht.

KRYETARI: Faleminderit! Kisha kërkuar që këta deputetët, që kanë mbetur dhe janë të pozitës, t'i reduktojnë, t'i shkurtojnë ose t'i dorëzojnë diskutimet me shkrim. Fjalën e ka deputetja Nurishahe Hulaj, le të përgatitet Kaqusha Jashari.

NURISHAHE HULAJ: Faleminderit, Kryetar i Kuvendit!
E nderuar Qeveri, Kryeministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar deputetë,

Në Kornizën afatmesme buxhetore 2009-2011 paraqiten prioritetet e Qeverisë së Kosovës që unë personalisht i përkrah dhe do ta votoj. Mirëpo, konsideroj se në këto katër shtylla të prioriteteve të Qeverisë është shumë prioritare të futet Ministria e Kulturës, do të thotë, rinia, kur dihet se 60% janë nën moshën 30 vjeçare dhe kur dihet se 22 deri 23 është moshë mesatare në Kosovë, do të thotë e ka arsyeshmërinë, e ka domosdoshmërinë dhe është një segment shumë i rëndësishëm që kërkon përkrahje qeveritare.

Sigurisht, është e rëndësishme edhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, që duhet të jetë në këto katër shtylla, duke ditur se 50% të rasteve të sëmundjeve ngjitëse paraqiten si pasojë e kontaminimit të ujit dhe ushqimit dhe është një mjedis, konsideroj, ende i ndotur në Kosovë, ende nuk kemi ujë cilësor të pijes. Mund të them se kemi ujë të pijes higjenik, por kemi edhe një ushqim të pakontrolluar. Në anën tjetër, do ta kemi edhe Ligjin për ushqimin, për çka do të krijohet Agjencioni për nënmbikëqyrje qeveritare për ushqimin, i cili nuk është paraparë edhe në linjën buxhetore.

Kërkoj edhe një sqarim. Ne kemi dy dokumente për Spitalin regjional të Prizrenit, meqenëse jam nga Prizreni. Dokumenti që është dorëzuar nga Ministria e Shëndetësisë më 28.10.2008 kap vlerën për Spitalin rajonal të Prizrenit në buxhetin e vitit 2009 në shumën prej 3.768.000 euro, ndërsa në kornizën që kemi ne para veti është e kundërta, do të thotë 3.768 është në kornizë, kurse e Prizrenit që është paraparë në draft dhe është dhënë nga Ministria e Shëndetësisë është 3.000.800 euro. Cila është e vërteta këtu, do të thotë, 100.000 euro është mungesë në buxhet Spitali regjional i Prizrenit, kur dihet se 500.000 banorë gravitojnë në atë rajon.

Një kërkesë dhe një sqarim tjetër e kërkoj. Është thënë dhe janë zotuar institucionet tona, përkatësisht Ministria e Shëndetësisë, se 44 euro do të jenë për personelin shëndetësor për muajt tetor, nëntor, dhjetor 2008 dhe ende ato nuk i ka marrë asnjë personel shëndetësor, të cilat janë paraparë nga të hyrat vetanake, ndërsa është thënë se në janar të vitit 2009 kjo do të futet në përqindje në listën e pagave për personelin shëndetësor. Kur dihet se memorandumit nënshkruhet në mes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Financave diku pas muajit maj të vitit rrjedhës, kah do të vinë këto mjete në rritje të pagave të personelit shëndetësor prej janarit të vitit 2009? Kërkoj një sqarim këtu edhe prej të dy ministrave si do të rrjedhë kjo?

Është një shumë 888.000 euro për performancën në shëndetësi. Unë e kisha renditur këtë në dy grupe, sepse do të duhej të kemi performancë në mes organizatave shëndetësore buxhetore dhe performancë në mes të personelit shëndetësor. Do të thotë, kjo shumë nuk mjafton që të kemi vetëm në këtë segment për matjen e performancës në shëndetësi.

Është shumë me rëndësi rritja 10% e shërbyesve civilë. Ne ende nuk e kemi të qartë, sepse është thënë më parë se arsimi dhe shëndetësia – personeli do të hiqen prej shërbyesve civilë. Këtu është rritje 10%, tash a do të jetë këtu shëndetësia në këtë 10% apo do të jetë rritje tjetër, unë kërkoj sqarim këtu prej ministrave. Ju faleminderit! Do ta përkrah buxhetin dhe do ta votoj.

KRYETARI: Faleminderit! Po, sqarimet i lypni në komisione. Fjalën e ka deputetja Kaqusha Jashari, le të përgatitet Luljeta Shehu.

KAQUSHA JASHARI: I nderuar kryetar,
Kabineti qeveritar dhe kolegë deputetë,

Unë do ta shkurtoj diskutimin. Mendoj se buxheti i propozuar nga qeveria për vitin e ardhshëm është bazuar në mundësi reale, si për sigurimin e të hyrave, ashtu edhe për rritje, e cila është projektuar 6%, por me siguri kërkohet një punë serioze për ta realizuar.

Do të ndalem në sektorin social. Rritje prej 12.5% për të gjithë përfituesit e asistencës sociale dhe pensionistët, gjithashtu edhe 10% për ngritjen e pagave të shërbyesve civilë, janë pak se bazat janë të ulëta. Me siguri edhe pozita dhe opozita ishim pajtuar me mundësinë e rritjes, por sikur që dëgjuam kryeministrin dhe ministrin, ekzistojnë rekomandime të Fondit Monetar Ndërkombëtar lidhur me rregullat fiskale e gjithashtu edhe kufijtë e shpenzimeve publike rrjedhëse, por unë lidhur me këtë i kam disa propozime konkrete.

Mendoj se Qeveria duhet të intensifikojë atë çka e ka filluar, punën në hartimin e Letrës së Bardhë për politikën sociale, nën një.

Nën dy, mendoj se duhet të na procedojë Projektligjin për sigurimin pensional dhe invalidor dhe ky ligj nuk ka ardhur në rend dite, sa unë i kam informata, lidhur me propozimin për formimin e Fondit pensional dhe kjo nuk ka mundësi për shkak të këtyre kushteve të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Prandaj, unë mendoj se në këtë buxhet është mirë që është ndarë vija buxhetore për pensionet bazë, për pensione kontributdhënëse, për pensione tjera, prandaj me aprovimin e këtij ligji mendoj se na mund ta identifikojmë, të krijojmë hyrje të reja, si prej fondit të privatizimit, për pensionet e kontributdhënësve.

Le të jetë si një propozim edhe shqyrtimi, sepse jam konsultuar me njerëzit të cilët e njohin këtë lëmi.

Nën tre, mendoj se Qeveria ka bërë mirë edhe sivjet që ka orientuar prioritetin nga infrastruktura rrugore dhe nuk pajtohem me njerëzit që këtu po dalin me vlerësime të llojllojshme lidhur me ndërtimin e rrugëve dhe mjetet të cilat janë ndarë për ndërtim, sepse pos që të gjithë e dimë se janë rrugët kusht për zhvillimin ekonomik, mos ta përmendi edhe zvogëlimin e migracionit fshat-qetë, deri më tani nuk kemi bërë asnjëherë analizë sa ka ndikuar sivjet ndërtimi i rrugëve në rritjen e prodhimit të materialit ndërtimor, të industrisë së materialit ndërtimor, sa ka ndikuar në zhvillimin e firmave ndërtimore, e gjithashtu ka ndikuar edhe në zvogëlimin e papunësisë. Prandaj, ndikimet janë edhe tjera, jo vetëm se janë shumë banale do vlerësime për vota ose për poenë.

Prandaj, unë e përkrah këtë projektbuxhet me mundësinë, me siguri, të përmirësimit dhe të merrem parasysh vërejtjet e dhëna. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! I kemi edhe dy deputete. Luljeta Shehu dhe Edita Tahiri.

LULJETA SHEHU: I nderuari Kryetar,
I nderuari Kryeministër,
Të nderuar ministra,
Të nderuar deputetë,
Pasi parafolësit folën mjaft, desha ta cek edhe një çështje që është me rëndësi për një kategori të familjeve që s'u përmendën deri më tani.

Për të synuar një të ardhme më të mirë, duhet të ketë një buxhet i mjaftuar. Mirëpo, pasi që e ka kapluar kriza financiare krejt botën, e gjithashtu edhe Kosovën, mendoj se ky

buxhet nuk do të mund t'i plotësojë kërkesat e popullit sepse ekziston një papunësi e madhe.

Në këtë buxhet ekziston një rritje për pensionistët nga 5 euro, por kjo nuk mund t'i plotësojë kërkesat e tyre. Për familjet e peronave të pagjetur të cilët kanë pritur një rritje qysh prej vitit 2008, në këtë buxhet nuk parashihet rritje në krahasim se sa anëtar kanë humbur familjet. Këtë e ceka pasi që vetë jam anëtare e Komisionit për të Pagjeturit dhe jo rrallë nga kontaktet që kam pasur me qytetarët, shihet se është shqetësuese pozita e tyre financiare, sepse mbetet e dëshiruar të bëhet një ngritje më e lartë se 1,5% për asistencën sociale. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka Edita Tahiri.

EDITA TAHIRI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Përshëndetje kolegë,

E nderuar Qeveri,

Unë do ta jap fjalimin e plotë, por më lejoni shkurtimisht t'i them disa fjalë lidhur me Projektbuxhetin.

Plani për buxhetin është një ndër sfidat më të mëdha të vendimmarrjes së një qeverie. Një buxhet i planifikuar mirë është ai i cili i plotëson kriteret politike, menaxheriale, ekonomike dhe të llogaridhënies. Pra, një buxhet i cili ofron zgjidhje të drejta për nevojat ekonomike dhe sociale të vendit tonë, e të cilat janë të shumta duke marrë parasysh gjendjen ende të rëndë ekonomike dhe papunësinë e madhe.

Ky është buxheti i parë i planifikuar nga kjo Qeveri dhe pritjet janë që prioritetet e Qeverisë të reflektojnë në buxhet si në aspektin e shtetndërtimit të mëtejshëm, të përballimit të tranzicionit pas pavarësisë, ashtu edhe në adresimin e fushave dhe të prioritetëve që me të drejtë kjo Qeveri i ka dhënë prioritet infrastrukturës, arsimit dhe shëndetësisë.

Plani buxhetor që kemi përpara në radhë të parë jep lajmin e mirë që buxheti për vitin 2009 është rritur për 15%, që do të thotë 200 e më shumë milionë dhe se synimet për rritjen ekonomike janë 6%. Këto janë paralajmërues të mirë që Kosova është në rrugë të mirë për një ekonomi më të mirë, zhvillim më të mirë dhe mirëqenie për qytetarët e Kosovës.

Duke vlerësuar këtë projektbuxhet dhe duke e mbështetur plotësisht, marr parasysh se ky buxhet ka dalë në rrethana të veçanta për faktin se ka kufizime në mjete, kemi nevoja të mëdha, kemi mungesë të politikës monetare, por edhe kemi shtrëngesa nga kriteret ndërkombëtare që dalin nga Fondi Monetar Ndërkombëtar, e të tjera. Sigurisht se ka pasur shumë kompromise dhe mendoj se të gjithë aktorët nuk mund të dalin të gjithë të kënaqur. Por, në qoftë se buxheti do të respektojë prioritetet strategjike dhe parimet e barazisë për ndarje, ma merr mendja se do t'ia dalim.

Me këtë rast, më lejoni shkurtimisht të jap disa analiza. Së pari te investimet kapitale, rritja duket se është mbi 11% dhe mendoj se kjo është një punë e mirë duke marrë parasysh nevojat e Kosovës për infrastrukturë dhe fusha tjera. Mirëpo, atë që desha ta them, ka të bëjë me kapacitetet implementuese sepse, siç e dimë nga e kaluara, ka pasur mbetje buxhetore, mund të ketë edhe tash dhe, në bazë të analizave, disa nga institucionet

sikur i kanë lënë shpenzimet për fund të vitit dhe kjo tregon që çështja e kapaciteteve duhet të shikohet.

Sa u përket rezervave, duke marrë parasysh atë që po zhvillohet në planin global dhe në raport me krizat e mundshme financiare që mund të përfshijnë edhe vendin tonë, rezervat 200 milionë mendoj se janë të mira, por këto duhet të shoqërohen me një plan anti-krizë dhe mos të na gjejë në një situatë gjumi, siç na ndodhi me Trustin Pensional.

Po ashtu, mendoj se është mirë të kujdesemi për sistemin e unifikimit të pagave, sepse kemi situata kur udhëheqësit e organizatave publike marrin madje ma shumë se kryeministri dhe kryetari i shtetit, që nuk është në rregull.

Nga ana tjetër, mendoj se edhe brenda institucioneve duhet të ketë unifikim.

Më lejoni shkurt të them se çështja e arsimit për investimet kapitale ka marrë një mbështetje mjaft të mirë, por do të kisha thënë se tek çështja e pagave të mësimdhënësve duhet vazhdimisht të kujdesemi për pagat e dinjitetshme për shkak të cilësisë që mund të rezultojë nga një stimulim i tillë.

Shëndetësia. Mendoj se më në fund është mirë që ka marrë një mbështetje dhe këto 10 milionë e sa, që janë dhënë, tregojnë një lëvizje të rëndësishme në këtë drejtim dhe po ashtu mendoj se mbështetje më e madhe i takon fushës së sundimit të ligjit, sidomos gjyqësisë, policisë, prokurorisë dhe sundimi i ligjit jo vetëm që ka të bëjë me përmirësimin e klimës së investimeve të huaja në Kosovë, por edhe me efikasitetin e luftës kundër dukurive negative, pra korrupsioni, krimi i organizuar, kontrabanda e tjera.

Sa i përket bujqësisë, mendoj se nuk i është dhënë rëndësi e mjaftueshme për faktin se vendet tjera të rajonit, madje deri 8% të buxhetit ia kushtojnë bujqësisë dhe ne, siç e dimë, një prej komponentëve kryesorë të ekonomisë është edhe bujqësia.

Dhe, më lejoni për fund, t'i jap disa rekomandime, natyrisht duke i dhënë mbështetje buxhetit.

Rekomandimi i parë, që nuk e kam parë të veçantë në buxhet, janë investimet për shtrirjen e pushtetit në veri të vendit; ndërhyrja e Serbisë në sovranitetin e Kosovës dhe refuzimi i planit të Ban Ki Munit duhet të bëhet në vepër.

E dyta, investime më të mëdha duhen në fushën e politikës së jashtme, duke marrë parasysh sfidat e njohjes, Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe çështjen e Kosovës atje, si dhe shtrirjen e rrjetit të përfaqësimit diplomatik, si dhe për integritet evropiane.

Më shumë mjete duhen për realizimin e qëllimeve të Mileniumit, sepse ne vetë këtu kemi miratuar Rezolutën për zhvillim dhe me këtë rast mendoj se çështja e varfërisë, problemet sociale, pensionistët, familjet e atyre që dhanë kontribut për pavarësinë si dhe të pagjeturit duhet të trajtohen më mirë në këtë buxhet.

Fuqizimi i grave dhe më vjen keq shumë që i latë gratë të fundit, por ndoshta e keni pasur edhe për sharm, si dhe fuqizimi i rinisë kërkon një mbështetje më të madhe dhe për fund mendoj se 100.000 euro që i janë dhënë “Ulpianës”, nuk janë të mjaftueshme. Mendoj se është koha të blihen tokat ku gjendet lokaliteti arkeologjik “Ulpiana” si dhe “Kalaja” e

Prizrenit, e cila është një pasuri mjaft e madhe, por në anën tjetër, meqë u përmend Prizreni, disa herë desha t'ua përkujtoj disave këtu se Prizreni është jo vetëm qendër kulturore, por edhe historike dhe mendoj se investimet në Prizren nuk kanë qenë të mjaftueshme, marrë parasysh nevojat që ka. Ju faleminderit!

Diskutime të dorëzuara me shkrim

HAJDIN ABAZI:

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar zoti Kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Sot kemi në rend të ditës një çështje tepër të rëndësishme, ndoshta më të rëndësishmen, sa i përket zhvillimeve në vend, pasi që buxheti është parakusht dhe kusht për rrjedhat dhe zhvillimet gjatë vitit që vjen.

Disa kolegë këtu, sidomos ata të opozitës, janë sulur vetëm për të kritikuar dhe për të gjetur pika të zeza, sado që janë të vetëdijshëm se edhe po të kishin qenë ata në pushtet, nuk do të kishin mundur të bëjnë më tepër, sepse nuk lejon më ndryshe vetë shuma e buxhetit, FMN dhe mekanizmat tjerë evropian. Nejse, kjo është çështje e qasjes së tyre, në radhë të parë të përfitimit politik të opinionit i gjerë i cili po na përcjell përmes ekranit të RTK-së. Mirëpo, duhet të kihet parasysh se kritikët e pavend dhe vetëm sa për të kritikuar shpesh mund të sjellin rezultate të kundërta me dëshirat, sepse qytetari ynë sheh ndryshimet konkrete, përparim dhe zhvillim që po bëhen me një dinamikë të paparë në historinë e pasluftës në Kosovë.

Një projekt-buxhet i tillë natyrisht se ka vend për ndonjë kritikë, për ndonjë sugjerim apo korrektim, por janë relevante krahasuar me mega projektet që i ka parashtruar vetë Qeveria. Unë do të dëshiroja vetëm që të gjitha këto të realizohen, e të mos mbeten vetëm planifiko, për çka i dëshiroj z. Kryeministër dhe kabinetit të tij qeverisës sukses, punë dhe angazhim me përkushtim, që t'i realizojë dhe përmbushë parashikimet dhe objektivat, e kam bindje se do t'ia dalë pasi që ka dëshmuar efikasitet dhe aftësi për të menaxhuar me sukses.

Sidoqoftë, po i kthehem temës së buxhetit. Varësisht se me çfarë qëllimi sheh diçka, ashtu edhe do ta shohësh. Nëse kërkon të meta, do t'i shohësh vetëm ato. Dhe shumëçka duket e parealizueshme, por ne po shohim tek realizohen projekte, që vetëm kemi mund t'i imagjinojmë deri para një viti!

Le të shohim më konkretisht. Qeveria ka bërë shumë rrugë, dhe kështu ia ka ndërruar pamjen vendit, por me këtë ka hapur edhe perspektiva dhe mundësi të reja. Rrugët do të sjellin investime të reja për turizëm, biznes dhe zhvillim tjetër, që do të hapen vende të reja të punës, do të krijohen të ardhura dhe kështu do të rritet mirëqenia në familje. Sa për ilustrim, po përmend vazhdimin e projektit të rrugës Jezerc-Budakovë, që do ta lidhë Ferizajn me Suharekën, dhe me tërë rrafshin e Dukagjinit, do të mundësojë komunikim, rekreacion dhe ndërlidhje të reja, sidomos gjatë pranverës, verës dhe vjeshtës. Kjo do të hapë një të ardhme të re për këtë trevë. Ose një shembull tjetër: rruga Ponesh-Gadish-Kishnapole-Gadime, do ta lidhte këtë pjesë turistike, por të izoluar, me Lipjanin, Prishtinën dhe Ferizajn, me ç'rast do të hapeshin perspektiva të reja biznesi, turizmi, rekreacioni dhe zhvillimi rural – bujqësi, blegtori, bletari, pulari etj. Këta ishin vetëm disa

shembuj, përndryshe rrugët hapin mundësi dhe potenciale të reja të zhvillimit ekonomik, teknologjik dhe për mikro e makrobiznese. Pa infrastrukturën rrugore një zhvillim i tillë nuk mund të imagjinohet. Kështu që ndërtimi i rrugëve është investim për të ardhmen, për mirëqenien, zhvillimin dhe prosperimin.

Një segment tjetër i suksesit të Qeverisë që e drejton z. Thaçi, është arsimi. Nuk besoj se ka ndonjë që mund ta mohojë zhvillimin që po bëhet, si në ndërtimin e objekteve shkollore, rritjen e pagave, dhe procesin e kompjuterizimit të shkollave. Ky realizim nuk është vetëm si përmbushje e programit elektorale, po është investim në të ardhmen, në rininë e vendit. Parakusht për një zhvillim bashkëkohor është arsimimi kualitativ, me procedura më të avancuara dhe me teknologji më të përparuar. Pikërisht këtë e ka për synim zhvillimi i hovshëm i arsimit, që e ka vënë në prioritet Qeveria. Kështu hapim mundësi dhe perspektiva për zhvillim të pakthyesëm, pa improvizime, por të qëndrueshëm. Mund të kërkohet më tepër, por atëherë do të kaloheshin caqet e mundësisë. Ministrit i dëshiroj vetëm vazhdim të suksesit si deri më tani.

Një segment tjetër është rritja e pagave, prej 10%. Duket pak, dhe mbase është. Po me siguri askush më shumë se kryeministri nuk do të kishte dëshirë për rritje më të madhe, mirëpo shtrëngesat buxhetore dhe kufizimet nga FMN nuk lejojnë më shumë. Megjithatë, më mirë pak, sidomos në këtë kohë krize, se sa hiq. Mirëpo, zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe arsimore, krijon kushtet për ngritje të vazhdueshme, por të qëndrueshme, të punësimit e të të ardhurave. Me rëndësi është ecja përpara, pak nga pak, por në përmirësim gradual të gjendjes sociale.

Po këtë objektiv kanë edhe lehtësirat e propozuara për investitorët dhe për prodhuesit. Zbritja e tatimit të fitimit nga 20% në 10% është një veprim me mend, sepse regjioni po konkurren me tarifa të ulëta dhe ne duhet të ecim me atë trend, nëse duam të jemi atraktiv. E kjo domethënë mundësi të reja për investime, hapje të kompanive prodhuese dhe bashkë me këtë edhe vende të reja pune, të ardhura dhe përmirësim i gjendjes ekonomike familjare të qytetarëve të Kosovës.

Ka dhe shumë të tjera, por konsideroj se mjaftojnë këto, sa për të ilustruar prioritetet zhvillimore që rrjedhin nga buxheti. Natyrisht, asgjë nuk mund të bëhet me shkop magjik, si e kam thënë dhe një herë tjetër, por krahas ngritjes së buxhetit, krijohen kushtet për përmirësime sociale, shëndetësore etj. Duket se buxheti ka parashikuar ecje të matur, strategjike dhe që i sjellë Kosovës një të ardhme me perspektivë.

Prandaj do ta votoj dhe do t'i jap mbështetje, duke shprehur besimin se arritjet do të jenë të justifikueshme dhe që do të sjellin prosperitet.
Faleminderit!

MYRVETE PANTINA:

Në çdo shtet, politika monetare dhe fiskale paraqesin instrumentet kryesore për realizimin e objektivave makroekonomikë të atij shteti. Megjithatë në Kosovë politika monetare ende nuk po mund të luaj rolin e vet, atëherë edhe më shumë rritet rëndësia e politikës fiskale për të realizuar objektivat makroekonomikë. Në bazë të zhvillimit të gjertanishëm, nuk mund të lavdërohem me politikën fiskale të aplikuar, sepse ende kemi papunësi të lartë – mbi 40%, rritje ekonomike të ulët mesatarisht 3,5%, e cila nuk mundëson uljen e papunësisë, strukturë ekonomike të pavolitshme, sepse mbi 50% të ndërmarrjeve të regjistruara merren me tregti, kurse me prodhim vetëm 9%, si edhe import të lartë që

rezulton me deficit të lartë tregtar, i cili në vitin 2009 pritet të arrijë në 1.829 miliardë euro.

Në programin e Qeverisë rritja ekonomike paraqet prioritetin kryesor. Në kuadër të këtij prioriteti bëjnë pjesë zhvillimi i infrastrukturës në tërësi, sundimi i ligjit, arsimi, bujqësia, politikat fiskale dhe sektori financiar. Është shumë e arsyeshme që rritja ekonomike të ketë prioritet, pasi që pa qëndrueshmëri ekonomike nuk do të ketë as qëndrueshmëri politike dhe sociale.

Në Buxhetin e vitit 2009 planifikohet rritja e të hyrave për 7.9% në krahasim me të hyrat e vitit 2008. Po ashtu, planifikohet rritja e shpenzimeve për 937 milionë euro, sa kanë qenë në vitin 2008, në 1.094 miliardë euro në vitin 2009. Pas disa vitesh me suficit buxhetor, në Buxhetin e vitit 2009 pritet një deficit prej 138,3 milionë euro, për të cilin nuk dihet si do të mbulohet, por do të shohim se a do të shpenzohen të gjitha mjetet e planifikuara, apo do të përsëritet mosshpenzimi i mjeteve për shkak të mosplanifikimit të projekteve si duhet apo për shkak të paraqitjes së problemeve në prokurim. Meqenëse nevojat për mjete financiare për ndërtimin e shtetit tonë të ri janë shumë të mëdha se sa mundësitë që na ofron buxheti ynë, për këtë arsye nuk duhet të lejojmë që mjetet e grumbulluara në buxhetin e shtetit të mbesin të pashfrytëzuara, e nëse merret në konsideratë edhe efekti multiplikues i mjeteve të shfrytëzuara, atëherë duhet të jetë edhe më e qartë pse mjetet nuk duhet të mbesin pa u futur në funksion.

Struktura e të hyrave buxhetore edhe më tutje mbetet e pavolitshme, sepse tatimet në kufi me 665,3 milionë përbëjnë rreth 70% të hyrave buxhetore, dhe, ende nuk kanë tendencë të rritjes, ndërsa tatimet e brendshme me 200 milionë euro vetëm 21% të hyrave buxhetore.

Ndarjet buxhetore të planifikuara në Projektbuxhetin e vitit 2009, mendoj se nuk janë bërë në harmoni me prioritetet e caktuara dhe në harmoni me nevojat e sektorëve të caktuar për të bërë ndryshimet e nevojshme në tregues makroekonomikë që u përmendën më lartë. Nëse duam të zvogëlojmë importin, duhet të prodhojmë më shumë. Përveç kësaj, duke prodhuar më shumë, do të rrisim bruto produktin vendor (BPV), do të zvogëlojmë papunësinë si dhe varfërinë, por edhe do të kursejmë buxhetin nga transferet. Andaj, nëse duam të arrijmë këto objektiva, është momenti i fundit të përkrahet sektori i prodhimit. Për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural parashihet rritja e buxhetit për 45%, si dhe 7 milionë euro për investime kapitale. Edhe ndërtimi i rrugëve ka rëndësi të madhe për zhvillimin ekonomik të Kosovës, por ndërtimi i rrugëve me prioritet më të vogël mund të presë edhe një kohë, në mënyrë që të mundësohet përkrahja më e madhe e prodhimit të vendit, qoftë me subvencione direkt, ose me lirimin nga taksat për import të lëndës së parë dhe të makinerisë për të gjithë prodhuesit (jo vetëm për prodhuesit bujqësorë) ose të formave të tjera të përkrahjes të cilat aplikohen edhe nëpër vendet e tjera. Kosova ka treg shumë të hapur. Prodhuesit e rajonit dhe më gjerë, pa asnjë pengesë mund të sjellin produktet e tyre në tregun e Kosovës, por parashihet pyetja se çfarë ka për t'i ofruar tregut të këtyre vendeve Kosova dhe nëse ka, a ka mundësi të depërtojë lehtë në këto tregje. Përgjigja në pyetjen e parë është se Kosova mund të ofrojë numër shumë të vogël të produkteve, ndërsa nuk e ka lehtë të depërtojë në këto tregje për shkak të kostos së lartë të prodhimit (për shkak të mospërkrahjes institucionale) apo edhe për shkak se vendet fqinje dhe vendet e rajonit vendosin barrierë ndaj tregtarëve kosovarë, madje edhe ato vende me të cilat Kosova ka marrëveshje të tregtisë së lirë.

Kosova, si shtet në ndërtim e sipër, nuk e them që duhet të aplikojë barriera tregtare, por duhet të kërkojë zbatimin e parimit të reciprocitetit së paku me vendet që ka marrëveshje tregtare, në mënyrë që të mund të eksportojë më shumë. Mos të harrojmë se vendet që sot janë të zhvilluara ekonomikisht, për të përmirësuar zhvillimin ekonomik kanë inkurajuar me metoda të ndryshme zhvillimin e ndërmarrjeve të tyre kombëtare. Këto vende, derisa kishin ekonomi të brishtë, ishin shumë larg nga aplikimi i politikave liberale (të tregut të lirë).

Në fund, dua të theksoj se asnjë subvencionim nuk duhet të bëhet pa projekt konkret, e as në bujqësi. Por, është e çuditshme se si Qeveria mund të rekomandojë subvencionimin e mëtejshëm të KEK-ut derisa nuk ofrohet ndonjë raport financiar për mënyrën e shfrytëzimit të subvencioneve të dhëna këtij subjekti në vitin paraprak, si dhe pa e kushtëzuar këtë subjekt me rritjen e inkasimit të të hyrave në periudhën e ardhshme.

GJYLNAZE SYLA:

I nderuar zoti kryetar,
E nderuar Qeveri,
Deputetë të nderuar,

Seanca e sotme e Kuvendit të Kosovës ka filluar me një orë e gjysmë vonesë. Kjo ndodhi, sepse Kryeministri dhe disa nga ministrat munguan. Kjo dëshmon se qeveria është e papërgjegjshme, injorante ndaj Kuvendit dhe e pa interesuar për qytetarët e Kosovës.

Për Projektbuxhetin për vitin 2009, të cilin sot po e shqyrtojmë, ministri Shala iu falënderua Kryeministrit, ministrave, Presidencës.

Zoti ministër,

Ky nuk është buxhet i qeverisë, por i qytetarëve të Kosovës, të cilët iu kanë dhënë besimin për ta menaxhuar. Prandaj, unë së pari i falënderoj ata që kontribuan për këtë buxhet, taksapaguesit.

Të nderuar deputetë,

Qeveria ka dështuar që të ballafaqohet me problemet kritike të popullit të Kosovës për shkak të papërgjegjësisë dhe paaftësisë. Sepse, në Buxhetin e vitit 2009 nuk është parashikuar një zgjidhje për zbutjen e varfërisë, zvogëlimin e papunësisë, rregullimin e shëndetësisë, furnizimin 24 orë me rrymë.

Prandaj, varfëria dhe papunësia nuk do të zbuten, shëndetësia nuk do të përmirësohet, problemi i rrymës nuk do të tejkalohet, ekonomia nuk do të zhvillohet.

Të nderuar deputetë,

Çfarë përfitojnë qytetarët e Kosovës nga ky buxhet? Duhet rikujtuar qeverisë se janë përgjegjës për menaxhimin e parasë publike. Më lejoni të tregoj se çfarë është ky buxhet dhe çfarë duhet të jetë.

Çfarë është ky projektbuxhet?

Nuk është buxhet zhvillimor. Nuk është transparent. Kamuflon suficitin. Subvencion KEK-un. Nuk nxitë reformat. Nuk e arrin qëllimin.

Çfarë duhet të jetë?

Buxheti për vitin 2009 duhet të jetë instrument i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të shtetit të Kosovës. Duhet të jetë transparent. Kuvendi vendos se cilat janë prioritetet në bazë të propozimit të qeverisë. Prandaj, qeveria duhet ti tregojë qartë vendimet, përmes shifrave, pa kamuflime. Sepse, pas shifrave fshihen vendimet. Deputetët dhe qytetarët e Kosovës duhet të informohen për këtë. Kjo është demokracia. Kjo është qeverisja e mirë.

Çfarë është ky projektbuxhet?

Sipas ministrit Ekonomisë dhe Financave, zotit Shala, me këtë buxhet është arritur rritja ekonomike prej 6%. Megjithatë, kjo rritje ka qenë e shoqëruar me inflacion të lartë. Gjithashtu, për shkak të rritjes së çmimeve në tregun ndërkombëtar të ushqimit dhe të karburanteve, inflacioni në gjashtë muajt e parë është rritur në 13%, dhe ka qenë më i lartë në Kosovë se sa te partnerët tregtarë të Kosovës. Kjo shkakton humbjen në konkurrencë dhe rritjen e deficitit tregtar.

Sa u përket shpenzimeve kapitale prej 40%, e vërteta është se vetëm 20% është shpenzuar, që dëshmon paaftësinë e qeverisë në menaxhim dhe domosdonë për mbikëqyrjen. Prandaj, qeveria duhet të sigurojë planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e projekteve, kurse Kuvendi përmes Komisionit për Buxhet të mbikëqyrë që këto projekte të zbatohen sipas planit dhe kohës së paraparë.

Çfarë duhet të jetë buxheti 2009?

Duhet të jetë i drejtë. Komunitat duhet të kenë ndarje të drejtë buxhetore. Komunitat që përbëjnë gati ¼ e popullsisë, si komuna e Pejës, Gjakovës dhe Mitrovicës, duhet të përfitojnë nga buxheti në baza të drejta, krahasuar me komunitat e tjera, si Prizreni, Gjilani apo Ferizaj. Kjo nuk është bërë. Ja argumentet: për Pejën dhe Gjakovën janë ndarë nga 12 milionë €, për Mitrovicën 11 milionë €, kurse Prizreni 22 milionë €, Gjilani dhe Ferizaj nga 11 milionë €.

Kjo është ndarje jo e drejtë e buxhetit, duke u bazuar në numrin e banorëve, por edhe në shkallën e papunësisë në këto komuna. Gjithsesi, komuna e Mitrovicës është dashur të trajtohet me prioritet, me mbështetje më të madhe buxhetore. Peja dhe Prizreni kanë pothuajse numër të njëjtë të banorëve, kurse Prizreni ka 10 milionë më shumë. Po ashtu, dihet se papunësia është më e lartë në komuna më të mëdha, si Peja, Gjakova dhe Mitrovica, se sa në komuna më të vogla, si Gjilani dhe Ferizaj.

Çfarë duhet të bëjë ky buxhet?

Buxheti 2009 duhet të kontribuojë në arritjen e objektivave dhe të strategjisë sipas KASH-it 2009-2011, i cili ka marrë miratimin nga donatorët në Konferencën Ndërkombëtare të Donatorëve, më 11 korrik 2008, në Bruksel.

Buxheti 2009 i prezantuar nga qeveria është ndryshe nga buxheti i prezantuar donatorëve, sepse qeveria ndryshon prioritetet tërë kohën. Prandaj, duhet që qeveria dhe donatorët t'i diskutojnë politikat.

Ky buxhet është parakusht me rëndësi për të filluar diskutimet për paketën e politikave me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Nuk duhet keqinterpretuar FMN-në, siç është bërë në dokumentin e buxhetit, ku thuhet se FMN relativisht është pajtuar me kufirin fiskal të rekomanduar.

Z. ministër,

Ju e dini se kjo nuk është e vërtetë. FMN jo vetëm që nuk është pajtuar, por ka tërhequr vërejtjen për këtë çështje dhe ka kërkuar që kjo pjesë të hiqet nga projektligji. Thënë shkurt, ky buxhet duhet të sigurojë anëtarësimin e Kosovës në Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Sa u përket politikave fiskale, tanimë kolegët e mi e përmendën se TVSH-ja është rritur prej 15% në 16%, pra është rritje prej 1%. Kjo rritje nuk i ndihmon të varfërit, pasi që çmimet e kostos jetësore të ushqimit dhe të karburanteve janë të larta.

Veçanërisht dëshiroj të shquaj nevojën që shëndetësia të bëhet prioritet. Dhe vetë mbështetja buxhetore e sistemit shëndetësor duhet trajtuar sipas prioriteteve. Duhet së pari, ashtu siç e kemi thënë edhe më herët, që Ministria e Shëndetësisë të krijojë sistemin e informimit shëndetësor për të ditur se sa do të kushtojë Ligji për sigurimet shëndetësore. Lidhur me marrëveshjen e Sindikatës së Shëndetësisë me Ministrinë e Shëndetësisë për rritjen e pagave prej 40 €, është e qartë se nuk do të ketë zbatim të kësaj marrëveshje në vitin 2009. Prandaj, pyes ministrin Shala: zoti ministër, a mund të na siguron se pagesa prej 40 € është e zbatueshme dhe e qëndrueshme?

Do të ndalem te problemi i rrymës. Edhe pas investimeve prej më shumë se 1 Miliard € në KEK, përsëri KEK-u vazhdon të mbështetet prej buxhetit të Kosovës. Kështu, buxheti i Kosovës ngarkohet me subvencionet për KEK-un. Janë paraparë shpenzimet prej 80 milionë € dhe 40 milion € për importin e rrymës. Kjo është plotësisht e gabueshme.

E para, qeveria ka paraparë që këto t'i kthehen buxhetit, do të thotë se shuma prej 160 milionë € të kredive të vitit 2008 dhe 2009 t'i kthehet buxhetit të Kosovës nga operatorët privat më 2009. Por, privatizimi nuk mund të kryhet para vitit 2010, sepse qeveria nuk do të jetë në gjendje që ta përfundojë procesin e tenderimit deri në fund të vitit 2009. Më mirë është që të përmirësohet operimi i KEK-ut. Në vend që të shpenzojë aq shumë për blerjen e rrymës, më mirë është që të përmirësojë faturimin dhe pagesën e rrymës.

Po ashtu, qeveria duhet të jetë plotësisht transparente në procesin e tenderimit të projektit “Kosova e Re”, për të fituar besimin dhe mbështetjen e taksapaguesve.

Rreziku për buxhetin është se në pranverë, kur do të bëhet rishikimi i buxhetit, mund të ndodhë që shpenzimet të rriten.

I nderuar zoti Kryetar,

Po të vlerësohej performanca e qeverisë me notë, sigurisht që kjo qeveri për këtë projektbuxhet do të merrte notën 1. Sepse, standardi kryesor për vlerësim duhet të jetë buxheti për jetë më të mirë të familjeve të Kosovës. Ky buxhet nuk e mbërrin këtë qëllim.

Prandaj, unë nuk do ta votoj.

Ju faleminderit për vëmendjen!

KRYETARI: Pasi të lajmëruar të tjerë për diskutim nuk ka, fjalën e ka Kryeministri i Kosovës, zoti Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë, kryetarë të partive politike,

Fillimisht dëshiroj që t'ju falënderoj për debatin shumë korrekt, konstruktiv për të gjitha sugjerimet, vërejtjet, rekomandimet, shqetësimet që janë ngritur.

Si Kryeministër i Qeverisë së Kosovës, me përgjegjësinë më të lartë ua rikonfirmoj se çdo sugjerim, çdo ide do të merret parasysh me respektin më të madh dhe përgjegjësinë më të lartë shtetërore.

Buxheti nuk është vetëm i Qeverisë, është i gjithë vendit, është i gjithë qytetarëve të Kosovës, është i gjithë politikës kosovare dhe ndihem tepër mirë me diskutimin shumë korrekt dhe shumë qëllimshëm. Por, ndërkohë dëshiroj t'i jap disa sqarime të cilat mendoj se janë të nevojshme, sqarime këto të shkurtra.

Dua të potencoj se sa u përket komunave, buxheti është ai që është dhe ka ngritje për çdo komunë dhe nuk ka diferencim politik, nuk ka anim apo diskriminim të tillë. Edhe sikur të paraqitej gjatë debatit për buxhet, të jeni të bindur se nuk do të pranoja një gjë të tillë, e as që do të lejoja të diskutohet. Në anën tjetër, gjithçka ka shkuar pas konsultave të gjata të brendshme, edhe brenda koalicionit, por edhe në raport me partitë e tjera që i kanë disa komuna në Kosovë. Gjithashtu, ju e dini se grandet janë rreth 100% më të mëdha këtë vit. Por, ndërkohë, unë e kuptoj se duhet folur për njerëzit që e përcjellin këtë debat dhe është krejt legjitime, por është me interes që secili të ngrihet mbi nivelin e interesit vetëm të lagjes dhe të fshatit të vet dhe të shoh këtë buxhet si buxhet të Kosovës. Jam i bindur se investimet të cilat i kemi bërë si Qeveri e Republikës së Kosovës, qoftë në rrugë, qoftë në shkollë, qoftë në kanalizime, qoftë në projekte të tjera, e kanë prekur për të mirë çdo familje kosovare e gati-gati, mund të them, 100% edhe vendbanimet prej nga vijmë ne të gjithë, pa dallim partie.

U përmend Mitrovica dhe dëshiroj ta theksoj fuqishëm para jush se vetëm për vitin 2008 në infrastrukturë rrugore, në ujësjellës, kanalizime janë investuar mbi 9 milionë euro. Mbi 4 milionë euro janë vetëm në pjesën veriore, e kjo ndodhë për herë të parë në Kosovën e pasluftës. Ky është prioritet unik, jo vetëm i Qeverisë, por unik i gjithë Kosovës që të investohet dhe nuk do të ndalemi. Përkundrazi, do t'i rrisim investimet për atë pjesë të territorit të Kosovës.

Gjithashtu, u ngrit edhe çështja e rrugëve dhe e shkollave. Do të vazhdojmë, bile edhe më fuqishëm me ndërtimin e rrugëve të reja, të shkollave të reja. Dikush më herët ka potencuar se kjo Qeveri është Qeveri shkollash dhe asfalti. Ndihej tepër mirë që kemi arritur në Kosovë më në fund të kemi një qeveri që merret me shkollë, ndërton shkollë, hap perspektivë të edukimit të vendit, por edhe modernizon vendin. Dhe, nuk kemi e nuk do të mbijetojë asnjë qeveri tash e tutje që do të jetë e baltës dhe e analfabetizmit. Është mbyllur ai kapitull.

Gjithashtu, të nderuar deputetë, ju siguroj se për çdo cent do të ketë llogaridhënie. Do të ketë transparencë të plotë edhe në të ardhmen. Do të ketë sundim të ligjit. Do të ketë ligjshmëri, por ndërkohë dëshiroj të theksoj se do të vazhdojmë të jemi të pakompromis në betejën kundër dukurive negative.

Theksoj fuqishëm, para jush, sepse kemi punuar bashkë me të gjithë në një formë a në formën tjetër – Qeveri – koalicion – opozitë – parti shqiptare – minoritare, të gjithë kemi punuar për vendin tonë. Ndihej tepër mirë dhe krenar që sot jam kryeministër i një Qeverie me njerëz të tillë dhe me mbështetjen tuaj se, më në fund, shteti ynë i ri, në vitin

që e kemi shpallur Kosovën shtet, kemi instaluar definitivisht qeverisjen e mirë. Ky sinjal i qartë edhe nga vetë qëndrimi i juaj, jo nga vetë mburrja ime, por nga qëndrimi juaj, nga deklaratimet tuaja, nga diskutimet tuaja, nga mbështetja juaj dhe unë ndihem tepër mirë që as edhe një deputet sot nuk ka vetëdyshime për korrupsion dhe krim të organizuar. Kjo e rritë edhe më tepër përgjegjësinë e qeverisë sime që të kemi tolerancë zero ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe për sundimin e ligjshmërisë.

Me këtë instalim të qeverisjes së mirë, me këtë efektivitet, ne do të jemi shumë shpejt edhe pjesë e NATO-s, edhe pjesë e Bashkimit Evropian. Natyrisht, kemi edhe shumë për të bërë, por janë zotimet tona të cilat do t'i implementojmë kriteret të cilat janë të domosdoshme dhe në politikë, edhe në ekonomi, edhe në legjislacion.

Prej prioriteteve të cilat u theksuan këtu dhe janë shqetësuese, shqetësim që ka qenë tash e 8 vite, që mund të jetë bartur edhe me lëshime të reja, por me zotime të mëdha, është prioriteti i reformave në shëndetësi. Janë reforma të rënda, por të domosdoshme dhe do të ballafaqohemi, për çka edhe kemi ndarë mjete shtesë, mjete shtesë të cilat do të rezultojnë, besoj fuqishëm, me një reformim më të thellë të shëndetësisë, me një kujdes më të madh për shëndetësinë, me një kujdes më të madh për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Gjithashtu, u përmendën edhe vende të reja të punës. Ne do të investojmë në gjithë sektorët që u përmendën këtu edhe më herët dhe investimi në të gjithë sektorët institucional shtetëror të Republikës së Kosovës, por edhe në sektorin privat do të krijojë mundësi dhe hapësirë të reja për vende të reja të punës. Të jeni të bindur se shëndetësia dhe krijimi i vendeve të punës do të jenë prej prioriteteve përsëri kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Desha të theksoj edhe një çështje që mendoj se definitivisht duhet të bëjmë qartësimin e duhur. Qeveria e Kosovës ka marrë vendimet legale dhe legjitime për privatizimin. Duhet të nxirret ligji shpejt. Por, ne kemi punuar paralelisht, duke respektuar gjithmonë ligjshmërinë. Ne definitivisht jemi shkëputur nga ekonomia socialiste, nga ekonomia e planifikuar dhe jemi në ekonominë e lirë të tregut.

Dikush mund të flasë në mënyrë prejjudikuese ende pa filluar procesi. Unë ju ftoj të gjithëve t'i jepni mbështetje këtij procesi, sepse është në interes të vendit, është në interes të qytetarëve, është në interes të perspektivës sonë të përbashkët.

Kriza globale e ka përfshirë të gjithë botën. Edhe Kosova, në një të ardhme të afërt, ndoshta mund të mos bëjë përjashtim, mirëpo ne me të mirat dhe me dobësitë jemi pjesë e botës dhe nuk mund të jemi, as nuk dëshirojmë, as nuk do të jemi të izoluar. Prandaj, njerëzit mund të kenë edhe filozofi të ndryshme politike, dikush mendon se duhet vazhduar me ekonomi socialiste, me ekonomi të planifikuar, por ky është vizioni im dhe ne do të vazhdojmë me ekonominë e lirë të tregut.

U ngrit këtu edhe çështja e mësuesve, e mësimitdhënësve, e pensioneve, e shërbyesve civilë dhe e segmenteve të tjera. Po! Fondi Monetar Ndërkombëtar ka ngritur pyetje për rritjen e pagave të mësimitdhënësve, pyetje këto legjitime të Fondit Monetar Ndërkombëtar, por edhe vendimi ynë ka qenë shumë legjitim për rritjen e pagave të mësimitdhënësve rreth 30% për herë të parë pas luftës. Ka qenë domosdoshmëri, prandaj kësaj pyetje të Fondit Monetar Ndërkombëtar iu kemi përgjigjur në mënyrë profesionale, por edhe kemi filluar në mënyrë shumë të përgjegjshme implementimin e vendimit për

rritjen e pagave për punëtorët e arsimit kosovar. Gjithashtu, edhe për pensionet, por edhe për shërbyesit civilë.

Duke ju falënderuar përsëri për të gjitha diskutimet, për mbështetjen tuaj, unë ju siguroj se do të punojmë bashkërisht për të mirën e vendit tonë, për mirëqenien sociale të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Ju ftoj që ta votojmë këtë projektbuxhet që është projektbuxheti i Kosovës ndryshe, i Kosovës së ndryshimeve për të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryeministër! Konsideroj se me fjalën përmbyllëse të Kryeministrit edhe është përmbyllur debati lidhur me këtë pikë.

Në sallë kemi 73 deputetë dhe kjo na jep mundësi për të hyrë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim. Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, 7 “kundër”, 5 “abstenime”, Kuvendi miratoi Projektbuxhetin, në parim, për vitin 2009.

Në bazë të Rregullës 35 pika 10 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Kuvendi ngarkon Komisionin për Buxhet dhe Financa, si komision përgjegjës dhe raportues, për të shqyrtuar Projektbuxhetin dhe Kuvendit t’i paraqet raport me rekomandime.

Komisionet e përhershme dhe funksionale mund ta shqyrtojnë Projektbuxhetin e vitit 2009 nga aspekti i fushëveprimeve të tyre dhe amendamentet eventuale t’ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Me këtë, po e mbylлим seancën e sotme. Mirupafshim në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia e Transkripteve